

Përmbajtja

Hyrje

Elira Zaka 3

Raport mbi monitorimin e respektimit të standardeve etike nga gjyqtarët.
Korrik 2010 - Qershor 2011

Rovena Qose - Pregja 6

Disa reflektime mbi problematikën dhe rrugët e arritjes së standardeve
mbi integritetin e gjyqtarëve. Etika gjyqësore – një element thelbësor i
integritetit të gjyqtarit

Ardian Dvorani 77

Etika e gjyqtarit dhe kriteret e vlerësimit nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë

Sandër Simoni 83

Inspektimi i gjyqësorit në lidhje me respektimin e standardeve etike dhe
praktika e ndjekur nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë

Valbona Vata 86

Hyrje

Qendra e Studimeve Parlamentare, me mbështetjen financiare të Ambasadës Amerikane në Tiranë, hartoi dhe zbatoi projektin “Gjyqtari dhe publiku: rritja e besimit të publikut kundrejt gjyqësorit, bazuar në parimet e transparencës dhe përgjegjshmërisë.” Nëpërmjet këtij projekti synohet rritja e besimit të publikut tek gjyqësori, përmes vendosjes së procedurave efçente të vlerësimit, në çështje që lidhen me etikën e gjyqtarëve.

Debati publik në ditët e sotme ka qenë i fokusuar në çështjet që lidhen me integritetin dhe përgjegjshmërinë e gjyqtarëve. Shoqëria shqiptare ka nevojë për magjistratë me autoritet dhe integritet të paprekshëm e të pacënueshëm. Ndërsa Kushtetuta garanton pavarësinë e gjyqësorit, ajo parashikon edhe një mekanizëm për të kontrolluar përgjegjshmërinë e gjyqtarëve. Duket se arritja e standardeve perëndimore në dhënien e drejtësisë dhe funksionimin e shtetit të së drejtës është një betejë e gjatë, e cila mund të fitohet gradualisht me anë të një qasjeje strategjike, që përfshin të gjitha palët e interesuara, që në procesin e përzgjedhjes së strukturave gjyqësore në të gjitha nivelet, duke shmangur ndikimin e pajustificuar politik mbi sistemin e drejtësisë.

Sistemi ynë i demokracisë kushtetuese mbështetet në themelet e tij të pavarësia e gjyqësorit. Në Shqipëri janë ndërmarrë reforma të rëndësishme kushtetuese dhe ligjore për një sistem gjyqësor të pavarur e të paanshëm. Gjithsesi, çështja e gjyqësorit vazhdon të mbetet një nga sfidat më të rëndësishme të shoqërisë shqiptare për vendosjen e një demokracie kushtetuese moderne.

Raporte dhe analiza të ndryshme janë bërë për këto reforma, të cilat vazhdojnë të tregojnë se kjo degë e pushtetit vuan nga mungesa e besimit të publikut. Ndryshimi i situatës së gjyqësorit nuk është një çështje vetëm e qeverisë, një rol të rëndësishëm në këtë aspekt duhet të luajnë shoqëria civile dhe media.

Një aspekt i rëndësishëm i demokracisë kushtetuese është kufizimi i pushtetit qeverisës. Ky lloj kufizimi shtrihet te tri degët e qeverisjes; legjislativin, ekzekutivin dhe gjyqësorin. Për shkak të rolit substancial kushtetues të gjyqësorit ky i fundit duhet të ruajë legjitimitetin dhe besimin e publikut tek ai. Proceset e rregullta e të drejta i japin garanci shoqërisë në të gjithë veprimtarinë e saj. Marrëdhëniet shoqërore nuk mund të jenë të qëndrueshme, nëse nuk garantohet drejtësi dhe shtet i së drejtës. Gjyqtarët janë në shërbim të publikut dhe veprimtaria e tyre duhet të jetë transparente dhe e bazuar në praktika të pakorruptueshme. Figura e gjyqtarit duhet të jetë e pacënueshme nga nepotizmi, abuzimi me pushtetin dhe arroganca. Si të tillë gjyqtarët si persona apo gjykatat si institucione duhet të tregohen të kujdesshëm për kufizimet që duhet të kenë dhe përgjegjësinë kryesore të tyre, atë ndaj publikut. Është edhe detyrë e shoqërisë civile që t'i mbajë ata nën një vëzhgim dhe vështrim kritik të hapur e transparent të vazhdueshëm.

Mbështetur në këto shqetësime, Qendra e Studimeve Parlamentare hartoi projektin në fjalë. Në kuadër të zbatimit të tij, Qendra e Studimeve Parlamentare ndërmori disa aktivitete, një prej tyre ishte monitorimi i drejtpërdrejtë i gjykatës së rrethit Tiranë, ku u vëzhgua në mënyrë specifike respektimi i rregullave të solemnitetit nga gjyqtarët.

Grupi i eksperteve ka kryer një analizë të mirëfilltë të standardeve etike të gjyqtarëve, ç'kuptohet me to dhe si merren ato në konsideratë nga organet emëruese të gjyqtarëve. Po kështu, një çështje që trajtohet në raport është edhe nevoja e respektimit të Kodit Etik për gjyqtarët, parimet

e sjelljes profesionale të cilat duhet të hartohen nga vetë gjyqtarët. Mbikëqyrja e standardeve etike, ankimet kundër gjyqtarëve dhe procesi disiplinor janë gjithashtu pjesë e analizës dhe e raportit të Qendrës së Studimeve Parlamentare.

Në vijim të aktiviteteve, u organizua tryeza e rumbullakët mbi Etikën e Gjyqtarëve, në të cilën gjyqtarë të të gjitha niveleve morën pjesë dhe diskutuan rreth rëndësisë së respektimit të standardeve etike për rritjen e besimit të publikut. Anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë edhe një herë theksuan rëndësinë e këtij aktiviteti dhe domosdoshmërinë e reformës gjyqësore si garanci për mirëfunksionin e gjyqësorit.

Çështje të lidhura me përzgjedhjen cilësore, morale e profesionale në emërimet e gjyqtarëve e në promovimin e ngritjen në karrierë të tyre ishin gjithashtu pjesë e diskutimeve dhe e debatit. Sistemi ende nuk ofron një proces të drejtë, profesional e transparent të procedimit disiplinor për rastet e parashikuara nga ligji. Për këtë qëllim, Qendra do të vazhdojë të ketë në focus të aktiviteteve dhe projekteve në të ardhme reformat në drejtësi dhe përmirësimin e standardeve që ofron sistemi i drejtësisë në vend.

Elira Zaka
Drejtoresh Ekzekutive
Qendra e Studimeve Parlamentare

Raport mbi monitorimin e respektimit të standardeve etike nga gjyqtarët

Korrik 2010 - Qershor 2011

1. Standarde etike për emërimin/pozicionin e gjyqtarëve dhe të drejtuesve të gjykatave

1.1 Kriteret e qarta të bazuara në merita, për emërimin fillestar dhe emërimet pasuese brenda sistemit gjyqësor, janë konsideruar si pjesë thelbësore e pavarësisë dhe paanësisë¹. Gjyqtarët duhet të emërohen mbi bazën e aftësive të tyre profesionale, kualifikimeve personale dhe vetë integritetin. Kriteret, si opinioni politik, raca ose ngjyra nuk konsiderohen si faktorë të rëndësishëm për pozicionet gjyqësore. Parimet Themelore të OKB-së mbi Pavarësinë e Gjyqësorit përcaktojnë që:

Personat e zgjedhur në detyrë gjyqësore duhet të jenë individë me integritet dhe aftësi e me trainimet e duhura në drejtësi. Çdo metodë e përzgjedhjes gjyqësore duhet të mbrojë ndaj emërimeve gjyqësore për motive të papërshtatshme.²

¹ Parimet Ndërkombëtare mbi Pavarësinë dhe Përgjegjshmërinë e Gjyqtarëve, Juristëve dhe Prokurorëve: ICJ Udhëzuesi për Praktikuesit, Nr. 1, faqe 38.

² Parimi 10.

Po kështu, Karta Universale e Gjyqtarit³ përcakton:

Përzgjedhja dhe çdo emërim i një gjyqtari duhet të bëhet në përputhje me objektivat dhe kriteret transparente bazuar në kualifikimin e duhur profesional.⁴

1.2 Gjyqtari, sipas Ligjit për Organizimin Gjyqësor (LOGJ), (neni 11/d) duhet të ketë “cilësi të larta morale”. Ky përcaktim, duke qenë se kemi të bëjmë me një kërkesë ligjore, presupozon që organet shtetërore të përfshira në procesin e emërimit, duhet të vlerësojnë nëse kandidati për gjyqtar e plotëson këtë kriter ose jo. Për të përmbushur këtë detyrim, këto organe, së pari, duhet të kenë një kuptim të qartë për konceptet ligjore. Në ligj nuk e gjejmë një përkufizim për konceptin “cilësi të larta morale”. Gjithashtu, një shpjegim dhe zberthim të kësaj kërkesë ligjore nuk e kemi hasur as në jurisprudencë.⁵

1.3 Nuk ka, gjithashtu, as edhe ndonjë akt të Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD) që të japë një përkufizim të “cilësive të larta morale” të gjyqtarëve. KLD ka ngritur një grup pune dhe është duke punuar në lidhje me përmirësimin e procedurave për lëvizje në karrierë të gjyqtarëve dhe një nga pikat e diskutuara këtu është edhe përcaktimi i një mënyre se si të evidentohen “Cilësitë e larta morale të gjyqtarëve”.

1.4 Sipas Kryetares së Shoqatës së Gjyqtarëve të Shqipërisë (ShGjSh), cilësitë e larta morale të gjyqtarëve lidhen me integritetin e gjyqtarit, veprimtarinë e tij personale për të qenë i drejtë, i ndershëm, i pakorruptueshëm, duke zbatuar me korrektësi dhe përkushtim maksimal detyrën e tij në shërbim të dhënies së drejtësisë.

ShGjSh e ka komentuar mungesën e përcaktimit të kriterëve në përcaktimin e cilësive të larta morale të gjyqtarëve që në kohën kur LOGJ ishte ende projekt, duke e evidentuar këtë si mangësi të tij.

³ Aprovuar nga Këshilli Qendror i Shoqatës Ndërkombëtare të Gjyqtarëve më 17 nëntor 1999.

⁴ Neni 9.

⁵ Aktualisht, në Gjykatën Kushtetuese është në proces shqyrtimi një kërkesë e 1/5 së deputetëve për interpretimin e disa neneve të Kushtetutës, në të cilën, ndër të tjera, përfshihet dhe kërkesa për interpretimin e kushteve të meritës që duhet të plotësojnë gjyqtarët kushtetues dhe ata të Gjykatës së Lartë. Gjykata Kushtetuese nuk është shprehur ende për këtë kërkesë.

1.5 KLD në Vendimin nr. 247/2, datë 16.02.2011 “Për organizimin dhe funksionimin e komisionit të shqyrtimit të kandidatëve për gjyqtarë”, rregullon procesin e emërimit të kandidatëve për gjyqtarë në gjykatat e shkallës së parë dhe gjykatën e apelit. Në këtë vendim është parashikuar ngritja dhe funksionimi i një komisioni të quajtur Komisioni i Shqyrtimit të Kandidatëve për Gjyqtarë, i përbërë nga 7 anëtarë⁶. Procedura për plotësimin e vendeve vakante të shpallura publikisht është e parashikuar në nenin 28 të Ligjit “Për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, dhe zhvillohet si për emërimet e reja, edhe për transferimet e gjyqtarëve.

KLD fillimisht verifikon kandidatët që plotësojnë kriteret ligjore⁷ për tu emëruar gjyqtarë. Dhe për secilin kandidat që çmohet se plotëson kriteret ligjore, Komisioni evidenton më tej treguesit e mëposhtëm:

- a) rezultatet e përfundimit të studimeve universitare e pasuniversitare;
- b) vjetërsia si jurist;
- c) treguesit e punës;
- d) trajnimet apo specializimet e ndryshme;
- e) të dhëna për studime të kryera apo botime në fushën juridike;
- f) të dhëna për qëndrimin moral;
- g) të dhënat për masa disiplinore;
- h) çdo të dhënë tjetër që tregon epërsi të kandidatit përkatës, ndaj kandidatëve të tjerë.

Kandidatët e sapo diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës, në varësi të renditjes sipas rezultateve në përfundim të Shkollës së Magjistraturës, duhet të plotësojnë një formular të veçantë, ku të shprehin zgjedhjen e propozuar prej tyre për vendet vakante në dispozicion, të caktuara me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

⁶ Neni 1 i vendimit nr. 247/2, datë 16.02.2011: a) Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, b) Ministri i Drejtësisë ose një përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, në nivel jo më të ulët sesa pozicioni administrativ/drejtues Drejtor Drejtorie, c) Tre anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë të zgjedhur nga Konferenca Kombëtare Gjyqësore, d) Një anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë i zgjedhur nga Parlamenti, e) Kryeinspektor i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

⁷ Neni 11 i ligjit Nr. 9877, datë 18.02.2008, “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”

Nuk ka ndonjë udhëzues të shkruar se si menaxhohen aplikantët konkurrues nga gjyqtarët në detyrë. Përdorimi i sistemit të vlerësimit të performancës, kur të vihet në funksionim, duhet të jetë veçanërisht relevant në diferencimin e cilësisë së kandidatëve, i njëjtë me notat e renditjes akademike të të diplomuarve të Shkollës së Magjistraturës.

1.6 Në lidhje me preferencën për të diplomuarit e Shkollës së Magjistraturës, ata zakonisht prezumohen të jenë gjyqtarë të mirë dhe trainimi i tyre reflektohet në cilësinë e vendimeve të tyre. Duke u dhënë atyre prioritet në emërim mbi kandidatët e jashtëm, mund të jetë e përshtatshme në mënyrë që të rritet investimi i bërë në trainimin e tyre dhe për t'i motivuar ata për të marrë nota të mira. Mund të jetë brenda praktikave europiane, megjithatë duhet të vihet re që shumë shtete kanë gjithashtu një metodë të njëanshme të hyrjes së gjyqtarëve dhe kjo mundësi nuk duhet përjashtuar plotësisht edhe për Shqipërinë.

1.7 Pjesë e procedurës së përzgjedhjes së kandidatit për gjyqtar është edhe testimi profesional. Në nenin 7 të Vendimit të KLD thuhet: 1. Pas verifikimit të kandidatëve që plotësojnë kriteret ligjore, Komisioni, kur e çmon të nevojshme, zhvillon testimin profesional të tyre. 2. Testimi bëhet duke komunikuar personalisht me kandidatin, duke e intervistuar ose duke marrë prej tij materiale të shkruara gjatë testimit ose më parë.

1.8 E njëjta procedurë përzgjedhjeje është edhe për kandidatët për në Gjykatën e Apelit⁸. Në lidhje me transferimin e gjyqtarëve të apelit, vendimi i KLD parashikon që: Gjyqtarët që kërkojnë të transferohen nga njëra gjykatë apeli në tjetrën, nuk i nënshtrohen testimit⁹. Komisioni bën renditjen e kandidatëve, bazuar në Vendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr. 269/2, datë 27/09/2010 “Për rregullat e hollësishme për sistemin e pikëzimit të detyrueshëm për zbatim, në rastin e përzgjedhjes së kandidatëve për plotësimin e vendeve vakante në gjykatat e apelit dhe gjykatat për krime të rënda.” Pas procedurës së vlerësimit apo dhe testimit, Komisioni bën një propozim konkret për vlerësimin përfundimtar, në lidhje me transferimin dhe emërimin e gjyqtarëve¹⁰. Dhe faza e fundit e

⁸ Neni 8 dhe neni 9 i Vendimit të KLD.

⁹ Neni 9/2 i Vendimit.

¹⁰ Neni 9/3 i Vendimit.

sistemit të përzgjedhjes së një kandidati për në gjykatën e apelit është shqyrtimi i propozimit të arsyetuar të Komisionit, në mbledhjen e Këshillit të Lartë të Drejtësisë¹¹.

1.9 Krahasuar me gjyqtarët në detyrë¹², për kandidatët e jashtëm, Komisioni ka shumë pak informacion. Nuk ka një praktikë vendase për marrjen e referencave nga punonjës të mëparshëm si në të shkruar apo në formë verbale dhe Komisioni nuk e bën këtë gjë. Pavarësisht detyrimit ligjor për të kryer një testim profesional të të gjithë kandidatëve, në vendimin e KLD për Komisionin e Shqyrtimit të Kandidatëve për Gjyqtarë kërkohet që Komisioni të kryejë një testim të tillë vetëm “kur çmohet e nevojshme”, dhe atëherë përjashton nga ky proces të diplomuarit nga Shkolla e Magjistraturës dhe gjyqtarët në detyrë që kërkojnë transferim.

1.10 Praktikisht, Komisioni nuk ka kryer asnjë lloj intervistimi, me të shkruar apo forma të tjera. As KLD nuk ka miratuar ndonjë mënyrë sesi të vlerësojë aplikimet për transferim nga gjyqtarët në detyrë ndaj kandidatëve nga të diplomuarit e Shkollës së Magjistraturës, apo aplikimet brenda gjyqësorit kundër njëri-tjetrit. Po kështu, nuk është miratuar ndonjë kriter për vlerësimin e përshtatshmërisë së kandidatëve për pozicionet e Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit të Gjykatës.

1.11 Në përputhje me rrethanat, Komisioni nuk i rendit kandidatët, por i paraqitet KLD-së një listë alfabetike e kandidatëve, që sipas Komisionit, plotësojnë kushtet, dhe një listë e atyre që nuk plotësojnë këto kriterë. Vetë KLD, nuk ka zhvilluar procedura apo praktika për mënyrën e diskutimit për kandidaturat.

1.12 Presidenti i Republikës nuk merr pjesë në diskutimet e KLD-së për emërimin dhe nuk voton për këto çështje, pasi ai merr vendime për dekretimin. KLD i propozon emërimet Presidentit (përveç rasteve kur KLD ka të drejtën përfundimtare të emërimit), dhe nëse ai është dakort, emërimet bëhen me dekrete të Presidentit. Miratimi i Presidentit nuk është formal dhe faktikisht gjatë viteve të fundit Presidenti ka refuzuar shumë propozime të KLD, duke kërkuar më tepër të dhëna ose edhe pa dhënë arsye në refuzimin e tij.

¹¹ Neni 9/4 i Vendimit.

¹² Neni 4 pika 2 e Vendimit: Kërkesat për emërim nga kandidatë të cilët ushtrojnë detyrën e gjyqtarit, shoqërohen me një kopje të përditësuar të Formularit Personal të Konkurruesit për Plotësimin e Vendit Vakant për Gjyqtar.

1.13 Në vitin 1999, KLD ngriti një sistem të vlerësimit të performancës nën Ligjin për Pushtetin Gjyqësor, i cili u zbatua në vitin 2002, por nuk arriti parashikimet dhe u braktis formalisht nga KLD-ja në vitin 2003. Që atëherë, KLD-ja është mbështetur në zhvillimin e një sistemi të ri nga një grup ekspertësh europianë brenda kuadrit të programit të përbashkët të Këshillit të Europës dhe Komisionit Europian për funksionimin efektiv të sistemit gjyqësor në Shqipëri. KLD-ja është angazhuar gjerësisht në ecurinë e sistemit të ri, me tre nga anëtarët e saj të përfshirë në proces së bashku me Kryetarin e Inspektoratit të tij dhe anëtarë të tjerë të stafit. Ministria e Drejtësisë është përfshirë gjithashtu në takimet mbi subjektin.(shih në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij raporti një përmbledhje të shkurtër për Historikun i sistemit të vlerësimit).

1.14 Me qëllim që të sigurohet zbatimi i parimit të administrimit të mirë, transparencës dhe barazisë në vlerësimin e gjyqtarëve, është parashikuar krijimi i dosjes personale, që përmban të gjithë të dhënat dhe informacionin profesional mbi karrierën e gjyqtarit. Drejtoria e burimeve njerëzore pranë KLD-së mban një dosje personeli për çdo gjyqtar, duke përfshirë informacionin profesional dhe personal në të. Disa nga informacionet sigurohen gjatë procesit të emërimit. Njoftimet për vendet e reja vakante nga KLD-ja, u kërkojnë aplikantëve të japin informacion të gjerë mbi kualifikimet dhe eksperiencat, veçanërisht gjyqtarët në detyrë që iu është dashur të plotësojnë të dhëna statistikore e të tjera mbi ngarkesën e tyre të punës. KLD-ja nuk ka informacionin e plotë mbi çdo gjyqtar. Disa gjyqtarë nuk iu janë përgjigjur kërkesave për plotësimin e informacioneve dhe dokumenteve të munguara. Për të zgjidhur këtë problem, KLD ka nxjerrë një vendim mbi “Për evidentimin e të dhënave për gjyqtarët”.¹³

1.15 Propozimi i paraqitur për ruajtjen e këtyre dosjeve është bërë me qëllimin që të dhënat për të gjithë gjyqtarët të administrohen rregullisht dhe të përdoren në vlerësimin e performancës së gjyqtarëve dhe për çështje të tjera lidhur me etikën dhe karrierën gjyqësore.¹⁴ Vendimi deklaroi

¹³ Vendim nr.177 (2), dt 16 Qershor 2005. Ky vendim hyri në fuqi më 15 Shtator 2005.

¹⁴ Neni 2 i Vendimit.

gjithashtu që KLD-ja nuk do të pranojë asnjë kërkesë për transferim, largim apo mungesë, ose trainim nëse gjyqtari në fjalë nuk ka plotësuar dosjen në përputhje me parashikimet e Vendimit. Ndërkohë që vendimi duket sikur rregullon vetëm praktikat administrative të KLD-së, ai gjithashtu kërkon të rregullojë proceset e transferimit dhe promovimit duke kufizuar të drejtën për të aplikuar për pozicione, efektivisht duke shtuar kriteret që nuk janë në Ligjin për Pushtetin Gjyqësor. Është e diskutueshme jo ligjërishit e lejueshme që KLD-ja të veprojë kështu duke përdorur si mjet Vendimin. Një mënyrë më e përshtatshme për të menaxhuar këtë mund të jetë nëpërmjet rregullores së KLD-së, duke specifikuar dokumentat e kërkuara për t'u plotësuar në çdo aplikim për një pozicion gjyqësor.

1.16 Nga personat e kontaktuar në KLD bëhet me dije se aktualisht në dosjen e çdo gjyqtari nuk gjenden të përfshira dokumente që të përkufizojnë cilësitë e larta morale të gjyqtarëve, përse kohë ato nuk janë vlerësuar dhe është ende e paqartë mënyra e identifikimit të tyre nga KLD-ja.

1.17 Një ndër problemet themelore përse i përket promovimit dhe transferimit është se KLD nuk ka zhvilluar deri më tani një proces objektiv dhe transparent për emërimin në përgjithësi. Mungesa e kriterëve objektivë dhe procedurave formale ka lejuar që procesi i transferimit dhe promovimit të dominohet nga faktorë tradicionalë të kontakteve politike dhe personale.

1.18 Mënyra se si KLD duhet të veprojë me transferimet dhe promovimet, ngre një numër pyetjesh në lidhje me prioritetet dhe kriteret e konkurrimit. Si duhet të vendosë KLD ndërmjet një gjyqtari që ka kaluar shumë kohë në postin e tij dhe një gjyqtari që është vlerësuar “shumë mirë” në procesin e vlerësimit të performancës? A duhet që vetëm rezultatet e vlerësimit të diktojnë prioritetin apo duhet të konsiderohen dhe faktorë të tjerë? Çfarë efekti duhet të kenë masat disiplinore të mëparshme në të drejtën për të aplikuar për pozicione?

2. Standardet etiko-morale për gjyqtarin e krimeve të rënda

2.1 Sipas Ligjit Nr.9110, datë 24.7.2003 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave për Krime të Rënda” gjyqtari i krimeve të rënda emërohet në këtë detyrë për një periudhë të caktuar kohe, 9 vjet me të drejtë riemërimi. Neni 3/2/3 i ligjit thotë: Kandidaturat për vendet vakante në gjykatat

për krime të rënda dhe në gjykatat e apelit për krime të rënda, shqyrtohen nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe vendimi për t'i propozuar Presidentit të Republikës emërimin e tyre, merret me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të këtij Këshilli. Me kërkesën e tyre dhe propozimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, gjyqtarët e gjykatave për krime të rënda dhe të gjykatave të apelit për krime të rënda, mund të rëmërohen në këtë detyrë.

2.2 Ligji rregullon edhe kriteret që kërkohen në emërimin e një gjyqtari të krimeve të rënda. Me miratimin e ligjit të ri për pushtetin gjyqësor, të vitit 2008 ka një nen të posaçëm që përcakton kriteret për emërimin e gjyqtarëve të kësaj gjykate. Gjyqtari i gjykatës për krimet e rënda emërohet nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në bazë të konkurrimit me jetëshkrime, pasi:

- a) të ketë punuar jo më pak se 5 vjet në gjykatat e shkallës së parë;
- b) të jetë dalluar për aftësi profesionale dhe cilësi të larta etiko-morale;
- c) të jetë vlerësuar “Shumë mirë” për aftësi profesionale dy herët e fundit;
- ç) të mos ketë masë disiplinore në fuqi.¹⁵

2.3 Pra nga sa shihet nga kriteret e përcaktuara në ligj, cilësitë e larta etiko-morale janë të rëndësishme dhe përcaktuese në emërimin e një gjyqtari të krimeve të rënda por të dhënat e marra në KLD në lidhje me vlerësimin e tyre nuk janë premtuese përse kohë KLD nuk ka zbatuar ende një sistem vlerësimi për gjyqtarët e krimeve të rënda. Sikurse u përmend në çështjet më lart sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve është një vendim i miratuar vetëm vitin e kaluar dhe zbatimi i tij ka nisur vetëm në një gjykatë të vendit deri më tani.

2.4 Siç u përmend dhe më lart, KLD-ja nuk ka ende një përcaktim të asaj se çdo kuptuar me cilësi etiko-morale të gjyqtarëve dhe për rrjedhojë nuk ka një përcaktim specifik në lidhje me vlerësimin e cilësive dhe aftësive morale të tyre. Në procesin e emërimeve të gjyqtarëve të gjykatës së krimeve të rënda por edhe në Gjykatën e Apelit Tiranë gjatë kohës kur kryetari i KLD-së ka qenë ish Presidenti Alfred Moisiu janë refuzuar disa kandidatūra të propozuara nga KLD-ja edhe pa shpjeguar refuzimin e bërë. Gjatë këtij procesi Presidenti i Republikës ka vlerësuar aspektet morale dhe etike,

¹⁵Neni 12/2 i Ligjit për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor të 2008.

duke marrë informacion nga institucionet shtetërore, por pa i bërë publike motivet e refuzimit. Ka opinione që e kanë vlerësuar pozitivisht këtë rol të Presidentit, por ka edhe zëra që e konsiderojnë jo të drejtë mosbërjen publike të motiveve të refuzimit. “Presidenti u kërkoi strukturave të KLD-së që për kandidaturat e tjera të zhvillohet një proces më i hapur dhe publik ku të krijohet mundësia për më tepër transparencë si dhe një informacion më të plotë lidhur me profilin e secilit kandidat për gjyqtar për krimet e rënda. E gjitha kjo, do t’i shërbejë zgjedhjes së individëve më të mirë, më të përkushtuar dhe më me integritet moral për dhënien e drejtësisë”, thuhet në njoftimin për shtyp të Presidencës. Kjo është hera e parë që Presidenti Moisiu rrëzon në mënyrë të pjesshme një vendim të KLD-së¹⁶.

2.5 Rreth 70 % e kandidatëve të propozuar për gjyqtarë janë refuzuar nga ish Presidenti Alfred Moisiu, disa për arsye të arritjeve profesionale dhe të tjerë për shkaqe etike që lidheshin me personalitetin e tyre individual. Filtrat e verifikimit të figurës së një gjyqtari për ish Presidentin përmenden: 1- ecuria profesionale e kandidatit për gjyqtar, ku përmenden rastet e prishjes së vendimeve të tyre nga gjykatat më të larta, numri i vendimeve të lëna në fuqi, cilësia e vendimeve të tyre. Gjithashtu në këtë pikë përmenden edhe mjaft raste kur largimi i një gjyqtari nga gjykata ku ai ishte aktualisht për në një gjykatë tjetër do të sillte probleme me mbarëvajtjen e punës në gjykatë edhe për shkak të vakumit që mund të krijohet me largimin e tij; 2- reagimi dhe opinioni qytetar ndaj një kandidati për gjyqtar ku përmenden letrat e ankesave të qytetarëve në Presidencë dhe KLD për ta, ecuria e verifikimit të ankesës së bërë nga inspektorati i KLD deri në fazën e procedimit disiplinor nga KLD dhe vendosur nga Gjykata e Lartë; 3- shkrimet në shtyp dhe media; 4- informacion i marrë nga institucione të specializuara shtetërore mbi figurën e një gjyqtari si p.sh nga ShISH.¹⁷

¹⁶ Marrë nga shtypi i kohës, 24.12.2003.

¹⁷ Informacion i marrë nga intervista me këshilltarin juridik të Presidentit të Republikës.

3. Kodi i Etikës Gjyqësore

3.1 Në vitin 1994 u krijua Shoqata e Gjyqtarëve të Shqipërisë. Menjëherë pas krijimit të saj, kjo shoqatë miratoi Kodin e Etikës Gjyqësore, në të cilin u përcaktuan rregullat e sjelljes së gjyqtarëve në punë e jashtë saj, duke synuar në forcimin e besimit të publikut te gjykatat dhe për të siguruar një sjellje të përshtatshme nga gjyqtarët në përputhje me rëndësinë e funksionit të tyre dhe përgjegjësitë që rrjedhin prej tij. Ky Kod hyri në fuqi më 12.03.1994.

3.2 Konferenca Gjyqësore, e krijuar si një organ kushtetues, bazuar në nenin 147/1 të Kushtetutës të vitit 1998, më 5.12.2000 miratoi Kodin e ri të Etikës Gjyqësore, që është ende në fuqi. Kodi paraqet një tërësi rregullash që vetë gjyqtarët kanë rënë dakort t'i binden, në funksion të realizimit të drejtësisë dhe funksionit të pushtetit gjyqësor në përputhje me Kushtetutën. Ky Kod ka ngarkuar Komisionin Disiplinor si organ që do të shqyrtojë rastet e shkeljeve të parimeve etike dhe Këshillin Ekzekutiv, si organ që do të trajtojë dhe do të vendosë për përgjegjësinë e tyre. Këto dy organe janë pjesë e strukturës së Konferencës Gjyqësore. Këshilli Ekzekutiv nuk ka përcaktuar në mënyrë të shkruar një procedurë, sipas së cilës do të shqyrtohen rastet e shkeljes së Kodit Etik dhe për përgjegjësinë përkatëse të gjyqtarit. Nuk ka informacion nëse këto organe kanë patur raste të shqyrtimit të shkeljeve të parimeve etike nga gjyqtarë të caktuar. Bazuar në praktikat e mira europiane, do të ishte më mirë që këto organe të merreshin me shpjegimin dhe interpretimin e Kodit Etik dhe jo me marrjen e masave disiplinore.

3.3 Kodi Etik nuk duhet të konsistojë në rregulla disiplinore, ai është një instrument vetërregullues i 'prodhuar' nga vetë gjyqësori. Tradita gjyqësore kontinentale mbështet fuqishëm idenë e kodifikimit. Shumë vende, tashmë, kanë miratuar kode të sjelljes në sektorin publik (polici), në profesionet e lira (avokat, doktor) dhe në sektorin privat (media). Kode të etikës janë propozuar kohët e fundit për gjyqtarët, veçanërisht në vendet e Europës lindore, duke ndjekur shembullin e SHBA-së. Kodi Italian është miratuar në vitin 1994 nga shoqata e gjyqtarëve italianë, një organizatë profesionale e gjyqtarëve. Vende të tjera si Estonia, Lituania, Moldova, Sllovenia, Çekia dhe Sllovakia, kanë një "kod gjyqësor të etikës" ose "parime të sjelljes", të miratuar nga asambltetë e gjyqtarëve dhe të ndara nga rregullat disiplinore.

3.4 Kodet e sjelljes kanë disa përfitime të rëndësishme: së pari, ato i ndihmojnë gjyqtarët të zgjidhin çështjet e etikës profesionale, duke i dhënë atyre autonomi në procesin e tyre vendimmarrës dhe garantojnë pavarësinë e tyre nga autoritetet e tjera; së dyti, ato informojnë publikun rreth standardeve të sjelljes që ata kanë të drejtë të presin nga gjyqtarët; së treti, ato kontribuojnë për t'i dhënë siguri publikut se drejtësia administrohet në mënyrë të pavarur dhe të paanshme.

3.5 Sidoqoftë, pavarësia dhe paanshmëria nuk mund të ruhen vetëm nga parimet e sjelljes. Standardet e sjelljes profesionale janë të ndryshme nga rregullat ligjore dhe disiplinore. Ato shprehin aftësinë profesionale për të reflektuar funksionimin e tyre në përputhje me vlerat e pritshme nga publiku si reagim/detyrim plotësues ndaj pushtetit që i është veshur (mirëbesuar). Këto janë standarde vetërregulluese, të cilat përfshijnë njohjen se zbatimi i ligjit nuk është një ushtrim mekanik, por përfshin pushtete diskrecionare të vërteta dhe i vendos gjyqtarët në marrëdhënie përgjegjshmërie me vetveten dhe kundrejt qytetarëve.

3.6 Kodet e sjelljes profesionale krijojnë gjithashtu një sërë problemesh. Për shembull, ato mund të krijojnë idenë se ato përmbajnë të gjitha rregullat dhe se çdo gjë që nuk ndalohet duhet të jetë e lejuar. Ato priren të mbithjeshtëzojnë situatat dhe, së fundi, ato krijojnë përshtypjen se standardet e sjelljes janë të fiksuara për një periudhë kohe, ndërsa ato duhet të zbatohen në mënyrë të vazhdueshme.

3.7 Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Europianë mbështet hartimin e deklaratave të sjelljes profesionale (KKGJE) (Opinion nr. 3 i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Europianë(KKGJE) drejtuar Këshillit të Ministrave të Këshillit të Europës mbi parimet dhe rregullat që rregullojnë sjelljen profesionale të gjyqtarëve, kryesisht ato etike, sjelljet e papërshtatshme dhe të pabarabarta, Strasburg, 19 Nëntor 2002).

Sipas KKGJE, për të ruajtur garancitë e nevojshme të pavarësisë së gjyqtarëve, çdo deklaram i standardeve të sjelljes profesionale duhet të mbështetet në dy parime themelore:

i) Së pari, ky dokument duhet të adresojë parimet bazë të sjelljes profesionale. Ai duhet të njohë pamundësinë e përgjithshme për të përfshirë një listë të plotë aktiviteteve e paracaktuara, të cilat do të ishin të ndaluara për gjyqtarin; standardet/parimet e vendosura duhet të shërbejnë

si instrumente vetërregulluese për gjyqtarët, rregulla të përgjithshme që drejtojnë veprimtarinë e tyre. Për më tepër, megjithëse ka një mbivendosje dhe ndërthurje/ndërveprim, parimet nuk duhet ato vetë të përbëjnë shkelje disiplinore ose shkelje civile ose penale.

ii) Së dyti, parimet e sjelljes profesionale duhet të hartohen nga vetë gjyqtarët. Ato duhet të jenë instrumente vetërregulluese të gjeneruara nga vetë gjyqësori, duke e aftësuar autoritetin gjyqësor të arrijë/fitojë legjitimitet nëpërmjet operimit brenda një kuadri përgjithësisht të pranuar të standardeve etike. Duhet të organizohet konsultim i gjerë, mundësisht nën kujdesin e një autoriteti autonom (shih paragrafin 29 të Opinioneve të KKGJE), të krijuar nga vetë gjyqtarët, i cili mund të jetë gjithashtu dhe përgjegjës për të shpjeguar dhe interpretuar deklaratat e standardeve të sjelljes profesionale.

4. Betimi i gjyqtarit dhe respektimi i rregullave të etikës profesionale

4.1 Teksti i betimit të gjyqtarit ka këtë përmbajtje: “Betohem solemnisht se gjatë kryerjes së detyrës do t’i qëndroj kurdoherë besnik Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjeve në fuqi dhe do të respektoj rregullat e etikës profesionale”¹⁸. Në këtë moment prezumohet se gjyqtari është i vetëdijshëm për përmbajtjen e rregullave të etikës profesionale. Por, ka një paqartësi përse i përket këtyre rregullave etike: formula e betimit i referohet rregullave etike të miratuara nga Konferenca Gjyqësore apo rregullave etike të përcaktuara në ligjin për organizimin gjyqësor?

4.2 Do të ishte më mirë që këto rregulla etike duhet të jenë të përcaktuara ose “të kodifikuara” në një dokument i cili të jetë i disponueshëm jo vetëm për gjyqtarët por edhe për publikun. Kjo do të krijonte një lloj sigurie dhe qartësie përse i përket përgjegjësisë dhe detyrimeve etike që gjyqtari merr përsipër në momentin e betimit. Do të ishte e përshtatshme që një përmbledhje e të gjitha rregullave etike të ishte në tavolinën e çdo gjyqtari dhe e ekspozuar në vendet publike në ambientet e gjykatave.

¹⁸ Neni 15/1 e LOGJ.

4.3 Sipas KLD-së rregullat e etikës së gjyqtarëve janë ato të përcaktuara në Kodin e Etikës Gjyqësore të miratuar nga Konferenca Gjyqësore në vitin 2004. Ndërkohë që një tjetër perceptim në lidhje me rregullat e etikës gjyqësore dhe se ku mund të gjenden ato kanë vetë gjyqtarët. Sipas ShGJSh rregullat e etikës së gjyqtarëve janë të shpërndara në disa ligje dhe akte si: Kushtetuta, LOGJ, Kodi i Procedurave, Karta Europiane për Statusin e Gjyqtarit si dhe Konventa për të drejtat e njeriut (pjesa e gjyqësorit) si dhe vendimet e KLD-së.

4.4 Nuk ka një botim të veçantë të përfshijë të gjitha rregullat e etikës profesionale. Nga intervistat e kryera në KLD dhe në Shoqatën e Gjyqtarëve rezulton që gjyqtarët prezumohen që duhet t'i njohin këto rregulla por ata nuk referohen lehtësisht se ku janë të fiksuara këto rregulla.

4.5 Për KLD-në nuk ka një informacion më shumë në këtë çështje. Për gjyqtarët këto rregulla njihen përsa kohë ato janë në funksion të punës dhe aktivitetit tyre të përditshëm, sigurisht dhe të vlerësimit që i bëhet gjyqtarëve në aktivitetin e tyre. Por, sërish ngrihet pyetja se a janë vlerësuar realisht gjyqtarët në këtë aspekt?

4.6 Publiku e ka të vështirë për të aksesuar rregullat e etikës profesionale për faktin siç e thamë edhe më sipër sepse këto rregulla nuk janë të përmbledhura në një dokument të vetëm. KLD nuk disponon një informacion nëse publiku është i informuar për ekzistencën e këtyre rregullave. Në gjykatë¹⁹ nuk ka një vend ku të jenë ekspozuar këto rregulla publikisht.

4.7 Ndërkohë, që prej 30 shtatorit 2010 ka një Rregullore “Për marrëdhëniet e gjykatës me publikun”, e miratuar me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë nr. 6777/5. Kjo Rregullore është një rregullim normativ për gjykatat e shkallës së parë dhe të Apelit, për mënyrën se si konceptohet dhe mbahet marrëdhënia e gjykatës me publikun. Në kuadër të informimit të publikut me këtë akt, Gjykata e Tiranës në janar 2011, në një prezantim me median, bëri publike Rregulloren me anë të një botimi të titulluar: Udhëzues praktik për zbatimin e Rregullores “Për marrëdhëniet e gjykatës me publikun”.

¹⁹ Nga vëzhgimi i kryer në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

4.8 Rregullorja përcakton konceptin e marrëdhënies së gjykatës me publikun, e cila përfshin respektivisht: 1- transparencën e veprimtarisë së gjykatës, 2- komunikimin efikas të gjykatës me publikun dhe 3- dhënien e informacionit mbi dokumentat zyrtare në gjykatë. Në këtë rregullore janë shpjeguar dhe dhënë një informacion për qytetarët mbi rolin dhe funksionin e disa prej pozicioneve të zyrtarëve në gjykatë si kryetari, kancelari dhe zyra e marrëdhënieve me publikun. Rregullorja ndalet gjatë në organizimin dhe funksionimin e Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun në gjykatë në funksion të aksesit publik në proceset gjyqësore dhe lehtësimit të pjesëmarrjes së tyre në të. Në rregullore nuk janë të përcaktuara standardet etike të gjyqtarëve dhe se çfarë duhet t'i ofrohet publikut në lidhje me këtë.

5.Papajtueshmëria e funksionit të gjyqtarit me veprimtari të tjera

5.1 Sipas Ligjit për Organizimin Gjyqësor, gjyqtari nuk mund të ushtrojë asnjë veprimtari tjetër shtetërore, private, ose politike (LOGJ, neni 22). Ligji synon të shmangë konfliktin e interesave që mund të krijohet ndërmjet detyrës që kryen gjyqtari me veprimtari të tjera të tij, si shtetërore ashtu dhe private. Interesat e drejtësisë dhe ruajtja e besimit të publikut i imponojnë gjyqtarit disa kufizime, si garanci për ushtrimin e detyrës me paanshmëri. Këtij qëllimi i shërbejnë edhe këto kufizime: Gjyqtari ndalohet të marrë pjesë në administrimin apo drejtimin e shoqërive tregtare, personalisht ose me anë përfaqësimi (LOGJ, neni 23/1/b); Gjyqtari ndalohet të jetë ekspert ose arbitër në arbitrazh. (LOGJ, neni 23/1/c).

5.2 Në rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të KLD-së, në nenin që përcakton detyrat e këtij institucioni parashikohet që inspektorati verifikon dhe vë në dukje çështjet që lidhen me pajtueshmërinë e veprimtarisë së gjyqtarëve në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligj²⁰. Nga informacioni i marrë në KLD, rezulton se ky institucion, për të kontrolluar respektimin e rregullave të papajtueshmërisë, ushtron kontrollë ndaj gjyqtarëve vetëm mbi bazën e ankesave të qytetarëve ose të një shqetësimi publik. Nuk ka raste që të ketë kryer kontrollë kryesisht në këtë aspekt.

²⁰ Neni 21/8 i Rregullores për Inspektoratin e KLD-së.

5.3 Nga të dhënat zyrtare të marra në KLD nuk rezulton asnjë rast për këtë kategori papajtueshmërie të gjyqtarit në detyrë, të jetë verifikuar nga Inspektorati i KLD-së dhe as ndonjë praktikë që mund të jetë çuar për shqyrtim në mbledhjen e KLD-së.

5.4 KLD nuk ka bërë asnjë interpretim të kuptimit “veprimtari tjetër private”, ata i referohen për këtë vetëm gjuhës së ligjit. Në aktivitetin institucional të KLD-së, ky institucion zbërthen kuptimin e një shkeljeje (veprim/mosveprim) të kryer nga gjyqtari kur ka raste konkrete dhe kur është marrë masë disiplinore ndaj gjyqtarit. Kuptimi në raste të tilla jepet në vendimin e arsyetuar të KLD-së.

5.5 Nga informacioni i marrë në KLD, ky institucion është duke përgatitur një udhëzues, bazuar në standardet dhe eksperiencat e sistemeve të ngjashme të drejtësisë, lidhur me mundësinë e gjyqtarëve për të kryer veprimtari mësimdhënëse.

5.6 Gjyqtari ndalohet të bëjë pjesë në parti politike ose të marrë pjesë në veprimtari me karakter politik. (LOGJ, neni 23/1/a) Nuk ka praktikë se si kontrollohet ky kufizim në funksionin e gjyqtarit. Nuk ka raste të konstatimit të shkeljes së kësaj ndalese.

5.7 A mundet gjyqtari të bëjë deklarata publike që kanë ndikim politik? Sipas opinionit të marrë në KLD, ligjvënësi nuk është shprehur në mënyrë specifike për deklarata që kanë ndikim politik, por gjyqtari duhet ta distancojë veten nga të tilla qëndrime. Pavarësisht se gjyqtari është një shtetas me të drejtë për të pasur bindje politike të caktuara, ai është edhe një funksionar publik të cilit i kërkohet të reflektojë paanshmëri dhe pavarësi gjatë ushtrimit të detyrës. Për rrjedhojë, ai nuk duhet të bëjë deklarata publike që kanë ndikim politik pasi një fakt i tillë çënon paanshmërinë e tij si gjyqtar dhe interpretohet si pjesëmarrje në veprimtari me karakter politik, meqënëse ai po shprehet dhe/apo merr pjesë në një veprimtari që ka karakter politik.

5.8 Gjyqtari ndalohet të bëjë deklarata në publik në lidhje me proceset (LOGJ, neni 23/1/ç), të bëjë të ditur mendimet që janë dhënë gjatë seancave të gjykimit, që akoma nuk kanë marrë formën e një vendimi (LOGJ, neni 23/1/d) si dhe të bëjë deklarata në publik për çdo gjë tjetër që çënon paanshmërinë në proces. (LOGJ, neni 23/1/dh). Gjyqtari duhet të ruajë dinjitetin e tij, duke mos lejuar veprime që komprometojnë

profesionin, organet e drejtësisë dhe figurën e tij në shoqëri. (LOGJ, neni 23/2)

Kuptohet, këto ndalesa ligjore, si të gjitha kufizimet e trajtuara më lart, synojnë të ruajnë besueshmërinë dhe pritshmëritë e publikut për paanshmërinë e gjyqtarit. Gjyqtari nuk mjafton të jetë i paanshëm, por ai duhet edhe të duket/të perceptohet si i paanshëm.

5.9 Po përmendim dy raste nga praktika, të cilat mund të shërbejnë si kazuse për diskutim:

Rasti 1: (Procesi Pango vs Top -Channel) Në qershor të 2010 gjyqtarë të gjykatës Tiranë, kanë bërë një deklaratë publike si reagim ndaj komenteve kritike mediatike kundrejt një procesi gjyqësor dhe gjyqtarit të çështjes, ku ishte e përfshirë Top Media. Në deklaratën e lexuar publikisht thuhet: “Gjyqtarët e Tiranës i kërkojnë Top Channel që të ndërpresë veprimet ndaj gjyqtarëve që po gjykojnë këtë çështje. Top Channel po pengon gjyqtarët në përmbushjen e misionit të tyre, që është vendosja e drejtësisë. Ne nuk gjykojmë vendimin, ne gjykojmë fushatën ndaj trupës gjyqësore, që është duke na cenuar në dinjitetin tonë. Top Channel duhet t’i drejtohet Gjykatës së Apelit për të kundërshtuar vendimin e padrejtë të dhënë nga gjykatësi Bendo.” Peticioni ishte nënshkruar nga 37 gjyqtarë nga 59 që ka Gjykata e Tiranës.

Rasti 2: Procesi “Gërdec” është përmendur shumë publikisht në media për shkak të shtyrjeve të njëpasnjëshme të seancave të tij ç’ka çuan edhe në kalimin e afateve procedurale të gjykimit duke sjellë lirimin e të pandehurve që ishin të arrestuar dhe vazhdimin e gjykimit në gjendje të lirë. Por deklaratat për këtë çështje janë bërë institucionalisht nga Gjykata e Tiranës, zyra e marrëdhënieve me publikun. Në total janë bërë nga gjykata 3 deklarata për median në lidhje me procesin. Shkaku ka qenë shtyrjet e seancave që sipas gjykatës ishin mosprezenca e avokatëve në seancë. Deklarata e fundit e bërë nga gjykata është ajo e datës 7.2.2011 pas ndryshimit të masës së arrestit të tre të akuzuarëve kryesorë në “arrest shtëpie”. Edhe në këtë deklaratë Gjykata e Tiranës ripërsërit qëndrimin e saj ndaj vonesave të këtij procesi. Gjykata kërkon moskommentimin e këtij vendimi për interesa politike dhe të tjera.

Në intervistën e kryer në KLD lidhur me çështje të tilla, ky institucion nuk jep asnjë prononcim duke u mjaftuar me shprehjen se nuk ka të dhëna dhe informacione mbi çështje të kësaj natyre.

Ndërsa vetë gjyqtarët ndajnë opinione të ndryshme në lidhje me çështjen. Shoqata e Gjyqtarëve përfaqësuar nga kryetarja e saj pranon se nuk ka qenë dakord me atë qëndrim të një grupi gjyqtarësh të shprehur në peticionin e tyre (rasti 1: Pango vs Top-Channel) dhe për këtë qëllim nuk e ka nënshkruar atë. Sipas saj, gjyqtari duhet të qëndrojë larg qëndrimeve publike dhe komenteve, ligji i ka të parashikuar mjetet e goditjes së një vendimi gjyqësor në shkallët më të larta të sistemit gjyqësor dhe janë të tepërta mënyrat e tilla të reagimit, edhe pse pranon se në shoqërinë tonë, qytetarët nuk kanë një kulturë të mjaftueshme juridike në lidhje me atë sesi duhet të kundërshtohet një vendim gjykate, më konkretisht duke iu drejtuar një gjykate të nivelit më të lartë.

Edhe nga institucioni i Gjykatës së Tiranës u pohua se qëndrimi për këtë çështje ishte i një grupi gjyqtarësh vetëm. Nuk ka një qëndrim institucional, zyrtar në emër të një shoqate në lidhje me këtë. Ishin vetëm një grup gjyqtarësh që ndanë të njëjtin reagim.

Nga intervista e kryer në KLD, debatet e gjyqtarëve për konferencën gjyqësore janë debate të karakterit teknik në lidhje me problemet konkrete juridike dhe jo debate apo shprehje konkrete në lidhje me çështjet në gjykim.

5.10 Gjyqtari ndalohet të bëjë grevë. (LOGJ, neni 23/1/e). Ligji, nëpërmjet këtij kufizimi, nisët nga parimi se funksioni gjyqësor dhe drejtësia janë shërbime jetike të shoqërisë dhe se ato kanë përparësi nga e drejta e gjyqtarëve për të protestuar nëpërmjet grevës për interesat e tyre ekonomike. Gjyqtarët janë të organizuar në shoqata të cilat mbrojnë të drejtat e tyre përballë pushteteve të tjera. Ata kanë edhe disa të drejta të siguruara nga Kushtetuta, të drejta që garantojnë një mbrojtje të përhershme të tyre si imuniteti, palëvizshmëria në detyrë, emërim i përhershëm, e drejta për të mos u ulur përfitimet të gjitha këto janë mjetë në mbrojtje të figurës dhe të drejtave që gjyqtarët kenë në ushtrimin e detyrës së tyre.

6. Përgjegjësia disiplinore/shkeljet që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit

6.1 Gjyqtari ka përgjegjësi disiplinore për shkelje të ligjit dhe për kryerjen e akteve e të sjelljeve që diskreditojnë pozitën dhe figurën e tij, në përputhje me parashikimet e nenit 32 të LOGJ (LOGJ, neni 31/2). Nga informacioni i marrë në KLD dhe me përfaqësues të shoqatës së

gjqtarëve prezumohet se gjyqtarët i njohin ato veprime dhe mosveprime që konsiderohen shkelje për figurën e një gjyqtari dhe për pasojë mund të çojnë në procedimin e tyre disiplinor nga institucioni përkatës. Kjo dijeni e gjyqtarëve është e lidhur me detyrimin e tyre në kuadër të ushtrimit të funksionit të gjyqtarit, për të njohur ligjin dhe zbatuar atë. Ligji për Organizimin Gjyqësor është ligj organik për funksionimin e sistemit gjyqësor dhe gjyqtarët është e prezumuar që janë të njohur me të.

6.2 Për vetë gjyqtarët parashikimi i shumë kategorive të shkeljeve disiplinore dhe shumëllojshmëria e tyre është e tepërt dhe e panevojshme. Ata vlerësojnë se kjo ka rënduar shumë edhe vetë pozitën e gjyqtarit.

6.3 Nuk ka një komentari të këtyre shkeljeve. KLD nuk ka bërë një përmbledhje apo botim ku të jenë të trajtuara teorikisht dhe për arsye studimi kategoritë e shkeljeve disiplinore të gjyqtarëve të parashikuara në Ligjin për Organizimin Gjyqësor. Sipas KLD-së ato vlerësohen rast pas rasti kur i parashtrohet një çështje konkrete për verifikim dhe shqyrtim. Në praktikën e KLD-së përmendet fakti që kur Inspektorati i KLD-së shqyrton një rast të një gjyqtari që gjendet me shkelje gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij gjyqësor dhe për pasojë nis procedura për verifikim ndaj tij, në vendimin e KLD-së për masë disiplinore trajtohet nga pikëpamja kuptimore kjo shkelje.

6.4 Nuk ka përmbledhje të jurisprudencës që lidhet me masat disiplinore. Sipas KLD-së, Ligji për Organizimin Gjyqësor, ku janë të parashikuara këto shkelje, është i ri dhe për pasojë ende nuk ka një praktikë në këtë drejtim dhe për rrjedhojë as përmbledhje të jurisprudencës.

6.5 Nuk ka interpretime të përmbajtjes së këtyre shkeljeve nga KLD, pasi sipas saj në kompetencat e KLD-së nuk është e drejta për të bërë përkufizime abstrakte në kuptimin e dispozitës ligjore por vetëm e drejta për të vendosur nëse një veprim konkret është apo jo shkelje sipas kuptimit të ligjit. Në lidhje me të gjithë kategorinë e shkeljeve dhe parashikimeve që bën ligji i miratuar në 2008, për shkeljet disiplinore të gjyqtarëve KLD thekson se për herë të parë ky ligj ka përcaktuar me saktësi dhe grupuar qartë këto shkelje. Duke u nisur nga fakti se ka ndryshime në këtë legjislacion lind nevoja që të plotësohet kuadri zbatues me vendimet e KLD. Një nevojë e tillë është më e dukshme për faktin se ky ligj duhet të plotësohet dhe me ndryshimet përkatëse për pjesën tjetër të legjislacionit të lidhur, e cila është

bllokuar për shkak të mungesës së shumicës për të miratuar ndryshimet në Kuvend.KLD ka patur si qëllim që në përmirësimet që do t'i bëhen akteve të nxjerra në përputhje me ligjin e ri për pushtetin gjyqësor të pasqyrohen dhe mendimet e faktorëve pjesëmarrës në sistem dhe ekspertëve të huaj duke ngritur për këtë shkak grupe pune për përmirësimin e sistemit.

A. Shkeljet disiplinore dhe praktika e KLD-së

6.6 Gjatë periudhës 2009-2010, nuk janë dhënë masa disiplinore për shkelje shumë të rënda. Nuk është konstatuar në asnjë rast ndaj një gjyqtari një shkelje e tillë.

6.7 Në vitin 2007 KLD-ja ka botuar një përmbledhje shumë të detajuar të gjithë aktivitetit të tij institucional, bazën ligjore, vendimet më të rëndësishme me impakt më të gjerë, kompetencat dhe mënyrën e organizimit të KLD, problematikat e trajtuara me gjykatat, etj. Ky botim u vu në dispozicion të publikut të gjerë, të interesuarve të fushës edhe për qëllime studimore. Ky botim përfshinte periudhën e veprimtarisë 2003-2007. Në këtë botim, në pjesën e bazës ligjore gjen edhe rastet se kur një gjyqtar procedohet disiplinarisht dhe mënyrat se si një qytetar mund të vërë në lëvizje KLD-në në këto raste.

6.8 Nga intervista e kryer në sekretarin e përgjithshëm të Dhomës Kombëtare të Avokatisë, rezulton se avokatët janë të njohur me të gjitha kategoritë e shkeljeve të parashikuara për gjyqtarët në LOGJ, po aq sa janë ata të njohur me gjithë bazën ligjore që drejton procesin gjyqësor në vend. Por problemi sipas tyre është se si konsiderohen vetë këta subjekte të procesit gjyqësor në gjykatë në krahasim me palën tjetër në gjykim, prokurorinë. Sipas tyre ka një ndikim në gjithë këtë, ka një diferencë të theksuar në marrëdhëniet mes palëve në gjykatë, por aq sa ka edhe diferencime mes avokatëve njëkohësisht. Disa trajtohen në mënyrë të drejtë dhe të barabartë e disa jo, çka sjell edhe reagim të dobët dhe indiferent të vetë avokatëve përballë shkeljeve që mund të hasin tek gjyqtarët. Për këtë ata në shumë raste vënë interesin e klientit të tyre mbi interesin e vetë sistemit.

6.9 Në pothuaj të gjitha rastet edhe pse avokatët mund të jenë në dijeni të një rasti që përbën shkelje nga ana e gjyqtarit, avokatët nuk ankohen për arsye ngushtësisht personale të tyre dhe mbi të gjitha të palës që përfaqësojnë. Vlen të përmendet se shkelja e afateve procedurale dhe zvarritje të gjykimeve

janë kategoria e shkeljeve për të cilat avokatët ankohen më së shumti.

Sipas avokatëve që një proces gjyqësor të ecë mbarë dhe shpejt duhet një bashkëpunim ideal gjykatë-prokurori-avokat-polici. (përmendet shembull: çështja “Gërdeci”, është një çështje me shumë të pandehur, edhe pse janë ndarë në dy grupe, ç’ka e bën të vështirë objektivisht gjykimin e saj dhe çon në zvarritjen e procesit. Në fillosat e gjykimit të këtij procesi pati një angazhim KLD-Prokurori-Gjykatë e Lartë-Dhomë Avokatie për krijimin e lehtësive për gjykimin e saj, duke i dhënë prioritet, por kjo nuk u zbatua më pas. Lehtësitë konsistojnë që duke caktuar dy ditë të javës, e hënë dhe e premte, për gjykimin e kësaj çështje, avokatët që do ishin pjesë e saj do të justifikoheshin në mungesat e tyre në gjyqe të tjera të klientëve që ata përfaqësojnë edhe në Gjykatën e Lartë, por nga praktika nuk rezultoi kështu.)

6.10 Nga burime të ndryshme rezulton se ka avokatë që janë ankuar për shkelje etike të kryera nga gjyqtarët, në KLD dhe në Ministrinë e Drejtësisë, dhe nuk kanë marrë përgjigje për asnjë prej tyre. Nga intervista e kryer në KLD, ky institucion nuk disponon të dhëna nëse ankuesit në KLD për gjyqtarët janë avokatë apo qytetarë që për interesa të tyre i drejtohen këtij institucioni. KLD pohon se nuk evidenton në regjistrat e saj të ankesave këtë element të ankuesit përveç emrit të tij. Në Dhomën Kombëtare të Avokatisë nuk disponohet një e dhënë e tillë për të specifikuar rastin dhe shkeljen për të cilën një avokat mund të ankohet në KLD. Ata pohojnë se ka mjaft raste ankesash por pa evidentuar shkakun real të tyre.

B. Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive

6.11 Në nenin 16/1/e të Ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, është parashikuar se Inspektorati i tij ka detyrë të verifikojë dhe vërë në dukje çështjet për pasuritë e deklaruara nga gjyqtarët.

6.12 Lidhur me këtë detyrë të ngarkuar nga ligji, por dhe në konsideratë të zhvillimeve që ka pësuar legjislacioni në fushën e deklarimit dhe kontrollit të pasurive të të zgjedhurve dhe të disa drejtuesve e punonjësve të shërbimit publik, si dhe të parandalimit të konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike, shkeljet e ligjit nga ana e gjyqtarit lidhur me këto çështje janë të tilla që nuk mund të vërtetohen drejtpërdrejt nga Inspektorati

i KLD, pasi ato kërkojnë që paraprakisht të konstatohen dhe të vërtetohen nga organi shtetëror përgjegjës i ngarkuar nga ligji dhe që është pikërisht Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive.

6.13 Sipas përcaktimeve të bëra në Ligjin Nr.9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve publike” (i ndryshuar), si dhe në Ligjin Nr.9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” (i ndryshuar), vërtetimi i shkeljes së ligjit, shkelje për të cilën ngarkohet edhe me përgjegjësi disiplinore subjekti që mbart detyrimin për deklarim, bëhet nga autoriteti i vetëm shtetëror përgjegjës, ILDKP. Janë pikërisht konstatimet e këtij Institucioni ato që vënë në lëvizje procesin disiplinor ndaj gjyqtarit që ka kryer shkelje të detyrimeve, që përmbahen në këto ligje. Në këto raste, sipas nenit 44.2 të Rregullores së Inspektoratit të KLD, Inspektorati kryen veprimet përkatëse për grumbullimin dhe dokumentimin e rastit disiplinor, ku në përfundim përgatitet relacioni përkatës, që i dërgohet Ministrisë së Drejtësisë për të gjykuar për procedimin disiplinor të gjyqtarit të konstatuar në shkelje të ligjit.

6.14 Për ILDKP, gjyqtarët janë subjekte të deklarimit të pasurive si të gjithë të tjerët që e kanë këtë detyrim sipas ligjit. ILDKP ka nxjerrë një botim (2010), të titulluar: Manual, hetimi administrativ dhe trajtimi i rasteve të veprave penale në fushën e deklarimit të interesave private, në të cilin gjejmë edhe një trajtim teorik dhe përkufizues të kësaj shkeljeje.

6.15 Eshtë vendosur një bashkëpunim institucional ndërmjet KLD-së dhe ILDKP-së.

Fillesat e bashkëpunimit institucional të tyre janë që në vitin 2004, me nënshkrimin e një memorandumit bashkëpunimi mes dy institucioneve, qëllimi i së cilit ishte komunikimi dhe shkëmbimi i të dhënave që lidhen me procesin e deklarimit e kontrollit të pasurive dhe detyrimeve financiare; rritjen e efikasitetit dhe bashkërendimin e punës ndërmjet institucioneve për kontrollin e deklaratave të pasurisë dhe detyrimeve financiare; koordinimin e punëve dhe aktiviteteve të përbashkëta institucionale në kuadrin e parandalimit të korrupsionit dhe luftës kundër tij.

6.16 Memorandumi i bashkëpunimit ngarkon respektivisht dy institucionet me: 1- të bashkëpunojnë për realizimin e kësaj marrëveshjeje; 2-

KLD vë në dispozicion të ILDKP çdo informacion dhe të dhënë që disponon ai dhe ato që janë në varësi të tij, që lidhen me kontrollin dhe verifikimin e deklaratës së pasurisë dhe detyrimeve financiare; 3- KLD cakton një strukturë të posaçme si pikë kontakti me ILDKP që komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit të jetë i shpejtë, korrekt dhe i efektshëm; 3- KLD merr përsipër që jo me vonë se 15 ditë nga marrja e kërkesës nga ILDKP të vënë në dispozicion të saj të dhënat e kërkuara. KLD duhet të japë përgjigje të drejtpërdrejtë dhe jo të përgjithshme; 4- në raste të caktuara me miratim të përbashkët të dy titullarëve të institucioneve mund të ngrihen edhe grupe të përbashkëta pune për kontrollin e deklaratave të pasurisë së gjyqtarëve²¹.

6.17 Bashkëpunimi institucional u freskua me deklaratë të re të përbashkët të KLD dhe ILDKP, të bërë në tetor 2010, për ngritjen e një grupi pune të përbashkët për transparencën e pasurive të gjyqtarëve. Qëllimi i kësaj deklarate është investigimi i thelluar dhe realizimi i transparencës mbi ligjshmërinë e burimeve të krijimit të pasurive të gjyqtarëve. Aty thuhet se: objekt i veprimtarisë së grupit të përbashkët të punës do të jetë verifikimi i pasurive të luajtshme dhe paluajtshme, si dhe çdo interes tjetër privat, të gjyqtarëve dhe familjarëve të tyre, që mund të përbëjnë shkak për rënie në konflikt interesi. KLD vendos në dispozicion të grupit të punës çdo informacion për verifikim të zgjeruar dhe të thelluar të interesave private, për të cilat inspektorati i ILDKP-së ka nisur aktualisht kontrollin e plotë. ILDKP nga ana tjetër merr përsipër të vërë në dispozicion të KLD informacione për raste të mundshme të konfliktit të interesit gjatë procesit të vendimmarrjes nga ana e gjyqtarëve.

6.18 Nga informacioni i marrë pranë ILDKP u pohua se në praktikën e rregullt të punës në këtë institucion informohet periodikisht KLD në lidhje me rastet e kësaj shkeljeje dhe bashkëpunohet në drejtim të zgjidhjes së problemeve, ndërkohë që KLD është autoriteti përgjegjës për njoftimin e subjekteve që mbartin deklarin në gjykata dhe brenda vetë KLD për mbledhjen dhe dorëzimin e deklaratave të tyre si dhe për të njoftuar ILDKP për ndryshimet në pozicionet e personave të cilët mbartin detyrimin për të deklaruar. Aktualisht grupi i punës është ngritur dhe është fokusuar në verifikimin në terren të asaj se çfarë është përfshirë në deklaratën e

²¹ Marrë nga teksti i Memorandumit të Bashkëpunimit.

pasurisë së gjyqtarëve. Nuk ka raste të shkeljes së detyrimeve që lidhen me deklarimin e pasurisë nga gjyqtarët.

6.19 Për ILDKP burim informacioni janë denoncimet e qytetarëve në telefon (0800-9999, pa pagese), e mail (unedenoncoj@hidaa.gov.al), shkrimet e medias, dhe forma tjera komunikimi. Pas marrjes së indicies, ILDKP vihet në verifikim të rastit konkret, për verifikimin e vërtetësisë së tij. Por praktikisht nuk është regjistruar asnjë rast i tillë konkret për gjyqtarët.

6.20 ILDKP nga ana e saj aplikon informimin e opinionit publik me anë të spoteve publicitare, fletëpalosjeve, broshurave, duke përmendur në mënyrë të dukshme dhe të qartë se cilat janë subjektet që kanë detyrimin të bëjnë deklarimin e pasurive në shtet dhe pasojat që ata kanë nëse deklarimi i tyre nuk është real. Këto mënyra bëhen nëpërmjet medias, shoqërisë civile, por edhe direkt qytetarëve dhe publikut në përgjithësi. Një tjetër mënyrë që ILDKP aplikon për këtë qëllim është edhe aktiviteti i titulluar, “ILDKP me dyer të hapura”, i cili zhvillohet në një ditë në vit, në çdo datë 29 prill. Në këtë ditë qytetarët mund të shkojnë dhe të shohin nga afër punën e ILDKP, mënyrën si mblidhet informacioni, si verifikohet, etj.

C. Ndalesa për përfitimin e dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale

6.21 Nga informacioni i marrë në KLD nuk rezulton të ketë një udhëzues për kuptimin dhe zbatimin e ndalesës ligjore për gjyqtarët lidhur me përfitimin e dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale për shkak të detyrës. Vetë KLD-ja i referohet vendimit të KM-së (VKM, nr 714, date 22.10.2004), i cili synon të bëjë një rregullim në këtë çështje duke përcaktuar edhe vlerën e dhuratave që janë të lejueshme. Kjo VKM jep edhe përkufizimin e asaj se çfarë do të konsiderohet dhuratë: janë likuiditete në cash, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari a në huadhënie, sende me vlerë dhe çdo send apo shërbim, me vlerë monetare, të premtuar, ofruar, dhënë falas ose nën vlerën e tregut, interesat, aksionet dhe pjesët e kapitalit në shoqëri tregtare, borxhet dhe detyrimet jozyrtare ndaj personave fizikë apo juridikë. Në dhuratat apo favorët e ndaluara përfshihen edhe ftesat për pritje të ndryshme, premtimet, ofrimet falas apo uljet e çmimeve për kryerjen e

shërbimeve, të argëtimeve, pushimeve, transporteve, udhëtimeve, ofrimi i bursave të studimit, ofrimi i sigurimeve, mbulimi i shpenzimeve për kryerje shërbimesh apo veprimtarish të nëpunësit. Një dhuratë konsiderohet e marrë në mënyrë të tërthortë kur i jepet familjes së nëpunësit, të afërmve, deri në shkallën e dytë, personave ose organizatave, me të cilat nëpunësi ka pasur ose ka marrëdhënie biznesi ose lidhje politike, në bazë të kërkesës, rekomandimit apo udhëzimit të nëpunësit²².

6.22 Gjithashtu, Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Sektorin Publik, nr 9367, date 7.4.2005, në nenin 23, parashikon: Është e ndaluar që një zyrtar të kërkojë ose të marrë, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, dhurata, favore, premtime ose trajtime preferenciale, të cilat i jepen për shkak të pozicionit të tij, nga një individ, person fizik ose juridik privat, kur kjo mund të shkaktojë lindjen e një konflikti interesi të çdo lloji. Përjashtohen vetëm rastet e përcaktuara me akte të organeve kompetente, të cilat lejojnë pranimin e dhuratave apo trajtimeve preferenciale për arsye protokollare.

6.23 Nuk ka raste të dhënies së masave disiplinore ndaj ndonjë gjyqtari, për shkeljen e mësipërme, gjatë periudhës 2009-2010.

6.24 Në lidhje me “favore, premtime ose trajtime preferenciale, të cilat i jepen për shkak të detyrës”, nga ILDKP synohet një bashkëpunim edhe më i organizuar me KLD, për vetë vështirësinë që ato kanë në zbulimin dhe vërtetimin e tyre. Kjo përbën një çështje etike të gjyqtarëve dhe bashkëpunimi me KLD është më se i nevojshëm dhe i vlefshëm këtu. ILDKP pohon se ka një rast konkret: Në vitin 2010 ILDKP u informua nga Lëvizja Mjaft nga një raport i tyre, në lidhje me një rast të tillë, dhe filloi verifikimi, i cili është ende në proces.

Ç. Zvarritja e proceseve gjyqësore dhe fillimi në kohë i seancave gjyqësore

6.25 Por nisur nga praktika gjyqësore mjaft procese gjyqësore zvarriten në kohë duke sjellë vonesa në gjykimin e çështjeve edhe për shkaqe të mosprezencës së avokatëve të palëve. Gjykata e Tiranës në mjaft raste ka deklaruar publikisht nëpërmjet deklaratve të saj për median se shtyrja e seancave bëhet për shkak të avokatëve. Rasti i shumëpërfolur “Gërdeci”

²² VKM, nr 714 datë 22.10.2004.

mund të merret si një kazuz për interpretim. Në të gjitha deklaratat e saj për shtyp, gjykata ka cituar “shtyrjen e seancave gjyqësore për shkak të mungesës së avokatëve”. Në deklaratën e datës 10.1.2011 kjo gjykatë citon: për 15 herë radhazi procesi gjyqësor ndaj të pandehurve të kësaj çështje nuk ka mundur të nisë për shkak të mungesës së avokatëve duke u bërë pengesë për një proces normal dhe të rregullt. Gjkata në deklaratën e saj kërkon në mënyrë të përsëritur ndërhyrjen e Dhomës Kombëtare të Avokatisë që në bazë të ligjit të avokatisë të reagojë me marrjen e masave të menjëhershme, me masa konkrete ndaj avokatëve që janë kthyer në shkakun kryesor të shtyrjeve apo pengimit të seancave gjyqësore, konkretisht të çështjes “Gërdeci”. Duke qëndruar sërish tek ky kazuz, Gjykata e Tiranës në deklaratën e datës 7.2.2011, bërë në ditën e ndryshimit të masës së sigurisë ndaj tre të pandehurve kryesorë të kësaj çështje, dhe ‘fajëson’ për këtë sërish mungesat e përsëritura të avokatëve në proces.

6.26 Sipas KLD është detyrë e palëve në gjykim të llogarisin dëmet e pretenduara që vijnë nga zvarritja e gjykimit. Nga KLD konfirmohen disa raste ankesash nga qytetarë për gjyqtarë të ndryshëm. Sipas KLD ka ankesa në lidhje me këtë shkelje, por nuk janë gjetur të bazuara për shkak se në çdo rast konkret vonesat kanë qenë të justifikuara në procesverbalet gjyqësore.

6.27 Nga informacioni i marrë në KLD nuk rezultojnë të ketë raste të tilla që dëshmojnë për vonesa të përsëritura për fillimin e seancës gjyqësore. Ndërkohë nga monitorimi dymujor në Gjykatën e Tiranës, një prej problemeve të konstatuara, është se vonesat në fillimin e seancave gjyqësore janë kthyer tashmë një dukuri e zakonshme e punës në gjykatë. Për më shumë, në lidhje me këtë çështje, do të flasim në vijim në raportit.

6.28 Nga intervista e kryer në Dhomën Kombëtare të Avokatisë rezultojnë se avokatët e kanë ngritur dhe përcjellë zërin e tyre në KLD dhe MeD lidhur me këtë dukuri edhe ndaj gjyqtarëve të veçantë. Por rezultati nuk ka qenë i kënaqshëm për ta, ka mjaftuar vetëm një tërheqje vëmendjeje ndaj gjyqtarit dhe kaq. Avokatët ndodhen para presionit që ushtrohet nga gjyqtarët dhe për këtë arsye ata shpesh herë edhe preferojnë heshtjen. Duke qënë një vend i vogël, me persona që njihen të gjithë me njëri-tjetrin kjo çon në kthimin e tyre në mburojë të njëri-tjetrit.

D. Mosrespektimi i rregullave të solemnitetit (neni 25 i LOGJ)

6.29 Për KLD-në nuk janë vërejtur shkelje serioze lidhur me solemnitetin, por sipas saj në rastin e inspektimeve tematike janë konstatuar mungesa e togës nga subjektet në gjykim si avokatë dhe në disa raste edhe nga prokurorët, fakt i cili i është bërë me dije gjykatës për ta riparuar këtë mangësi.

6.30 Duke iu referuar shkrimeve të shtypit vendas në tetor 2010, vlen të përmendet kryerja e një kontrolli të palajmëruar të KLD-së në disa prej gjykatave në vend, përkatësisht në Tiranë, Durrës dhe Lezhë. Qëllimi i këtij inspektimi të befasishëm ka qenë i njëjtë: kontrolli i gjyqtarëve në respektimin e solemnitetit dhe etikës së gjyqtarit, respektimin e orareve të gjyqeve si dhe zhvillimin e seancave me dyer të hapura në salla të posaçme gjykimi. Shkas për inspektimin është marrë numri i lartë i ankesave të qytetarëve apo subjekteve të tjera për mungesën e theksuar të disiplinës, etikës, solemnitetit në seancat gjyqësore, të depozituara në Këshillin e Lartë të Drejtësisë²³.

6.31 Gjykata e parë e cila iu nënshtrua një kontrolli të tillë ishte ajo e Tiranës, për tu pasuar nga Gjykata e Shkallës së Parë Durrës dhe Lezhë. Sipas gazetës Shqip të datës 8 tetor 2010, “Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka nisur dje në orën tetë të mëngjesit një sërë inspektimesh të befasishme në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Duke marrë shkas nga ankesat e qytetarëve apo subjekteve të tjera për mungesën e theksuar të disiplinës, etikës, solemnitetit në seancat gjyqësore në gjykatën e kryeqytetit, Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë ka iniciuar një verifikim dhe inspektim që do të zhvillohet për disa javë në këtë gjykatë. Të gjithë inspektorët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë kanë qenë prezentë në çdo ambient, zyrë apo sallë gjykimi për të kontrolluar që në orët e para të mëngjesit. Është kryer kontroll në respektimin e orarit të fillimit të seancave gjyqësore nga gjyqtarët, respektimin e etikës, transparencës dhe normave të solemnitetit në gjykim dhe zhvillimin e seancave me dyer të hapura në salla të posaçme gjykimi.

“Mungesa e disiplinës dhe respektimit të normave të solemnitetit është bërë objekt i pakënaqësive dhe ankesave të publikut, gjë e cila e ka motivuar Këshillin e Lartë të Drejtësisë të hidhet në veprim nëpërmjet inspektimeve në terren të aktivitetit të gjyqtarëve”, thuhet në njoftimin e

²³ Shkrime në të përditshmet Shekulli e Standard datë 22.10.2010.

KLD-së.

6.32 Sipas Dhomës së Avokatisë, avokatët i njohin rregullat e solemnitetit. Ata janë të hapur ndaj masave që mund të merrem ndaj atyre avokatëve që nuk respektojnë këtë aspekt të procesit të solemnitetit në gjykatë.

6.33 Gjyqtarët duhet të respektojnë normat e etikës në marrëdhëniet me pjesëmarrësit në proces, kolegët, kryetarin e gjykatës, stafin e administratës gjyqësore, ekspertët, prokurorët, avokatët. KLD nuk jep të dhëna për raste të tilla shkeljesh të konstatuara, por pohon se ka një raport nga Inspektorati i KLD-së përcjellë Ministrin të Drejtësisë, i cili nuk është sjellë ende për procedim në KLD.

6.34 Avokatët (sipas disa avokatëve) janë në dijeni, por reagimi kundërveprues edhe denoncues i avokatëve është i dobët për arsye të interesave të tyre dhe të klienteve që përfaqësojnë në gjykatë. Nga eksperiencia e deritanishme për raste të mëparshme të denoncuar nuk kanë qenë të suksesshme dhe për pasojë më mirë preferohet heshtja.

Dh. Shoqërimi me palët pjesëmarrëse gjatë periudhës së gjykimit

6.35 Gjyqtari nuk duhet të shoqërohet me palët pjesëmarrëse gjatë periudhës së gjykimit (duke përfshirë dhe avokatët mbrojtës të palëve). Nga informacioni i marrë pranë KLD-së nuk rezulton të jenë konstatuar shkelje të kësaj ndalese.

6.36 Gjatë monitorimit të kryer nga QSP-ja në gjykatë shpesh herë kryesisht në çështjet penale u vu re që pala (prokuror më shpesh, por edhe avokat) rrinë me gjyqtarin para fillimit të seancës dhe/ose pas mbarimit të saj. Nuk mund të pretendohet se kjo bëhet për arsye të ndikimit në gjykim, por kjo ngre pytjen nëse jemi përpara shkeljes ose jo të detyrimit të gjyqtarit për të mos u shoqëruar me palët në gjykim. (Një rast konkret ishte kur para fillimit të seancës penale, do të shpallej vendimi dhe gjyqtari u konsultua haptazi me prokurorin e çështjes, i cili ndodhej në zyrën e tij në pritje të fillimit të seancës. Në përfundim gjykata dha atë masë dënimi të kërkuar nga prokurori.)

7.Mbikëqyrja e standardeve etike nga kryetari i gjykatës

7.1 Në progres raportin e BE për Shqipërinë për vitin 2010, në pjesën për sistemin gjyqësor thuhet se “gjyqësori vuan nga probleme të transparencës dhe efikasitetit”. Menaxhimi i gjykatave është i dobët edhe për shkak të mungesës së burimeve njerëzore dhe burimeve financiare,

veçanërisht në gjykatat e shkallës së parë. Nuk ka një organizim dhe trajnim të përshtatshëm për administratorët e gjykatave.

7.2 Në nenin 18 të Ligjit për Organizimin Gjyqësor përcaktohen kompetencat e kryetarit të gjykatës, si funksionari që përfaqëson gjykatën në marrëdhëniet me të tretët dhe është ai që drejton dhe organizon punën e përditshme të këtij institucioni në raport me gjyqtarët, ndarjen e tyre në seksione, planifikimin e gjyqtarëve në gjykimet me objekt caktimin e masave të sigurimit dhe çdo kërkesë tjetër gjatë fazës së hetimit. Është kryetari i gjykatës ai që organizon diskutime për çështje të natyrës juridike, bazuar në përgjithësimin e përvojës së gjykimit, vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, vendimet e gjykatave të tjera, vendimet e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, aktet e kontrollit dhe inspektimit të ushtruara nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë; mbikëqyr respektimin e etikës gjyqësore dhe të solemnitetit, si dhe planifikimin e çështjeve gjyqësore për qëllime të vlerësimit profesional; me kontakte me ekipet e kontrollit të Ministrisë së Drejtësisë apo të Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, njihen me qëllimin dhe objektin e kontrollit dhe u krijojnë atyre mundësi në ushtrimin e detyrës; mbikëqyr disiplinën në punë të gjyqtarëve; bashkërendon punën me Shkollën e Magjistraturës, Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe Ministrinë e Drejtësisë për çështje të ngritjes profesionale të gjyqtarëve; kujdeset për çështjet e ruajtjes dhe sigurisë në gjykatë; kryen detyra të tjera në funksion të drejtimit administrativ të gjykatës, të parashikuara në aktet ligjore ose nënligjore në fuqi.

7.3 Në Rregulloren “Për marrëdhënien e gjykatës me publikun” të miratuar në shtator të vitit 2010 rregullohet marrëdhënia e gjykatës përballë publikut. Kapitulli II/1 i Rregullores thotë: kryetari i gjykatës është autoriteti përgjegjës për ndërtimin, ruajtjen dhe përmirësimin e marrëdhënies së gjykatës me publikun. Kryetari i gjykatës është gjyqtar që ka ngarkesën e tij të çështjeve në gjykim. Në të tilla raste ai komunikon si titullar dhe jo në cilësi individuale për këtë kategori çështjesh që ka për gjykim në cilësinë e gjyqtarit (kapitulli II/4 i Rregullores). Gjithashtu, Rregullorja e ngarkon kryetarin me funksionin e komunikimit mediatik. Detyrën e marrëdhënies me publikun, kryetari e kryen nëpërmjet komunikimit mediatik, marrjes së masave për orientimin e publikut në mjediset e gjykatës, marrjes së masave për azhurnimin e faqes së

internetit, drejtimet administrativ të veprimtarisë së ZMP-së, drejtimet administrativ të gjykatës në tërësi, si dhe aktiviteteteve njohëse dhe edukuese, të gjykatës për komunitetin. ((kapitulli II/5 i Rregullores). Gjithashtu, Rregullorja kërkon që: të paktën një herë në vit, kryetari është i detyruar të informojë publikun mbi veprimtarinë vjetore të gjykatës, problemet që ajo ka, si dhe natyrën e shkeljeve të ligjit që përbëjnë shqetësim për publikun. Ky informacion shoqërohet, kur është e mundur, me të dhëna statistikore.

7.4 Kryetari mund të organizojë veprimtari sensibilizuese që ndikojnë në përhapjen e edukatës ligjore në komunitet. Kur kjo kërkohet nga përfaqësues të komunitetit, është ai vetë ose përfaqësuesi i caktuar prej tij i detyruar të marrë pjesë, për aq sa është e mundur. Kryetari është autoriteti që zgjidh çdo mosmarrëveshje që mund të lindë brenda gjykatës që ai drejton, për shkak të marrëdhënies me publikun. (kapitulli II/6-8-9 i Rregullores).

7.5 Nga të dhëna pranë zyrës së marrëdhënies me publikun në gjykatë, kryetari ka një orar të caktuar çdo ditë të enjte për takime me publikun.

7.6 Kryetari i gjykatës duhet të marrë masa për afishimin e kopjes së këtij vendimi në një vend të dukshëm brenda ambienteve të gjykatës. (VS-KLD, neni 5)

Nga monitorimi i zhvilluar rezulton se nuk është i aplikueshëm ky standard. Në asnjë stendë apo hapësirë të Gjykatës Tiranë nuk ka afishim të vendimeve gjyqësore dhe ato mund të gjenden vetëm elektronikisht në faqen e internetit të Gjykatës së Tiranës dhe gjithashtu në faqen e internetit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë²⁴. Publikimi i tyre në faqet e internetit i bën vendimet gjyqësore publike të dallueshme, por vetëm për atë pjesë të shoqërisë dhe të interesuarëve që kanë akses në internet dhe e përdorin atë.

8. Solemniteti në gjykim

8.1 Solemniteti i procesit gjyqësor është një element i rëndësishëm i gjykimit dhe përmban disa rregulla, të cilët ne i përfshimë në objektin tonë të monitorimit, të tilla si: vendi i zhvillimit të gjykimit, kushtet e zhvillimit të gjykimit, veshja e posaçme e gjykatës dhe e palëve në proces, respektimi

²⁴ Informacion i marrë në faqet e internetit <http://www.gjykatatirana.gov.al> dhe <http://www.qdgj.kld.al>

i orarit të shpallur për fillimin e gjykimit, sjellja e përshtatshme e subjekteve të pranishëm dhe etika në komunikim.

8.2 KLD ka nxjerrë një vendim i cili saktëson standardet dhe kriteret e solemnitetit në gjykim²⁵. Solemniteti gjatë zhvillimit të gjykimit kërkon me saktësi që proceset gjyqësore duhet të fillojnë në respektim të orarit të gjykimit të komunikuar dhe afishuar në gjykatë, me përjashtim kur ka një arsye të justifikuar. Sekretarja gjyqësore, thërret në orar subjektet procedurale për fillimin e gjykimit dhe i orienton për vendin e zhvillimit të tij. Në momentin e hyrjes në sallë të trupit gjykues, të pranishmit ngrihen në këmbë, nën njoftimin e sekretares gjyqësore. Para miratimit të vendimit të KLD për solemnitetin në Shqipëri nuk ka patur me parë një akt që të ketë rregulluar specifikisht këtë çështje. Gjykata është mjaftuar duke zbatuar vetëm rregullat e përcaktuara në Kodet e Procedurës dhe dispozitat e ligjeve të tjera procedurale.

A. Komunikimi gjatë procesit gjyqësor

8.3 Gjatë gjykimit, palët pjesëmarrëse, duhet të mbajnë qëndrim korrekt dhe sjellje që shpreh respekt për trupin gjykues, duke evituar çdo lloj veprimi të papërshtatshëm në sjellje dhe në të shprehurit e tyre, si në komunikim me trupin gjykues, me subjektet e tjera në proces apo të pranishmit në sallë. Komunikimi ndaj trupit gjykues nga palët dhe të pranishmit e tjerë në proces, duhet të bëhet me ton të përshtatshëm, duke iu drejtuar me formën e mirësjelljes 'Ju' ose me shprehjen 'I nderuar'. Palët pjesëmarrëse në proces, duhet të flasin në këmbë përpara gjykatës, po kështu edhe ekspertët apo dëshmitarët e thirrur gjatë procedurës së betimit, me përjashtim të rasteve kur gjendja shëndetësore nuk ua lejon një gjë të tillë²⁶.

8.4 Në intervistën e realizuar për këtë qëllim në KLD, një sjellje e tillë do të vlerësohet nga gjykata që shqyrton çështjen duke iu referuar rregullave ligjore dhe standardeve të pranuar në ligj dhe në moralin shoqëror.

8.5 Nga monitorimi i QSP-së rezulton se palët dhe pjesëmarrësit në gjykim kanë një sjellje të rregullt dhe korrekte me gjykatën, po ashtu edhe

²⁵ Vendim Nr. 238/b/1 datë 24.12.2008. Ky vendim hyri në fuqi në datë 1.1.2009.

²⁶ Neni 4 i Vendimit.

ndaj njëri-tjetrit. Komunikimi i tyre është në përgjithësi etik, formal dhe korrekt. Të shprehurit e tyre është konform etikës që kërkon gjykata, por kjo më së shumti është e zbatueshme nga ato subjekte të procesit gjyqësor që e njohin procedurën, prokurorët dhe avokatët dhe më pak nga njerëzit e thjeshtë pjesëmarrës në seancë gjyqësore, qëndrimi i të cilëve është më shumë pasiv dhe në mosnjohje të mënyrës së dhënies së shpjegimeve dhe ndërhyrjes në gjykatë. Vlen të përmendet se shpesh herë pjesëmarrësit, njerëzit e thjeshtë ‘instruktohen’ gjatë seancës nga gjykata për mënyrën se si duhen t’i drejtohen asaj dhe palëve si për gjuhën e folur ashtu edhe për qëndrimin e mbajtur në seancë.

Një element që është vënë re gjatë monitorimit është se në mjaft raste ka një komunikim të drejtëpërdrejtë midis gjykatës dhe palëve, duke iu drejtuar në emër personave; seancat shndërrohen në një bisedë të thjeshtë mes “miqsh” apo edhe me shprehi të gjyqtarëve deri në gjeste tallëse me pjesëmarrësit në gjykim. Këto të fundit janë disa raste sporadike të gjetura gjatë monitorimit.

Në vetëm 1 rast të monitoruar seanca është shoqëruar me debate të ashpra gjykatë-avokat dhe në 1 rast tjetër gjykata nxorri jashtë për arsye etike një prej të pranishmëve në seancë.

Nga monitorimi rezulton se në të gjitha rastet është gjykata ajo që i’u kërkon palëve të flasin në këmbë para saj²⁷. Ky element bëhet i ditur duke u cituar shprehimisht nga gjykata ‘të folurit në këmbë’ për palët në proces gjyqësor. Ky konstatim vlen edhe për ata që kanë cilësinë e dëshmitarit në proces.

Avokatë, prokurorë, ekspertë e zbatojnë këtë rregull vetë pa kërkesën e gjykatës. Në 20 raste (seanca) është vënë re që komunikimi gjykatë-palë pjesëmarrëse në gjykim është zhvilluar ulur dhe pa ushtruar formalitetin e kërkuar.

B.Veshja e posaçme

8.6 Gjyqtari gjatë gjykimin të çështjes duhet të respektojë solemnitetin e gjykimin dhe të mbajë veshje të posaçme. (LOGJ, neni 25/1). Në vendimin e KLD-së për solemnitetin, veshja e posaçme në gjykim është një prej standardeve

²⁷ Në këtë rast bëhet fjalë për qytetarë që janë pjesëmarrës dhe subjekte në gjykim.

të parashikuara për t'u respektuar gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor. Gjyqtari, gjatë zhvillimit të proceseve gjyqësore, duhet të mbajë një veshje e posaçme sipas një modeli uniform për gjyqtarët e çdo niveli gjykimi. Toga e gjyqtarit, është veshje me ngjyrë të zezë dhe me një xhufkë në njërën anë të shpatullës me ngjyrë të kuqe për gjyqtarët e rretheve gjyqësore, dhe dy të tilla për gjyqtarët e gjykatave të Apeleve. Veshja e përditshme e gjyqtarit/gjyqtares në ambientet e ushtrimit të detyrës, duhet të jetë serioze dhe e përshtatshme për pozicionin e tij/saj zyrtar²⁸.

8.7 Vendimi i KLD parashikon edhe veshjen e sekretarit gjyqësor dhe vendos standard edhe për veshjen e subjekteve gjyqësore si prokuror dhe avokat. Sekretarja gjyqësore, gjatë zhvillimit të proceseve gjyqësore, mund të mbajë veshje të posaçme të ngjashme me atë të gjyqtarit, me ngjyrë gri të errët. Sekretarja gjyqësore, duhet të demonstrojë seriozitet në veshje në ambientet e punës së kryer jashtë sallave apo kohës së zhvillimit të proceseve²⁹.

8.8 Avokati dhe prokurori duhet të marrin pjesë në proces të veshur me togën e posaçme, sipas modelit të përcaktuar përkatësisht, nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe Prokuroria e Përgjithshme³⁰.

8.9 Sipas KLD-së në gjykatat shqiptare respektohen përgjithësisht rregullat e solemnitetit gjatë zhvillimit të gjykimit.

8.10 QSP ka kryer një monitorim të drejtëpërdrejtë në Gjykatën e Tiranës ku janë vëzhguar seanca të drejtuara nga gjyqtarë të vetëm dhe seanca të zhvilluara me trup gjykues, të përbërë nga 3 gjyqtarë, dhe në total janë vëzhguar 218. Mbajtja e veshjes së posaçme të gjyqtarit ishte një element i vëzhguar me shumë kujdes nga monitoruesit tanë në të gjitha seancat gjyqësore.

8.11 Nga monitorimi i kryer rezultoi se: nga 218 gjyqtarë të monitoruar 142 prej tyre e veshin veshjen e posaçme dhe 76 gjyqtarë nuk e kanë veshur veshjen e posaçme gjatë seancave gjyqësore. Vlen për tu theksuar në seancat që zhvillohen në sallat e gjyqeve të gjithë gjyqtarët pa përjashtim e veshin veshjen e posaçme. Ndërkohë rastet kur ata nuk e veshin janë ato seanca që zhvillohen në zyrat e tyre. Gjithashtu ajo që u

²⁸ Neni 3 i Vendimit.

²⁹ Neni 3 i Vendimit.

³⁰ Neni 3 i Vendimit.

vu re gjatë monitorimit është se gjyqtarët e seancave civile janë më të rregullt dhe e veshin më shumë veshjen e posaçme (edhe pse seancat e tyre zhvillohen kryesisht në zyra) krahasuar me ata të çështjeve penale që nuk janë të rregullt në veshjen e posaçme për gjyqet që zhvillohen në zyra.

Rezultate të monitorimit të kryer nga QSP është se përgjithësisht, gjyqtarët vishen në mënyrë të rregullt dhe formale në ambientet e gjykatës. Gjatë monitorimit u panë vetëm 3 raste kur gjyqtarë që nuk mbanin veshjen e posaçme dhe ishin të veshur në mënyrë jo serioze dhe jo të përshtatshme për pozicionin e gjyqtarit, zhvillonin seanca gjyqësore. Në këtë kategori veshjesh janë përfshirë ato të tipit sportiv. Në të gjitha rastet e tjera veshja ka qenë e pranueshme për ambientin dhe institucionin që përfaqësojnë.

8.12 Veshja e sekretares gjyqësore është një standard i procesit gjyqësor që kërkohet në vendimin e solemnitetit. Ky element rezulton të respektohet në Gjykatën e Tiranës. Veshja e posaçme e sekretareve gjyqësore është pelerinë ngjyrë gri me dy shirita rozë në të dy anët e trupit deri në fund si dhe vazhdim të shiritave në anën e pasme në formë harku. Në anën e majtë të shpatullës ka një xhufkë në ngjyrë të kuqe.

Nga monitorimi i kryer në Gjykatën e Tiranës në 152 seanca gjyqësore por të zhvilluara efektivisht 149 seanca gjyqësore³¹, penale dhe civile vetëm 134 sekretare gjyqësore e kanë veshur veshjen e posaçme gjatë seancave gjyqësore dhe 15 të tjera jo.

Rezultate të monitorimit të kryer nga QSP është se përgjithësisht, sekretaret gjyqësore vishen në mënyrë të rregullt dhe formale në ambientet e gjykatës, p.sh pa teprime dhe dekolte.

Por vlen të theksohet se mbajtja përgjatë gjithë orarit të tyre të punës në gjykatë veshjen e posaçme të seancës gjyqësore zbeh interesin për të vëzhguar këtë aspekt të veshjes së tyre.

8.13 Toga e posaçme e avokatit është: Pelerinë e zezë, në shpatullën e majtë ka një xhufkë të artë dhe një litar në formë rrethi të bardhë në të artë. Në anën e djathtë të shpatullës ka dy rripa të artë në formë litari të cilët përshkrojnë të gjithë pjesën e shpatullës në formë dyfishë. Në pjesën e përparme në të majtë është i vendosur titulli av. dhe emri/mbiemri i avokatit.

³¹ 3 seanca nuk u zhvilluan për mungesë të gjyqtarit edhe pse data e seancës ishte njoftuar si e tillë dhe palët prisnin tek dera e zyrës së gjyqtarit.

Toga e posaçme e prokurorit është: Pelerinë e zezë me një xhufkë të kuqe të vendosur në shpatullën e majtë të trupit.

8.14 Nga monitorimi i kryer në Gjykatën e Tiranës në 152 seanca gjyqësore por të zhvilluara efektivisht 149 seanca gjyqësore, penale dhe civile kanë marrë pjesë gjithsej 55 prokurorë, dhe në vetëm 1 çështje civile u vu re prania e prokurorit. Nga këta, vetëm 10 prokurorë e kanë veshur togën e posaçme dhe pjesa tjetër jo.

Gjithashtu, në seancat e monitoruara kanë marrë pjesë gjithsej 230 avokatë. Nga këta, vetëm 30 avokatë e kanë veshur togën e posaçme ku 3 prej tyre i përkasin seancave të gjykimeve civile pjesa tjetër në seanca të gjykimeve penale.

C. Vendi i zhvillimit të gjyqimit

8.15 Në raportin e hartuar nga OSBE në kuadër të projektit të zbatuar prej tyre “Për një gjykim të hapur” në vitin 2006 citohet se: proceset gjyqësore në Shqipëri, në përgjithësi, zhvillohen me dyer të hapura dhe ka shumë pak raste ku personat që janë të interesuar të marrin pjesë në një seancë gjyqësore, t’u jetë mohuar shprehimisht hyrja. Megjithatë, seancat gjyqësore zhvillohen më shpesh në zyrat e gjyqtarëve se sa në sallat e gjyqeve, dhe kjo gjë që ndodh në praktikë, është vërejtur në shumë raste. Në rastin më të mirë, zyrat e gjyqtarëve pajisen me disa karrige më shumë (të formave dhe madhësive të ndryshme), por nuk ka hapësirë për prokurorin dhe avokatin që të hapin letrat e tyre ose të mbajnë shënime gjatë zhvillimit të seancës. Mundësia e palëve për të hyrë në zyrat e gjyqtarëve është gjithashtu shqetësim, sepse lehtëson kontaktet e padëshirueshme midis palëve dhe gjykatës, të cilat mund të përdoren për qëllime korruptive ose si presion mbi gjyqtarin. Si përfundim, seancat gjyqësore në zyrat e ngarkuara të gjyqtarëve, nganjëherë me palët e kërrusura mbi letrat e tyre që u rrëshqasin nga prehri, kontribuojnë pak në ruajtjen e solemnitetit të seancës gjyqësore dhe respektin që duhet të kenë palët dhe publiku për gjykatën si institucion i drejtësisë.

Në Gjykatën e Rrethit Tiranë, ku seancat zhvillohen shpesh në zyrat e gjyqtarëve, cilido që dëshiron të marrë pjesë në një gjyq duhet të kontaktojë paraprkisht gjyqtarin që e ka çështjen në shqyrtim. Herë pas here, por jo gjithmonë, sekretarja është në gjendje të japë këtë informacion. Nganjëherë vëzhgues nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri janë informuar që seanca do të zhvillohet në një sallë gjyqi dhe vetëm në momentin e

fundit informohen se do të zhvillohet në zyrën e gjyqtarit, dhe si përfundim mësojnë se ajo sërish do të zhvillohet në sallën e gjyqit.

8.16 Një konstatim të njëjtë në lidhje me këtë çështje e gjejmë dhe në raport progresin e BE për Shqipërinë për vitin 2010, në pjesën për pushtetin gjyqësor ku thuhet: Kushtet e punës në gjykata mbeten të këqija dhe shpesh herë seancat gjyqësore mbahen në zyrat e gjyqtarëve, duke dëmtuar transparencën dhe eficientësinë e tyre. Shqetësimi mbi sigurinë e gjyqtarëve vazhdon të jetë i njëjtë.

8.17 Vendi i posaçëm i zhvillimit të gjykimit përbën një prej standardeve të solemnitetit në Vendimin e KLD-së për këtë çështje. KLD parashikon që të gjitha proceset gjyqësore duhet të zhvillohen në salla gjykimi të përshtatshme për natyrën e çështjes konkrete. Në Vendim përshkruhet edhe se si duhet të jetë një sallë gjykimi, me të gjithë elementët e saj përbërës³².

8.18 Nga monitorimi i QSP-së rezulton se në pjesën më të madhe të tyre seancat gjyqësore zhvillohen në zyrat e gjyqtarëve dhe vetëm pak në sallat e gjykimit. Nëse mund të bëjmë një klasifikim të sallave gjyqësore, ato janë të përshtatshme për gjykime civile dhe gjykime penale. Nga 152 seanca të monitoruara, nga të cilat 3 seanca nuk janë zhvilluar fare për shkak të mungesës së gjyqtarit edhe pse palët në gjykim ishin në dijeni të datës së seancës dhe rrinin tek dera e zyrës së gjyqtarit³³, 125 seanca janë zhvilluar në zyrat e gjyqtarëve dhe vetëm 24 në sallat e gjyqëve. Nga këto 20 janë çështje penale dhe vetëm 4 janë seanca gjyqësore të karakterit civil të zhvilluara në sallë.

8.19 Nga monitorimi i kryer nga QSP rezulton gjithashtu se për të bërë të mundur pjesëmarrjen në një seancë gjyqësore monitoruesve tanë iu desh të komunikonin paraprakisht me gjyqtarin e çështjes dhe marrë lejen e pjesëmarrjes në seancë prej tij. Kjo situatë ishte e detyrueshme përse kohë seancat gjyqësore zhvillohen në zyrat e gjyqtarëve. Në të gjitha rastet

³² Neni 2, Vendimi i KLD-së për Solemnitetin.

³³ Info nga monitoruesit e QSP-së. Gjithashtu seanca e planifikuar ishte e publikuar edhe në monitorët elektronikë të gjykatës ku shfaqeshin listat e seancave gjyqësore të ditës. 2 prej gjyqtarëve mungonin për arsye shëndetësore dhe një për pjesëmarrje në seminar.

na u desh të jepej shpjegime se përse ishim të interesuar të ndiqnim një seancë gjyqësore edhe pse gjyqtarët në të njëjtën kohë pohonin faktin se seancat janë të hapura për publikun. Pati disa raste kur seanca e përzgjedhur për tu monitoruar korrespondonte me një çështje që ishte në fazën përgatitore të shqyrtimit në gjykatë dhe gjyqtarët të ndryshëm nuk e morën në konsideratë kërkesën tonë për pjesëmarrje në të³⁴. Vetëm në një rast, seancë gjyqësore për një çështje të karakterit penal, nuk u lejua monitorimi nga gjyqtari i çështjes pasi gjykimi ishte deklaruar për tu zhvilluar me dyer të mbyllura në seancat paraardhëse.

8.20 Ndërkohë po ti referohemi Rregullores “Për marrëdhëniet e gjykatës me publikun” është detyrë e zyrës së marrëdhënies me publikun në gjykatë të merret dhe të administrojë kërkesat për pjesëmarrje në seancë gjyqësore për publikun dhe median³⁵.

8.21 Sikurse rezulton nga të dhënat seancat gjyqësore penale zhvillohen më së shumti në sallat e gjykimit, por gjithnjë duke përmendur ato çështje që kanë të pandehur në gjendje arresti. Të gjitha të tjerat zhvillohen në zyrat e gjyqtarëve, ku përmenden çështjet penale me rrezikshmëri jo të lartë shoqërore. Zhvillimi i seancave në zyrën e gjyqtarit sjell probleme që lidhen me moszbatimin e parimit të publicitetit dhe solemnitetit të gjykimit. Në asnjë prej seancave të zhvilluara në zyra nuk u vu re pjesëmarrje e publikut.

8.22 Kushtet që duhet të plotësojë zhvillimi i gjykimit janë përmendur në nenin 2 të Vendimit të KLD-së për solemnitetin gjyqësor.

8.23 Vlen të theksohet se sallat e gjykimit në Gjykatën e Tiranës janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e një procesi gjyqësor normal dhe solemn, me përjashtim të vetëm 4 (katër) sallave në dhomën penale të Gjykatës Tiranë nga 14 (katërmbydhjetë) në total, që nuk plotësojnë kushtet për të zhvilluar seanca të rregullta gjyqësore. Nga monitorimi i kryer nga monitoruesit e QSP-së rezulton se procesverbali i seancës gjyqësore mbahet në dy mënyra: me dorë dhe me kompjuter. Seancat e zhvilluara në sallat e gjyqëve në të gjitha rastet procesverbali i seancës mbahet me shkrim dore nga sekretarja gjyqësore nën kujdesin e

³⁴ Seanca të tilla nuk janë përfshirë në totalin e numrit të seancave të monitoruara.

³⁵ Kapitulli III, 1.2/ë.

veçantë të gjyqtarit të çështjes. Vetëm në një rast u vu re, konkretisht në gjyqin e çështjes “Gërdeci”, që procesverbali mbahej me kompjuter. Ndërsa në seancat e zhvilluara në zyrat e gjyqtarëve vetëm në dy raste procesverbali mbahej me shkrim dore nga sekretarja gjyqësore. Në të gjitha seancat e tjera procesverbali mbahej direkt në kompjuter. Procesverbali i seancës përgatitore mbahej me shkrim dore nga vetë gjyqtari i çështjes, ku nga 5 seanca përgatitore të ndjekura në 4 prej tyre procesverbali është mbajtur me shkrim dore dhe në vetëm 1 rast në kompjuter.

8.24 Përcaktimin se si duhet të jetë një sallë gjykimi e parashikon vendimi i KLD-së në nenin 2 të tij. Nëse mund të flasim për një kategorizim të sallave të gjykimit ajo është në penale dhe civile, dallimi i të cilave është nga prania e një kafazi hekuri në ato penale ku qëndrojnë të pandehurit në gjendje arresti. Ata qëndrojnë brenda kësaj ndarjeje të shoqëruar nga punonjës të forcave të rendit dhe pa pranga në duar gjatë zhvillimit të gjykimit. Të gjitha sallat e tjera konsiderohen si vende të posaçme ku zhvillohen gjykimet me natyrë civile.

8.25 Gjykata e Tiranës ka 14 salla gjyqi. Përkatësisht, dhoma penale ka 7 salla gjykimi dhe dhoma civile ka 7 salla gjykimi. QSP ka kryer një vëzhgim të të gjitha sallave të gjykimit në Gjykatën e Tiranës, duke vëzhguar (për më shumë informacion referohu Shtojcë 2 bashkëlidhur këtij raporti)

Ç. Respektimi i orarit të gjykimit

8.26 Proceset gjyqësore duhet të fillojnë në respektim të orarit të gjykimit të komunikuar dhe afishuar në gjykatë, me përjashtim kur ka një arsye të justifikuar. Sekretarja gjyqësore, thërret në orar subjektet procedurale për fillimin e gjykimit dhe i orienton për vendin e zhvillimit të tij. Në momentin e hyrjes në sallë të trupit gjykues, të pranishmit ngrihen në këmbë, nën njoftimin e sekretares gjyqësore. (VS-KLD, neni 4)

8.27 Respektimi i orarit të fillimit të seancës është pjesë e rëndësishme e solemnitetit të procesit gjyqësor. Fillimi i seancave gjyqësore jo në orarin e caktuar por me vonesë është një prej rezultateve dhe gjetjeve të monitorimit të kryer në gjykatë nga QSP. Meqënëse, në shumicën e rasteve nuk ka ambiente pritjeje pranë sallave të gjyqeve, njerëzit presin, nganjëherë për shumë kohë, jashtë godinës së gjykatës. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë korridorët jashtë zyrave të gjyqtarëve janë të mbushura me njerëz që presin gjykimin e çështjes, e të takojnë gjyqtarin apo sekretaren

gjyqësore. Kjo gjendje krijon gjithashtu një mjedis pune kaotik për gjyqtarët dhe vetë personelin e gjykatës³⁶.

8.28 I njëjti konstatim është përmendur edhe në raport progresin e BE-së për Shqipërinë për vitin 2010 duke cituar vonesa të pajustificueshme të seancave gjyqësore janë shqetësim sikurse është edhe ngarkesa e madhe e gjyqtarëve. Seancat gjyqësore ecin shumë ngadalë dhe numri i tyre për një çështje është i lartë. Shpesh herë, gjykimet vonohen edhe nga vonesa e ardhjes dhe sjelljes së të pandehurve në gjykatë. Këtu përmenden edhe vonesat dhe pasojat e ardhura nga ushtrimi i funksionit nga avokatët në proceset gjyqësore. Cilësia e shërbimeve të ofruara nga avokatët është vlerësuar vazhdimisht e pamjaftueshme nga gjyqtarët. Ka shumë raste kur avokatët përdorin taktikën e vonesës në gjykim duke mos u paraqitur fare në seancë dhe pa u marrë asnjë masë disiplinore ndaj tyre njëkohësisht.

8.29 Nga monitorimi i zhvilluar nga QSP në Gjykatën e Tiranës rezultoi se vonesa në fillimin e seancave gjyqësore është tashmë një fenomen i përhapur, i përditshëm dhe i zakonshëm i procedimeve gjyqësore për pothuaj në të gjithë gjyqtarët. Një konkluzion i përgjithshëm i nxjerrë nga monitorimi është se më shumë se gjysma e seancave të monitoruara fillojnë jo në respektim të orarit të parashikuar. Kështu, nga 152 seanca gjyqësore të monitoruara nga QSP, 3 seanca nuk janë zhvilluar fare, 50 seanca gjyqësore kanë filluar në orarin e parashikuar dhe 99 seanca të tjera kanë filluar me vonesë. Vonesat në fillimin e seancës gjyqësore varion nga 5 minuta në 60 minuta.³⁷

Shkaqet e vonesës së fillimit të seancës gjyqësore janë të ndryshme dhe ndër to mund të përmendim:

- Angazhimi i gjyqtarëve në procese të tjera gjyqësore,
- Ardhja me vonesë e gjyqtarit të çështjes në vendin e gjykimin (zyrë ose sallë)
- Arsye pa shkak nga ana e gjyqtarit³⁸
- Vonesa në ardhjen e palëve në gjykim (në çështjet e karakterit civil)

³⁶ Raporti i OSBE, viti 2006.

³⁷ Një prej tyre është edhe seanca gjyqësore e çështjes “Gërdeci”.

³⁸ Palët presin tek dera e zyrës dhe iu komunikohet nga sekretarja të presin kur të thirren nga vetë ajo.

·Vënia e sallës në dispozicion të gjykatës me vonesë nga forcat e rendit publik (në çështjet e karakterit penal, me të pandehur të arrestuar).

8.30 Ligji shqiptar nuk përkufizon rastet që mund të vlerësohen si të justifikuar në arsyet që mund të çojnë në fillimin me vonesë të një seance gjyqësore. Nga monitorimi ynë rezulton se në rastet e fillimit me vonesë ka mjaft të tilla që janë shkak i kushteve të infrastrukturës në gjykatë si mungesa e sallave të lira (rasti me të pandehur të arrestuar); gjyqtari është në një gjykim tjetër i cili nuk ka mbaruar ende (sepse ka një vendosje oraresh gjykimi çdo 30 minuta nga gjyqtarët, kjo për arsye të ngarkesës shumë të madhe të tyre me dosje në gjykim). Nga biseda me gjyqtarë u vu re se ata në mjaft ditë të javës zhvillojnë 10-12 seanca gjyqësore në ditë, duke pasur një orar të parashikuar çdo 30 minuta/seancë. Shumë raste vonesash janë edhe ardhja e palëve me vonesë (vonesa në raste të tilla varion 5-7 minuta).

8.31 Kalendarët e seancave gjyqësore në Gjykatën e Tiranës janë të bërë publik nëpërmjet sistemit elektronik në gjykatën civile dhe të afishuar në stendat e njoftimeve në gjykatën penale. Kalendari zakonisht përmban informacion mbi objektin e çështjes, gjyqtarin, orarin e gjyqimit dhe palët në gjykim. Pranë gjykatës civile në korridorin e katit të parë të saj janë të vendosur 2 monitorë me prekje (touch screen) ku mund të merret informacioni i lartpërmendur. Gjithashtu në mur janë të vendosur dy ekranë të tjerë që shfaqin listën e çështjeve pas hedhjes së shortit për emrin e gjyqtarit që do të gjykojë çështjen. Një tjetër ekran me të njëjtën përmbajtje është i vendosur edhe në ambientin ku ndodhen shërbimet për publikun në gjykatë, e cila ka një hyrje të veçantë gjithashtu. Gjatë periudhës së monitorimit për disa ditë monitorët nuk funksiononin për arsye teknike dhe në ditë të tilla të gjithë të interesuarëve iu desh të shkonin pranë zyrave përkatëse të gjyqtarëve të merrnin informacionin e kërkuar. Pranë gjykatës penale në hyrje të saj, hyrja kryesore që përdoret për gjykatën dhe personelin është e vendosur stenda e informacionit, në të cilën afishohen listat e seancave gjyqësore të javës konkrete, me informacionin e përmendur më lart.

9.Procesi disiplinor kundër gjyqtarëve

9.1 Në ligjin për pushtetin gjyqësor, kapitulli IV i tij, nenet 31-36 flasin për rastet ku një gjyqtar kryen shkelje disiplinore dhe për të cilën

ndaj tij mund të fillojë procedimi disiplinor nga organi përkatës si dhe të drejtat që i njihen me ligj një gjyqtari ndaj të cilit është marrë një masë disiplinore.

9.2 LOGJ ka bërë një parashikim të ri dhe të gjerë rastesh që çojnë në procedim disiplinor të një gjyqtari në krahasim me atë se çfarë ishte parashikuar në ligjin për pushtetin gjyqësor para ndryshimit të tij në vitin 2008.

9.3 Neni 31/2 dhe 32 i Ligjit përmban të gjithë sjelljet që mund ta bëjnë përgjegjës një gjyqtar për procedim disiplinor. Shkeljet disiplinore kategorizohen në tre grupe: shkelje shumë të rënda, shkelje të rënda dhe shkelje të lehta. Përshkrimin e këtyre shkeljeve dhe të dhëna mbi raste konkrete për secilën prej tyre janë referuar më lart në pjesën B të raportit.

9.4 Të drejtën për nisjen e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarit në Këshillin e Lartë të Drejtësisë e ka Ministri i Drejtësisë. Fillimi i procedimit disiplinor mund të bëhet jo më vonë se 1 vit nga data e konstatimit të shkeljes nga organi që ka të drejtën për fillimin e këtij procedimi, por jo më vonë se 5 vjet nga data e kryerjes së shkeljes. Ky është parashikimi ligjor për procedimin disiplinor të gjyqtarëve të vendosur në Ligjin për Organizimin Gjyqësor, neni 34.

Ka gjithashtu një Rregullore “Për procedimin disiplinor të gjyqtarëve” e vitit 2003, e cila është ende në fuqi ku saktësohet kompetenca e Ministrit të Drejtësisë për të vënë në lëvizje procedimin disiplinor të gjyqtarëve (neni 1).

9.5 Neni 2 i Rregullores për procedimin disiplinor të gjyqtarëve kërkon që kërkesa për procedim disiplinor për gjyqtarët të depozitohet nga Ministri i Drejtësisë në Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Në këtë kërkesë duhet të përcaktohen shkeljet e ligjit që përbëjnë shkelje disiplinore, si dhe lloji i masës së dënimit që gjykohet se duhet të merret ndaj gjyqtarit që procedohet. Kërkesës duhet t’i bashkangjitet: dokumentacioni që përmban të dhënat përkatëse të cilat provojnë shkeljen e bërë nga gjyqtari; deklarata e gjyqtarit ku është kërkuar të paraqesë me shkrim pretendimet e tij lidhur me procedimin; si dhe pretendimet me shkrim të gjyqtarit që procedohet, në qoftë se ai i ka paraqitur.

9.6 Vendimi për vendosjen e masës disiplinore ndaj një gjyqtari merret në mbledhjen e KLD-së me shumicën e votave të anëtarëve që janë të pranishëm në mbledhje, me votim të hapur. Në rastet kur votat ndahen në

mënyrë të barabartë propozimi i Ministrit të Drejtësisë për masën disiplinore quhet i rrëzuar. (neni 10/1 i Rregullores për Procedimin Disiplinor të Gjyqtarëve).

9.7 Dublikimi i kompetencave dhe procesit verifikues të veprimtarisë së gjyqtarëve dhe gjykatave të shkallës së parë dhe të apeleve u konsideruan si një domosdoshmëri për interpretim. Çështja nëse këto të drejta paralele për të kryer inspektime ishin në kundërshtim me Kushtetutën u shqyrtua nga Gjykata Kushtetuese në vitin 2004. Gjykata shqyrtoi fillimisht çështjen nëse inspektimet mund të shqyrtonin thelbin e çështjeve, dhe arriti në përfundimin se vendimet gjyqësore mund të shqyrtohen vetëm nga një gjykatë e një shkalle më të lartë dhe asnjë organ tjetër nuk ka të drejtë të vlerësojë ligjshmërinë apo bazat e vendimeve gjyqësore që nuk janë ndryshuar apo shfuqizuar nga një gjykatë më e lartë. Gjykata u shpreh se KLD vetëm mund të marrë masa disiplinore ndaj gjyqtarëve pa shqyrtuar vendimet e tyre nëse vendimi ka qenë i lidhur me sjellje që çënojnë rëndë figurën dhe pozitën e gjyqtarit. Gjykata më pas shqyrtoi kuadrin e procesit disiplinor dhe arriti në përfundimin se ishte në përputhje me parimin kushtetues të pavarësisë së gjyqësorit. Gjithsesi u theksua se ky përfundim u arrit vetëm nga shqyrtimi i dispozitave të këtij ligji dhe jo zbatimit të tij, duke vërejtur ekzistencën e dy inspektoriateve të ngjashëm përcaktimi i saktë i nocioneve të inspektimit, kontrollit dhe verifikimit, shmangia e ndërhyrjeve dhe caktimi i kufijve në kontrollin e gjykatave dhe gjyqtarëve janë çështje që duhet të shikohen në kuadrin e përgjithshëm të reformës ligjore.

9.8 Në vitin 2006 u (ri)nënshkrua një memorandum bashkëpunimi³⁹ mes dy institucioneve, Ministri e Drejtësisë dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë për bashkërendimin e punës në drejtim të një kuptimi dhe kuadri procedural të përbashkët, në përmbushjen e detyrave për kontrollin e gjykatave dhe gjyqtarëve, sipas legjislacionit në fuqi. Memorandumi nuk përbën një tentativë për ndarjen e kompetencave midis Ministrit dhe KLD-së, por një instrument angazhimi reciprok, i nevojshëm e i bazuar në vullnetin e tyre të lirë. Memorandumi ka një synim të dyfishtë, kapërcimin e konfuzionit ligjor dhe plotësimin e boshllëqeve në konceptimin e kontrollit

³⁹ Memorandumi i parë është nënshkruar në vitin 2004.

të gjykatave dhe gjyqtarëve në të dy institucionet. Ky memorandum fokusohet mbi çështje të një natyre organizative/administrative në fushën e kontrollit të gjykatave dhe gjyqtarëve me qëllim krijimin e një fryme dhe kuadri bashkëpunimi midis Ministrisë së Drejtësisë e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, përmes një kombinimi më të mirë të punës kontrolluese që realizon secili institucion. Përveç kësaj, Memorandumi mund të shërbejë, për sa i përket disa aspekteve të veçanta të kontrollit të gjykatave dhe gjyqtarëve, si një pikënisje dhe një referencë për amendamente apo rishikimin e kuadrit ligjor të sistemit gjyqësor shqiptar.

9.9 Shmangia e dublikimeve të verifikimit nga të dy inspektoratet është rregulluar edhe në vetë Rregulloren e Inspektoratit të KLD-së⁴⁰, në nenin 37/a të saj: Inspektorati organizon punën që të mos dublohet verifikimi i ankesave me Drejtorinë e Inspektimit të Ministrisë së Drejtësisë. Në rastin kur në drejtim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Ministrisë së Drejtësisë paraqitet e njëjta ankesë që adresohet ndaj veprimtarisë së gjyqtarëve dhe çmohet se ka vend për verifikim, si rregull verifikimi i saj kryhet nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Në rastin kur në drejtim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Ministrisë së Drejtësisë paraqitet e njëjta ankesë që adresohet edhe ndaj veprimtarisë së administratës gjyqësore dhe çmohet se ka vend për verifikim, si rregull verifikimi i saj kryhet nga Drejtoria e Inspektimit të Ministrisë së Drejtësisë. Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë angazhohet që nëpërmjet procedurave të thjeshtuara të mundësojë dhënien dhe shkëmbimin e të dhënave të regjistrit të ankesave me Drejtorinë e Inspektimit të Ministrisë së Drejtësisë.

9.10 KLD-ja ka një Inspektorat të përbërë nga gjyqtarë me eksperiencë, që është ngarkuar me detyrën të verifikojë ankesat ndaj gjyqtarëve, një detyrë që e ka ndër marrë që në krijimin e tij në 1997, dhe gjithashtu edhe me kryerjen e inspektimeve tematike dhe të përgjithshme të punës së gjykatave dhe të gjyqtarëve në to.

⁴⁰ Rregullore për organizimin dhe funksionimin e inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Miratuar me Vendimin të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Nr.195/2/a, datë 05.07.2006. Shtuar dhe ndryshuar me Vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Nr.207/1, date 07.02.2007.

9.11 Gjatë inspektimeve të përgjithshme, që kryhen nga Inspektorati i KLD-së në bashkëpunim me Inspektoratin e Ministrisë së Drejtësisë, inspektorët vlerësojnë çdo dosje gjyqësore në gjykatë të tre viteve të fundit. Inspektimet tematike shikojnë vetëm dosje mbi çështje të caktuara. Fokusi kryesor i këtyre inspektimeve ka qenë të gjenden shkelje të ligjeve themelore apo procedurale. Ndërkohë që i gjithë nocioni i një inspektimi të tillë mund të kthehet në problem për pavarësinë e gjyqësorit dhe faktin që vendimet gjyqësore mund të jenë subjekt për t'u apeluar vetëm nga një gjykatë më e lartë,⁴¹ për qëllime të këtij raporti është e mjaftueshme të vihet re se verifikimi i ankesave dhe proceset e inspektimit i japin informacion KLD-së mbi kapacitetin profesional, ose mungesën e kapacitetit dhe shkeljet e etikës nga disa gjyqtarë të veçantë që bëhen informacion i përdorur në rastin e marrjes së vendimeve për promovim ose transferim.

9.12 Një prej mënyrave që parashikon ligji në përfundim të një verifikimi të kryer, në rastet kur gjyqtari është gjetur me shkelje procedurale për të cilën ai mund të marrë një masë disiplinore është përgatitja e relacionit, për t'u përcjell Ministrit të Drejtësisë nga Zv.kryetari i KLD-së⁴². Dhe të drejtën për nisjen apo jo të procedimit disiplinor e ka në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe përfundimtare vetëm Ministri i Drejtësisë, sipas nenit 34/1 të LOGJ.

9.13 Sipas KLD-së, kjo rezervë ligjore dhënë Ministrit të Drejtësisë është një faktor që vonon procedimin disiplinor të gjyqtarëve. Diskrecioni që ka Ministri për të nisur apo jo procedimin disiplinor ndaj një gjyqtari e lidhur edhe me afatin në pritje 1 vjeçar, përveç procedurave të tjera të cilat janë të nevojshme për të përgatitur materialet nga inspektorati i KLD-së dhe pa llogaritur procedurat dhe kohën e nevojshme për të shqyrtuar kërkesën e Ministrit para KLD-së në rastin ku ka filluar një procedim disiplinor, kufizon procedimet disiplinore në KLD. Sipas KLD-së nëse nisma e procedimit do të shpërndahej në disa subjekte kjo do të

⁴¹ Një përmbledhje se si këto procese funksionojnë në praktikë dhe disa komente mbi meritat e tyre gjenden në botimin, *Një Vlerësim i Funksionimit dhe Administrimit të KLD-së në Shqipëri, Shtator 2005*.

⁴² Neni 33/b i Rregullores së Inspektoratit të KLD.

sillte më shumë procedime para KLD-së dhe për pasojë më shumë shkelje të dënuara.

9.14 Nga interpretimi që mund t'i bëjmë dispozitës mbi fillimin e procedimit disiplinor ndaj një gjyqtari rezulton se ai është plotësisht në diskecionin e Ministrit. Ministri e ka këtë të drejtë edhe në rastet kur ndaj një gjyqtari nga inspektorati i KLD-së është konkluduar një raport me shkelje⁴³.

9.15 Një implikim i mundshëm politik në procedimin disiplinor të gjyqtarëve sipas KLD është potencialisht ekzistues përsa kohë Ministri është anëtar i Qeverisë dhe përfaqësues i një force politike. Në këtë kuadër, KLD propozon që e drejta për të nisur procedimin disiplinor të paktën për raportet që dërgon inspektorati i KLD-së nuk duhen të kufizohen vetëm në ekskluzivitetin e Ministrit duke hequr në këtë mënyrë edhe dyshime të mundshme për implikim politik në rastet kur nuk niset një procedim ndaj një gjyqtari.

9.16 Edhe në raport progresin e KE-së për vitin 2010, për pjesën pushteti gjyqësor, delegacioni europian nxjerr në pah dhe thekson se iniciativa e procedimit disiplinor është vetëm në duart e Ministrit të Drejtësisë, pa asnjë kontroll dhe mëdyshje. Edhe për faktin se mungesa e procedimit disiplinor është element kyç në karrierën gjyqësore të një gjyqtari, ka një rrezik konkret të ndërhyrjes nga Qeveria në këtë fushë. Si rezultat, mund të thuhet se nuk ka sisteme kontrolli dhe të përgjegjshme e efëcente dhe procedime disiplinore po ashtu. Gjithashtu, masat parandaluese ndaj korrupsionit në gjyqësor nuk janë të mjaftueshme.

9.17 Nga ana tjetër shpesh ndodh që gjyqtarët ankohen se ata mund të procedohen për shkeljen më të vogël ndërkohë që gjyqtarë të konsideruar si 'të këqinj' mbeten të paprekshëm. Pra, inspektimi dhe procedimi disiplinor mund të përdoren arbitrarisht si mjete kërcënimi apo ndëshkimi. Në vende si Italia ku është në fuqi një sistem i ngjashëm, Ministri gëzon statusin e një organi kushtetues dhe kreut të gjyqësorit, por dhe në këtë rast roli si iniciuesi i vetëm i procedimit disiplinor është i diskutueshëm.

Ka disa zgjidhje të mundshme për këtë problem, për shembull t'i kërkohet Ministrit të bëjë të ditur qoftë dhe publikisht arsyetimin e tij

⁴³ Marrë nga intervista në KLD.

për mos procedim, apo t'i lejojë KLD-së të shqyrtojë rastin dhe të vendosë të nisë procedimin. Një zgjidhje tjetër është delegimi i kompetencës për të nisur procedimet tek një organ tjetër.

9.18 Të dhëna të nxjerra nga praktika shqiptare për fillimin dhe/apo ndryshimin e masës disiplinore të propozuar ndaj një gjyqtari me propozim të Ministrit të Drejtësisë në mbledhjet e KLD-së në 2 vitet e fundit (2009-2010) dëshmojnë se, në:

- 4 raste është pushuar procedimi disiplinor ndaj gjyqtarit/ve;
- 6 raste është ndryshuar masa disiplinore e propozuar ndaj gjyqtarit/ve;
- 4 raste të shtyjë shqyrtimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarit/ve;

dhe

• 5 raste KLD vendos ndryshe nga kërkesa e ministrit. (për më shumë shiko Shtojcë 3 bashkëlidhur këtij raporti).

9.19 Vlen të theksohet se dy inspektoratet e kontrollit të gjyqtarëve, ai i KLD-së dhe ai i Ministrisë së Drejtësisë, bashkëpunojnë ngushtë për kontrollin e shkeljeve të gjyqtarëve dhe në rastet kur çmohet e nevojshme edhe me anë të inspektimeve të përbashkëta në çështje të caktuara kur ka vendosur mbledhja e anëtarëve të KLD-së.

9.20 Për shkak të dualitetit të lejuar nga ligji në veprimtarinë e inspektorateve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe të Ministrisë së Drejtësisë, neni 27/a i Rregullores për organizimin dhe funksionimin e inspektoratit të KLD-së ka tentuar shmangien e tij, për aq sa mundëson një akt i tillë nënligjor, duke nënkuptuar se një ankesë mund të verë në lëvizje vetëm një proces verifikimi, pavarësisht strukturës inspektuese që realizon atë. Kështu, sipas rregullit të parashikuar në këtë dispozitë, në rastin kur në drejtim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Ministrisë së Drejtësisë paraqitet e njëjta ankesë që adresohet ndaj veprimtarisë së gjyqtarëve dhe çmohet se ka vend për verifikim, si rregull verifikimi i saj kryhet nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Ndërsa, kur ankesa adresohet edhe ndaj veprimtarisë së administratës gjyqësore dhe çmohet se ka vend për verifikim, si rregull verifikimi i saj kryhet nga Drejtoria e Inspektimit të Ministrisë së Drejtësisë.

9.21 Por edhe pse dy institucionet e gjyqësorit Shqiptar që merren me kontrollin e gjyqtarëve pretendojnë se kanë bashkëpunim të mirë mes tyre disi më i ndryshëm është ajo ç'ka raportohet në raportet e ekspertëve

ndërkombëtare në këtë drejtim. Në raport progresin e KE-së për vitin 2010, pjesa e sistemit gjyqësor thuhet se ka një mbivendosje dhe mungesë bashkëpunimi midis dy inspektorateve. “Që të dy, Ministria e Djretësisë dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë kanë kompetenca dhe zbatojnë procedura që nuk përputhen plotësisht me standardet europiane në lidhje me inspektimet e gjyqtarëve dhe gjykatave. Vlerësimi i gjyqtarëve ka mungesë transparence. Shqipëria nuk ka traditë në pavarësinë gjyqësore. Ajo ka nevojë të vazhdojë me procesin e reformimit të gjyqësorit, përfshirë miratimin e një strategjie të reformës në sistemin gjyqësor dhe ligjeve që presin të miratohen dhe vendosjen e një sistemi të dhënash për një sistem gjyqësor të pavarur dhe eficient. Duhet trajtuar mungesa e pavarësisë, transparencës dhe përgjegjshmëria në emërimin, transferimin dhe vlerësimin e gjyqtarëve sikurse duhet përmirësuar edhe sistemi i kontrolleve në gjyqësor.”

9.22 Vetë KLD në lidhje me afatet për fillimin e procedimit disiplinor thotë se afatet janë ligjore dhe gjykohen nga ana e tyre si të tilla që i përshkruajnë procedurave që do të kryhen për nisjen e procedimit.

9.23 Procesi i verifikimit të ankesave rregullohet nga Rregullorja e Inspektoriatit. Me marrjen e ankesës nga Inspektoriatit i KLD, ajo së pari shqyrtohet nga Kryeinspektori, i cili informon Zëvendëskryetarin, dhe më pas cakton inspektorin që do të merret me këtë ankesë. Duke pasur parasysh detyrimin e Inspektoriatit për të verifikuar të gjitha ankesat përveç disa kategorive, është mjaft e kufizuar hapësira e Kryeinspektorit për të vendosur për të mos verifikuar. Por Zëvendëskryetari i cili njoftohet për të gjitha çështjet mund të marrë një vendim të ndryshëm nga ai i Kryeinspektorit. Kjo përzjerje e roleve nuk përbën një shqetësim më vete.

Kryeinspektori lëshon një urdhër për inspektorin e çështjes për objektin, detyrat për verifikim dhe një afat për përfundimin e tyre. Të gjitha fazat e këtij procesi duhen ndjekur. Së paku inspektorët që kanë shumë përvojë, kanë mendimin se nuk është e nevojshme t’u tregohet sesi të kryejnë punën e tyre, dhe se është e panevojshme përgatitja e urdhrave me shkrim për mënyrën e kryerjes së verifikimit. Do të ishte më e dobishme hartimi i një sërë rregullash të përgjithshme dhe e shoqëruar me mbledhje të brendshme mbi çështjet në proces do të kërkonte më pak kohë nga Kryeinspektori. Sipas Ligjit për KLD-në, gjyqtari i interesuar

duhet të njoftohet para verifikimit të ankesës. Zbatimi i një rregulli të tillë konsiderohet si një zhvillim mjaft pozitiv nga gjyqtarët. Duket si diçka e drejtë, por duhet pasur parasysh se është vetëm faza e verifikimit. Ky është një proces transparent duke qenë se rregullorja e inspektoratit parashikon çdo situatë dhe rast në verifikimin ose jo të një ankese drejtuar në KLD. Në rastin kur ankesa vlerësohet e papërshtatshme në formë dhe në përmbajtje dhe urdhërohet arkivimi i saj, ankuesit i kthehet menjëherë përgjigje nga Kryeinspektori, ku parashtrihen shkaqet dhe arsyet e moskryerjes së verifikimit⁴⁴.

9.24 Verifikimi i ankesës është procesi i njohjes dhe konfirmimit të vërtetësisë së pretendimeve apo shqetësimeve për fakte dhe rrethana që lidhen me veprimtarinë e gjyqtarëve konkrete, proces i cili realizohet nëpërmjet marrjes, grumbullimit, analizës dhe ballafaqimit të të dhënave konkrete. Objekt verifikimi të ankesave mund të jenë : faktet apo rrethanat që kanë të bëjnë me mosfunksionimin normal të zyrës së gjyqtarit; faktet apo rrethanat që mund të konsiderohen shkelje në referim të detyrave gjyqësore të gjyqtarit, të cilat përgjithësisht kanë të bëjnë me mosrespektimin formal të ligjit, me mosrespektimin e solemnitetit gjatë gjykimit, me planifikimin dhe organizimin e punës, si dhe me sjelljen e gjyqtarit gjatë apo jashtë gjykimit, që nga ana tjetër kanë ndikuar apo tregojnë dukshëm për zvarritje të pajustificuar të procesit, mungesë të etikës profesionale në komunikim, mungesë të kujdesit në motivimin ligjor të vendimit gjyqësor apo për një mënyrë të vepruari me pasoja për palët në proces gjyqësor; faktet apo rrethanat që mund të konsiderohen shkelje në referim të normave të sjelljes dhe etikës së gjyqtarit të formalizuara në ligj apo akte të tjera me karakter të përgjithshëm.

9.25 KLD verifikon të gjitha ankesat që i drejtohen këtij institucioni për ato raste që parashikon ligji, ndërsa në lidhje me raste të tjera objekt shqyrtimi KLD orienton qytetarët për institucionin kompetent se kujt i duhet drejtuar ankesa. KLD nuk jep të dhëna se sa raste ankesash të tilla i janë kaluar për shqyrtim Ministrisë së Drejtësisë . Proces i verifikimit të ankesës nga inspektorati i KLD ka një fazë paraprake shqyrtimi, e cila

⁴⁴ Neni 27/3 i Rregullores së Inspektoratit.

ushtrohet nga Kryeinspektori i KLD, fazë në të cilën përcaktohet nëse është në kompetencë të tij të bëj verifikimin apo të ndonjë organi tjetër.

9.26 Në funksion të realizimit të një procesi verifikimi disiplinor transparent, sa më pak të kontestueshëm dhe plotësisht të verifikueshëm, që nga ana tjetër dikton marrjen dhe ushtrimin e përgjegjshëm të përgjegjësive, në nenin 26/1 të Rregullores së Inspektoratit, gjejnë parashikim rregulla që diktojnë realizimin e një procesi të formalizuar. Kështu, nëse ankesat ose shqetësimet e bëra publike në media janë gjithsesi të dokumentuara, për ankesat e depozituara në Këshillin e Lartë të Drejtësisë kërkohet që ato të bëhen në formë të shkruar, madje duke përmbytur edhe disa elemente konkrete, mungesa e të cilëve mund të passjell moskryerjen e verifikimeve disiplinore.

9.27 Në të gjitha rastet e shqyrtuara nga KLD, sipas KLD-së, qytetari ankues merr përgjigje me shkrim për rezultatin e verifikimit të kryer.

9.28 Ankesat drejtuar KLD-së mund të depozitohen nëpërmjet shërbimit postar ose drejtpërdrejt në Zyrën e Protokollit të institucionit. Këto ankesa i kalojnë menjëherë për trajtim Kryeinspektorit. Që një ankesë të quhet e vlefshme dhe nga e cila të nis një proces verifikimi, ajo duhet të plotësojë disa elementë që karakterizojnë aspektin formal të saj, në mungesë të të cilëve passjell moskryerjen e veprimeve verifikuese. Elementët që duhet të përmbajë një ankesë janë: ankuesin, të identifikuar në mënyrë të padyshimtë; shkeljen apo rrethanat konkrete të pretenduara; kohën e ndodhjes së tij; gjykatën apo gjyqtarin konkret si dhe kur është rasti, dokumente apo burimet provuese të atyre fakteve apo rrethanave të pretenduara.

9.29 Ankesat e depozituara, si dhe ato të bëra publike nëpërmjet mediave, regjistrohen në Regjistrin e Ankesave, që duhet të përmbajë këto rubrika: identiteti i ankuesit, gjykata apo gjyqtari ndaj kujt adresohet ankesa, lënda e ankesës, llojin e shkeljes së pretenduar, data e nxjerrjes së urdhërit të verifikimit, inspektori i ngarkuar për verifikim, data e marrjes së ankesës dhe urdhërit të verifikimit nga inspektori, data e depozitimit të praktikës së verifikimit nga inspektori dhe mënyra e përfundimit të trajtimit apo verifikimit.

9.30 Procesi i verifikimit të një ankesë të ardhur në Inspektoratin e KLD fillon me nxjerrjen e urdhërit të verifikimit nga Kryeinspektori. Ky

jepet në formë të shkruar, dhe në të përcaktohet inspektori apo grupi i inspektorëve që do të kryejnë verifikimin, lënda objekt verifikimi, detyrat e verifikimit si dhe afati i kryerjes së verifikimit.

Inspektori pavarësisht detyrave të lëna në Urdhërin e Verifikimit, verifikon vërtetësinë e pretendimeve të ngritura nga subjekti ankues, si dhe kryesisht çdo çështje që lidhet me funksionimin apo veprimtarinë normale të gjyqtarit, që është e dukshme dhe që mund të konsiderohet nga ligji si shkelje disipline.

9.31 Pjesë e procesit dhe metodologjisë së verifikimit është vënia në dijeni për rastin të gjyqtarit përkatës dhe të kryetarit të gjykatës ku ushtron veprimtarinë e tij ky gjyqtar. Ligji parashikon raste përjashtimore kur gjyqtari nuk vihet në dijeni dhe kjo për arsye të një situatë të papërshtatshme, por që në çdo rast gjyqtarit i bëhen të ditura pretendimet e ankuesit. Në të tilla raste kjo bëhet në urdhër të Zëvendëskryetarit të KLD-së.

Ligji ka parashikuar edhe rastet ku ankesa ka lidhje me një çështje që është ende në gjykim. Në të tilla situata inspektori duhet të marrë të gjitha masat dhe të bëjë të gjitha përpjekjet e duhura që veprimtaria e tij të mos ndikojë në pavarësinë e gjyqtarit apo gjyqtarëve të asaj çështje konkrete dhe as të përcillet në mënyrë të tillë. Në këtë rast, verifikimi kryhet vetëm për pretendime që lidhen me zvarritje të procesit gjyqësor apo për çështje të etikës së gjyqtarit.

9.32 Të dhënat e marra në KLD konfirmojnë dërgimin e katër raporteve Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë gjatë vitit të fundit. KLD-ja nuk ka asnjë informacion të kthyer tek ajo në lidhje me këto raste.

9.33 Inspektorati i KLD-së ka 12 inspektorë. Inspektorët kanë statusin e gjyqtarit të apelit dhe në mungesë të tyre juristë që kanë shërbyer si gjyqtarë jo më pak se 5 vjet. Nga informacioni i marrë në KLD, aktualisht të gjithë inspektorët në KLD kanë punuar më parë gjyqtarë. Por vlen për t'u theksuar se ka pak interes të gjyqtarëve për t'u bërë inspektorë në KLD, edhe për shkak të mungesës së garancive në karrierën e tyre të mëtejshme në gjyqësor.

Inspektimet e KLD-së dhe të Ministrisë së Drejtësisë

9.34 Duke iu referuar vendimeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD/Vendim datë 2.11.2009, nr 254) të bëra publik në faqen e internetit

të këtij institucioni mbi çështjen e inspektimeve gjatë kësaj periudhe kohore rezulton se KLD-ja ka vendosur kryerjen e këtij inspektimi tematik në gjykatat e rretheve gjyqësore Tiranë, Durrës, Shkodër, Vlorë e në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Ky inspektim do të ketë si objekt dhe do të pasqyrojë ecurinë e të gjitha çështjeve penale të regjistruara në vitet 2007 e 2008, në gjykatat e sipërcituara, në ngarkim të shtetasve të marrë të pandehur për kryerjen e veprave penale, si më poshtë vijon :

- I. vrasje në rrethana cilësuese, e parashikuar nga neni 79 i Kodit Penal;
- II. vrasje me paramendim, e parashikuar nga neni 78 i Kodit Penal;
- III. shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese, i parashikuar nga neni 114/a i Kodit Penal;
- IV. trafikimi i narkotikëve, i parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal;
- V. shpërdorimi i detyrës, i parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal;
- VI. korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike, i parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal;
- VII. korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë, i parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal.

9.35 Ligji parashikon dy lloj inspektimesh: të përgjithshme dhe tematike. Inspektimet tematike konsistojnë në verifikimin e dosjeve të çështjeve të veçanta. Qëllimi kryesor i këtyre inspektimeve, sidomos i atyre të përgjithshme, është gjetja e shkeljeve të ligjit material dhe procedural. Koncepti i inspektimit të përgjithshëm duket sikur bie në kundërshtim me pavarësinë e gjyqësorit dhe me faktin që vendimet gjyqësore mund të jenë subjekt i ankimeve në gjykatat më të larta por gjithësesi vlen të përmendet se për qëllime të këtij raporti është e mjaftueshme të theksojmë se verifikimi i ankesave dhe kryerja e inspektimeve i japin KLD-së informacion mbi nivelin profesional, ose mungesën e aftësisë dhe shkeljet etike të gjyqtarëve të veçantë, informacion i cili shërben dhe merret parasysh në vendimet e promovimit të tyre dhe transferimeve⁴⁵.

Inicimi i një inspektimi të përgjithshëm apo tematik vendoset nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë: a. mbi bazën e një kalendari paraprak pune të

⁴⁵ Marrë në raportin e DPK, Vlerësimi i Promovimit, Transferimeve dhe Sistemit të Karierrës Gjyqësore në Shqipëri.

propozuar nga Zëvendëskryetari me synimin që brenda një periudhe 2-vjeçare të inspektohen të gjitha gjykatat e shkallës së parë dhe gjykatat e apelit, dhe b. mbi një rast apo një situatë problematike të vlerësuar serioze, për të cilën Këshilli mund të vijë në dijeni nga çdokush prej anëtarëve apo nga informacionet e ardhura pranë tij.

9.36 Në përfundim të inspektimit dhe në bazë të rezultateve të këtij inspektimi, Ministri i Drejtësisë propozon procedimin disiplinor të gjyqtarëve para Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe depoziton dokumentacionin përkatës pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Kërkesa për procedim disiplinor, përveç dokumentacionit me të dhënat përkatëse, të cilat provojnë shkeljen e bërë nga gjyqtari, përmban edhe propozimin për llojin e masës disiplinore që gjykohet se duhet të merret ndaj gjyqtarit të proceduar disiplinarisht. (LKLD, neni 31)

9.37 Kërkesa për procedim disiplinor të gjyqtarëve depozitohet nga Ministri i Drejtësisë në Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Në kërkesën për procedimin disiplinor përcaktohen shkeljet e ligjit që përbëjnë shkelje disiplinore, si dhe lloji i masës që gjykohet se duhet të merret ndaj gjyqtarit që procedohet. Kërkesës duhet t'i bashkëngjiten :

a) dokumentacioni që përmban të dhënat përkatëse të cilat provojnë shkeljen e bërë nga gjyqtari;

b) deklaratat e gjyqtarit se i është kërkuar të paraqesë me shkrim pretendimet e tij lidhur me procedimin;

c) pretendimet me shkrim të gjyqtarit që procedohet, në qoftë se ai i ka paraqitur.⁴⁶

Interesimit tonë për të pasur një model/praktikë konkrete mbi një rast procedimi nuk u bë i mundur nga KLD për shkak të konfidencialitetit dhe përmbajtjes që ka një material i tillë.

9.38 Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, kur ngarkohet me detyra verifikuese, është i detyruar që, brenda 15 ditëve, të kryej procedurat e verifikimit dhe të depozitojë raportin përkatës. (LKLD, neni 31) Ky proces verifikimi nuk ka ndryshim nga ai që bëhet kur një gjyqtar kontrollohet në veprimtarinë e tij pas një ankese të ardhur për të. Procedura është e njëjtë dhe është përmendur më lart.

⁴⁶ Neni 2 i Rregullores për Procedimin Disiplinor të Gjyqtarëve.

Statistika të marra në KLD thonë për:

·Vitin 2009: 221 verifikime të kryera

·Vitin 2010: 235 verifikime të kryera

Sipas KLD-së nuk ka evidencë për këtë pikë pasi disa raporte janë në vijueshmëri, por për çdo rast i cili verifikohet në përfundim përgatitet një raport.

9.39 Ministri i Drejtësisë vë në dijeni Këshillin e Lartë të Drejtësisë për rastet dhe për motivet e mosfillimit të procedimit disiplinor të gjyqtarit në kushtet e shkronjës “a” pika 1 e nenit 16 të këtij ligji. (LKLD, neni 31) Gjatë viteve 2009-2010, të dhënat e marra në KLD dëshmojnë për 1 rast të tillë.

Informacioni i Ministrisë pasqyron rastin për të cilin nuk fillohet procedimi dhe arsyet e dhëna nga Ministri për të. Ky informacion nuk bëhet publik dhe për këtë arsye nuk mundi të vihet në dispozicion të QSP edhe për qëllime studimore. Informacioni është i disponueshëm për përdorim të brendshëm, dhe nuk lejohet akses i publikut në të.

10. Disa përfundime

A. Standarde etike për emërimin/pozicionin e gjyqtarëve dhe të drejtuesve të gjykatave

Gjyqtari, sipas LOGJ (neni 11/d) duhet të ketë “cilësi të larta morale”. Ky përcaktim, duke qenë se kemi të bëjmë me një kërkesë ligjore, presupozon që organet shtetërore, të përfshira në procesin e emërimit, duhet të vlerësojnë nëse kandidati për gjyqtar e plotëson këtë kriter ose jo. Në ligj nuk e gjejmë një përkufizim për konceptin “cilësi të larta morale”. Gjithashtu, një shpjegim dhe zërthim të kësaj kërkesë ligjore nuk e kemi hasur as në jurisprudencë. Nuk ka gjithashtu as edhe ndonjë akt të Këshillit të Lartë të Drejtësisë që të japë një përkufizim të “cilësive të larta morale” të gjyqtarëve.

Në procedurat e emërimit dhe transferimit të gjyqtarëve KLD-së i paraqitet nga komisioni përkatës një listë alfabetike e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe një listë e atyre që nuk plotësojnë këto kritere. Një ndër problemet themelore përse i përket promovimit dhe transferimit është se KLD nuk ka zhvilluar deri më tani një proces objektiv dhe transparent për emërimin në përgjithësi. Mungesa e kritereve objektive dhe procedurave formale ka lejuar që procesi i transferimit dhe promovimit të dominohet nga faktorë tradicionalë të kontakteve politike dhe personale.

Procesverbalet e mbledhjeve tregojnë se ka pak ose aspak debat lidhur me meritat e kandidatëve, por disa të intervistuar mendojnë se ai zëvendësohet nga njohjet apo ushtrimi i ndikimit.

KLD-ja është mbështetur në zhvillimin e një sistemi të ri nga një grup ekspertësh europianë brenda kuadrit të programit të përbashkët të Këshillit të Europës dhe Komisionit Europian për funksionimin efektiv të sistemit gjyqësor në Shqipëri. Sistemi i ri i vlerësimit parashikon të ketë edhe kritere për vlerësimin e cilësive etiko-morale të gjyqtarëve, të cilat do të shërbejnë më pas edhe për emërimin, promovimin dhe transferimin e gjyqtarëve.

Mënyra se si KLD duhet të veprojë me transferimet dhe promovimet, ngre një numër pyetjesh në lidhje prioritetet dhe kriteret e konkurrimit. Si duhet të vendosë KLD ndërmjet një gjyqtari që ka kaluar shumë kohë në postin e tij dhe një gjyqtari që është vlerësuar “shumë mirë” në procesin e vlerësimit të performancës? A duhet që vetëm rezultatet e vlerësimit të diktojnë prioritetin apo duhet të konsiderohen dhe faktorë të tjerë? Çfarë efekti duhet të kenë masat disiplinore të mëparshme në të drejtën për të aplikuar për pozicione?

B. Betimi i gjyqtarit dhe respektimi i rregullave të etikës profesionale

Teksti i betimit të gjyqtarit ka këtë përmbajtje: “Beto hem solemnisht se gjatë kryerjes së detyrës do t’i qëndroj kurdoherë besnik Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjeve në fuqi dhe do të respektoj rregullat e etikës profesionale”⁴⁷. Në këtë moment prezumohet se gjyqtari është i vetëdijshëm për përmbajtjen e rregullave të etikës profesionale. Por, ka një paqartësi përsa i përket këtyre rregullave etike: formula e betimit i referohet rregullave etike të miratuara nga Konferenca Gjyqësore apo rregullave etike të përcaktuara në Ligjin për Organizimin Gjyqësor?

Do të ishte më mirë që këto rregulla etike të jenë të përcaktuara ose “të kodifikuara” në një dokument, i cili duhet të jetë i disponueshëm jo vetëm për gjyqtarët, por edhe për publikun. Kjo do të krijonte një lloj sigurie dhe qartësie përsa i përket përgjegjësisë dhe detyrimeve etike që gjyqtari merr përsipër në momentin e betimit. Do të ishte e përshtatshme që një përmbledhje e të gjitha rregullave etike të ishte në tavolinën e çdo

⁴⁷ Neni 15/1 i LOGJ.

gjyqtari dhe e ekspozuar në vendet publike në ambientet e gjykatave.

Është një zhvillim pozitiv fakti që prej 30 shtatorit 2010 ka një Rregullore “Për marrëdhëniet e gjykatës me publikun”, e miratuar me Urdhër të Ministrisë të Drejtësisë nr. 6777/5. Kjo Rregullore është një rregullim normativ për Gjykatat e Shkallës së Parë dhe të Apelit, për mënyrën se si konceptohet dhe mbahet marrëdhënia e gjykatës me publikun.

C.Kodi Etik i gjyqtarëve

Konferenca Gjyqësore ka miratuar Kodin e Etikës Gjyqësore (2000) që është ende në fuqi. Kodi paraqet një tërësi rregullash që vetë gjyqtarët kanë rënë dakort t’i binden, në funksion të realizimit të drejtësisë dhe funksionit të pushtetit gjyqësor në përputhje me Kushtetutën. Ky Kod ka ngarkuar Komisionin Disiplinor si organ që do të shqyrtojë rastet e shkeljeve të parimeve etike dhe Këshillin Ekzekutiv, si organ që do të trajtojë dhe do të vendosë për përgjegjësinë e tyre. Këto dy organe janë pjesë e strukturës së Konferencës Gjyqësore. Këshilli Ekzekutiv nuk ka përcaktuar në mënyrë të shkruar një procedurë, sipas së cilës do të shqyrtohen rastet e shkeljes së Kodit Etik dhe për përgjegjësinë përkatëse të gjyqtarit. Nuk ka informacion nëse këto organe kanë patur raste të shqyrtimit të shkeljeve të parimeve etike nga gjyqtarë të caktuar. Bazuar në praktikatat e mira europiane, do të ishte më mirë që këto organe të merreshin me shpjegimin dhe interpretimin e Kodit Etik dhe jo me marrjen e masave disiplinore.

Ç. Papajtueshmëria e funksionit të gjyqtarit me veprimtari të tjera

Sipas Ligjit për Organizimin Gjyqësor, gjyqtari nuk mund të ushtrojë asnjë veprimtari tjetër shtetërore, private, ose politike (LOGJ, neni 22). Ligji synon të shmangë konfliktin e interesave që mund të krijohet ndërmjet detyrës që kryen gjyqtari me veprimtari të tjera të tij, si shtetërore ashtu dhe private. Interesat e drejtësisë dhe ruajtja e besimit të publikut i imponojnë gjyqtarit disa kufizime, si garanci për ushtrimin e detyrës me paanshmëri.

KLD për të kontrolluar respektimin e rregullave të papajtueshmërisë, ushtron kontrollin ndaj gjyqtarëve vetëm mbi bazën e ankesave të qytetarëve ose të një shqetësimi publik. Nuk ka raste që të ketë kryer kontrollin kryesisht në këtë aspekt. Nga të dhënat zyrtare të marra në KLD nuk rezulton asnjë rast për këtë kategori papajtueshmërie të gjyqtarit në detyrë, të jetë verifikuar nga Inspektorati i KLD dhe as ndonjë praktikë që mund

të jetë çuar për shqyrtim në mbledhjen e KLD-së.

KLD është duke përgatitur një udhëzues, bazuar në standardet dhe eksperiencat e sistemeve të ngjashme të drejtësisë, lidhur me mundësinë e gjyqtarëve për të kryer veprimtari mësimdhënëse.

Gjyqtari ndalohet të bëjë deklarata në publik në lidhje me proceset (LOGJ, neni 23/1/ç), të bëjë të ditur mendimet që janë dhënë gjatë seancave të gjykimit, që akoma nuk kanë marrë formën e një vendimi (LOGJ, neni 23/1/d) si dhe të bëjë deklarata në publik për çdo gjë tjetër që cenon paanshmërinë në proces. (LOGJ, neni 23/1/dh). Gjyqtari duhet të ruajë dinjitetin e tij, duke mos lejuar veprime që komprometojnë profesionin, organet e drejtësisë dhe figurën e tij në shoqëri (LOGJ, neni 23/2). Këto ndalesa ligjore, synojnë të ruajnë besueshmërinë dhe pritshmëritë e publikut për paanshmërinë e gjyqtarit. Gjyqtari nuk mjafton të jetë i paanshëm, por ai duhet edhe të duket/të perceptohet si i paanshëm.

D.Përgjegjësia disiplinore/shkeljet që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit

Gjyqtari ka përgjegjësi disiplinore për shkelje të ligjit dhe për kryerjen e akteve e të sjelljeve që diskreditojnë pozitën dhe figurën e tij, në përputhje me parashikimet e nenit 32 të LOGJ (LOGJ, neni 31/2). Nga informacioni i marrë në KLD dhe me përfaqësues të Shoqatës së Gjyqtarëve prezumohet se gjyqtarët i njohin ato veprime dhe mosveprime që konsiderohen shkelje për figurën e një gjyqtari dhe për pasojë mund të çojnë në procedimin e tyre disiplinor nga institucioni përkatës. Kjo dijeni e gjyqtarëve është e lidhur me detyrimin e tyre në kuadër të ushtrimit të funksionit të gjyqtarit, për të njohur ligjin dhe zbatuar atë.

KLD nuk ka bërë një përmbledhje apo botim ku të jenë të trajtuara teorikisht dhe për arsye studimi kategoritë e shkeljeve disiplinore të gjyqtarëve të parashikuara në Ligjin për Organizimin Gjyqësor. Sipas KLD-së ato vlerësohen rast pas rasti kur i parashtrahet një çështje konkrete për verifikim dhe shqyrtim. Në praktikën e KLD-së përmendet fakti që kur Inspektorati i KLD-së shqyrton një rast të një gjyqtari që gjendet me shkelje gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij gjyqësor dhe për pasojë nis procedura për verifikim ndaj tij, në vendimin e KLD-së për masë disiplinore trajtohet nga pikëpamja kuptimore kjo shkelje.

Në vitet 2009-2010 nga inspektorati i KLD-së janë konstatuar vetëm 4

(katër) raste të shkeljeve të parashikuara në LOGJ për të cilat ka pasur procese verifikimi, përkatësisht:

1.shkelja e parashikuar nga Neni 32/2/gj: akte dhe sjellje të tjera të rënda që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit;

2.shkelja e parashikuar nga Neni 32/3/ç: ndërhyrja ose çdo lloj ndikimi tjetër në ushtrimin e detyrës të një gjyqtari tjetër;

3.shkelja e parashikuar nga Neni 32/3/d: mosrespektimi i rregullave të solemnitetit, sipas nenit 25 të këtij ligji;

4.shkelja e parashikuar nga Neni 32/3/dh: shkelja e normave të etikës në marrëdhëniet me pjesëmarrësit në proces, kolegët, kryetarin e gjykatës, stafin e administratës gjyqësore, ekspertët, prokurorët, avokatët.

Për shkeljen e parë KLD-ja është në proces shqyrtimi. Për shkeljen e dytë ka pasur disa verifikime nga Inspektorati i KLD-së për disa ankesa të ardhura, por që nuk kanë rezultuar me shkelje të kryera nga gjyqtarë. Për shkeljen e tretë janë konstatuar nga Inspektorati i KLD-së raste të mosmbajtjes së veshjes së posaçme nga gjyqtarët gjatë inspektimeve tematike të kryera por për të cilat nuk është konsideruar mbajtja e një raporti. Për shkeljen e katërt ka një raport përcjellë Ministrisë të Drejtësisë për të cilin nuk është kthyer ende përgjigje në KLD.

Avokatët janë të njohur me të gjitha kategoritë e shkeljeve të parashikuara për gjyqtarët në LOGJ, po aq sa janë të njohur me gjithë bazën ligjore që drejton procesin gjyqësor në vend. Pothuaj në të gjitha rastet, edhe pse avokatët mund të jenë në dijeni të një rasti që përbën shkelje nga ana e gjyqtarit, avokatët nuk ankohen për arsye ngushtësisht personale dhe mbi të gjitha për interesa të palës që përfaqësojnë. Vlen të përmendet se shkelja e afateve procedurale dhe zvarritje të gjykimeve janë kategoria e shkeljeve për të cilat avokatët ankohen më së shumti. Sipas avokatëve, që një proces gjyqësor të ecë mbarë dhe shpejt duhet një bashkëpunim shumë i mirë gjykatë-prokurori-avokat-polici.

Edhe në rastet kur avokatët janë ankuar për shkelje etike të kryera nga gjyqtarët, në KLD dhe në Ministrinë e Drejtësisë, ata nuk marrin përgjigje se çfarë është bërë me ankesën e tyre. KLD-ja nuk disponon të dhëna nëse ankuesit për gjyqtarët janë avokatë apo qytetarë, që për interesa të tyre i drejtohen këtij institucioni. KLD-ja pohon se nuk evidenton në regjistrat e saj të ankesave këto elemente të ankuesit, përveç emrit të tij. Dhe në Dhomën Kombëtare të

Avokatisë nuk disponohet një e dhënë e tillë për të specifikuar rastin dhe shkëljen për të cilën një avokat mund të jetë ankuar në KLD.

Dh. Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive

Ekziston një bashkëpunim institucional ndërmjet KLD-së dhe ILDKP-së, në kuadër të të cilit në tetor 2010, u deklarua ngritja e një grupi pune të përbashkët për transparencën e pasurive të gjyqtarëve. Qëllimi i këtij bashkëpunimi është investigimi i thelluar dhe realizimi i transparencës mbi ligjshmërinë e burimeve të krijimit të pasurive të gjyqtarëve. Aty thuhet se: objekt i veprimtarisë së grupit të përbashkët të punës do të jetë verifikimi i pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe çdo interes tjetër privat i gjyqtarëve dhe familjarëve të tyre, që mund të përbëjnë shkak për rënie në konflikt interesi. KLD vendos në dispozicion të grupit të punës çdo informacion për verifikim të zgjeruar dhe të thelluar të interesave private, për të cilat inspektorati i ILDKP-së ka nisur aktualisht kontrollin e plotë. ILDKP-ja, nga ana tjetër, merr përsipër të vërë në dispozicion të KLD informacione për raste të mundshme të konfliktit të interesit gjatë procesit të vendimmarrjes nga ana e gjyqtarëve. Aktualisht grupi i punës është ngritur dhe është fokusuar në verifikimin në terren të asaj se çfarë është përfshirë në deklaratën e pasurisë së gjyqtarëve. Deri në fund të vitit 2010 nuk janë konstatuar raste të shkeljes së detyrimeve që lidhen me deklarimin e pasurisë nga gjyqtarët.

E.Solemniteti në gjykim

KLD-ja ka nxjerrë një vendim i cili saktëson standardet dhe kriteret e solemnitetit në gjykim. Solemniteti i procesit gjyqësor është një element i rëndësishëm i gjykimit dhe përban disa rregulla, të cilët ne i përfshimë në objektin tonë të monitorimit, të tilla si: vendi i zhvillimit të gjykimit, kushtet e zhvillimit të gjykimit, veshja e posaçme e gjykatës dhe e palëve në proces, respektimi i orarit të shpallur për fillimin e gjykimit, sjellja e përshtatshme e subjekteve të pranishëm dhe etika në komunikim. Nga monitorimi i QSP (nëntor 2010 - janar 2011) në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë është arritur në këto përfundime:

Komunikimi gjatë procesit gjyqësor: Në përgjithësi palët dhe pjesëmarrësit në gjykim kanë një sjellje të rregullt dhe korrekte me gjykatën, po ashtu edhe ndaj njëri-tjetrit. Komunikimi i tyre është etik, formal dhe korrekt. Vlen të përmendet se shpesh herë pjesëmarrësit, njerëzit e thjeshtë 'instruktohen'

gjatë seancës nga gjykata për mënyrën se si duhen t'i drejtohen asaj dhe palëve, si për gjuhën e folur, ashtu edhe për qëndrimin e mbajtur në seancë. Por janë vënë re raste kur ka një komunikim të drejtpërdrejtë midis gjykatës dhe palëve, duke iu drejtuar me emër personave apo edhe kur seanca të jetë shndërruar në një bisedë të thjeshtë mes “miqsh”.

Veshja e posaçme: Në seancat e vëzhguara, 142 gjyqtarë e veshin veshjen e posaçme dhe 76 gjyqtarë nuk e kanë veshur veshjen e posaçme gjatë seancave gjyqësore. Vlen për tu theksuar se, në seancat që zhvillohen në sallat e gjyqeve, të gjithë gjyqtarët pa përjashtim e veshin veshjen e posaçme. Ndërkohë rastet kur ata nuk e veshin janë ato seanca që zhvillohen në zyrat e tyre.

Nga 149 seanca gjyqësore të monitoruara në 15 raste është konstatuar që sekretaret gjyqësore nuk kanë respektuar kërkesën për veshjen e posaçme.

Gjithashtu, në seancat e monitoruara është konstatuar se në shumicën e rasteve prokurorët nuk kanë veshur togën e posaçme të përcaktuar për ta.

I njëjti problem është vënë re edhe me veshjen që duhet të kenë avokatët sipas rregullave të solemnitetit.

Vendi i zhvillimit të gjykimit: Në pjesën më të madhe të tyre seancat gjyqësore zhvillohen në zyrat e gjyqtarëve dhe më pak në sallat e gjykimit. Nëse mund të bëjmë një klasifikim të sallave gjyqësore, ato janë të përshtatshme për gjykime civile dhe gjykime penale. Nga 149 seanca të monitoruara 125 seanca janë zhvilluar në zyrat e gjyqtarëve dhe vetëm 24 në sallat e gjyqeve. Nga këto 20 janë çështje penale dhe vetëm 4 janë seanca gjyqësore të karakterit civil.

Respektimi i orarit të gjykimit: Më shumë se gjysma e seancave të monitoruara fillojnë jo në respektim të orarit të parashikuar. Kështu, nga 149 seanca gjyqësore të monitoruara 50 seanca gjyqësore kanë filluar në orarin e parashikuar dhe 99 seanca të tjera kanë filluar me vonesë. Vonesat në fillimin e seancës gjyqësore varion nga 5 minuta në 60 minuta.

Shkaqet e vonesës së fillimit të seancës gjyqësore janë të ndryshme dhe ndër to mund të përmendim:

- Angazhimi i gjyqtarëve në procese të tjera gjyqësore;
- Ardhja me vonesë e gjyqtarit të çështjes në vendin e gjykimit (zyrë ose sallë);
- Arsye pa shkak nga ana e gjyqtarit;
- Vonesa në ardhjen e palëve në gjykim (në çështjet e karakterit civil);

- Vënia e sallës në dispozicion të gjykatës me vonesë nga forcat e rendit publik (në çështjet e karakterit penal, me të pandehur të arrestuar).

Ë. Procesi disiplinor kundër gjyqtarëve

Në vitin 2006 u (ri)nëns shkrua një memorandum bashkëpunimi mes dy institucioneve, Ministri e Drejtësisë dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë për bashkërendimin e punës në drejtim të një kuptimi dhe kuadri procedural të përbashkët, në përmbushjen e detyrave për kontrollin e gjykatave dhe gjyqtarëve, sipas legjislacionit në fuqi. Shmangia e dublikimeve të verifikimit nga të dy inspektoratet është rregulluar edhe në vetë Rregulloren e Inspektoratit të KLD-së, në nenin 37/a të saj: Inspektorati organizon punën që të mos dublohet verifikimi i ankesave me Drejtorinë e Inspektimit të Ministrisë së Drejtësisë.

Nga interpretimi që mund t'i bëjmë dispozitës mbi fillimin e procedimit disiplinor ndaj një gjyqtari, rezulton se ky është plotësisht në diskecionin e Ministrit. Ministri e ka këtë të drejtë edhe në rastet kur ndaj një gjyqtari nga Inspektorati i KLD-së është konkluduar një raport me shkelje. Një implikim i mundshëm politik në procedimin disiplinor të gjyqtarëve sipas KLD-së është i mundshëm përse kohë Ministri është anëtar i Qeverisë dhe përfaqësues i një force politike. Në këtë kuadër, KLD propozon që e drejta për të nisur procedimin disiplinor të paktën për raportet që dërgon Inspektorati i KLD nuk duhen të kufizohen vetëm në ekskluzivitetin e Ministrit, duke hequr në këtë mënyrë edhe dyshime të mundshme për implikim politik në rastet kur nuk niset procedimi ndaj një gjyqtari.

Në funksion të realizimit të një procesi verifikimi disiplinor transparent, sa më pak të kontestueshëm dhe plotësisht të verifikueshëm, që nga ana tjetër dikton marrjen dhe ushtrimin e përgjegjshëm të përgjegjësive, në nenin 26/1 të Rregullores së Inspektoratit, gjejnë parashikim rregulla që diktojnë realizimin e një procesi të formalizuar. Kështu, nëse ankesat ose shqetësimet e bëra publike në media janë gjithsesi të dokumentuara, për ankesat e depozituara në Këshillin e Lartë të Drejtësisë kërkohet që ato të bëhen në formë të shkruar, madje duke përmbajtur edhe disa elemente konkrete, mungesa e të cilëve mund të passjell moskryerjen e verifikimeve disiplinore.

Të dhëna të nxjerra nga praktika shqiptare për fillimin dhe/apo ndryshimin e masës disiplinore të propozuar ndaj një gjyqtari me propozim

të Ministrisë të Drejtësisë në mbledhjet e KLD-së në 2 vitet e fundit (2009-2010) dëshmojnë se, në:

- 4 raste është pushuar procedimi disiplinor ndaj gjyqtarit/ve;
- 6 raste është ndryshuar masa disiplinore e propozuar ndaj gjyqtarit/ve;
- 4 raste të shtyjë shqyrtimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarit/ve; dhe
- 5 raste KLD vendos ndryshe nga kërkesa e ministrit.

Shtojca 1- Historik i sistemit të vlerësimit⁴⁸

Sistemi i vlerësimit profesional dhe etik të gjyqtarëve, u projektua gjatë viteve 2003-2005 nga një grup pune i përbërë nga Këshilli i Europës dhe ekspertë shqiptarë.

Me vendimin Nr.193/2 datë 11.05.2006, Këshilli i Lartë i Drejtësisë miratoi “Sistemin Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve”.

Me anë të të njëjtit Vendim Nr 193/2 më 11.05.2006, KLD vendosi të aplikojë Sistemin e Vlerësimit në mënyrë eksperimentale në Gjykatat e Apelit Durrës, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor në Durrës si edhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Menjëherë pas vendimit të sipërpërmendur, filloi zbatimi eksperimental i sistemit, i cili zgjati deri në Nëntor 2006 dhe u krye në dy faza. Gjatë fazës së parë të zbatimit eksperimental e cila zgjati deri në Korrik 2006, trupa gjyqësore u njoh me sistemin e vlerësimit profesional. Gjatë fazës së dytë u mblodhën të dhëna, informacione dhe vendime nëpërmjet procedurave të parashikuara nga Sistemi i Vlerësimit. Në të njëjtën kohë, me Vendim nr. 199/3 datë 15.09.2006, KLD miratoi “Kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore” si pjesë përbërëse të Sistemit Profesional të Vlerësimit.

Në bazë të raportit të Inspektoratit të KLD-së “Mbi problemet që rezultuan nga zbatimi eksperimental i Sistemit të Vlerësimit të Aftësive Profesionale dhe Etike të gjyqtarëve”, KLD me Vendim të datës 07.02.2007, bëri ndryshime në Sistemin e Vlerësimit Profesional, me qëllim përfshirjen e propozimeve të Inspektoratit të KLD-së.

⁴⁸ Marrë nga Botimi i Projektit të Binjakëzimit të KLD “Mbështetje për Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe Inspektoratin e tij”.

Me Vendimin e datës 5.03.2007, KLD vendosi të caktojë Inspektoriatin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, për të filluar procedurat e vlerësimit profesional dhe etik të gjyqtarëve të gjykatave të rretheve gjyqësore dhe apelit sipas rendit alfabetik. Periudha e vlerësimit u parashikua të shtrihej mbi veprimtarinë e gjyqtarëve për periudhën 2005-2006.

Në Shtator 2007 në Tiranë, Projekti i Binjakëzimit⁴⁹ pranë KLD-së ofroi asistencën e tij teknike në organizimin e një tryeze të rrumbullakët me qëllim përcaktimin e udhëzimeve për zbatimin e sistemit. Këto udhëzimeve u hartuan nga ekspertët e Projektit, në ndjekje të konsultimeve të thella me përfaqësuesit e gjyqtarëve dhe Institucioneve, me anëtarë të KLD-së, Inspektoratin e KLD-së, Shkollën e Magjistraturës dhe Kryetarin e Gjykatës së Lartë të përfshirë në procesin e vlerësimit. Institucionet përkatëse Shqiptare miratuan në vijim udhëzimet e propozuara nga Projekti.

Gjatë periudhës Nëntor 2007 - Prill 2008 u zhvilluan trajnime në nivel kombëtar, duke filluar me qytetin e Shkodrës në Nëntor 2007 dhe duke përfunduar në qytetin e Korçës në Prill 2008. U organizuan 18 sesione trajnuese me qëllimin për të ilustruar dhe diskutuar Sistemin me gjyqtarët Shqiptarë, Kryetarët e Gjykatave dhe Inspektoratin e KLD-së. Seminaret kishin si objektiv familjarizimin e gjyqtarëve dhe Kryetarëve të Gjykatave me procedurat e Sistemit dhe hartimin e sugjerimeve të tyre për përmirësimin e Sistemit.

Me miratimin e Ligjit të ri për Organizimin Gjyqësor në 2008, ndryshoi edhe korniza ligjore e vlerësimit profesional në një mënyrë thelbësore dhe vlerësimi, tashmë parashikohet në Nenin 13 të Ligjit të ri, sipas të cilit: Vlerësimi i aftësive profesionale të gjyqtarit:

1. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, të paktën një herë në tre vjet, bën vlerësimin e aftësive profesionale të gjyqtarit, në përputhje me vendimin e miratuar prej tij për kriteret e vlerësimit.

2. Vlerësimi i aftësive profesionale është: a) “Shumë mirë”; b) “Mirë”; c) “Pranueshëm”; ç) “I paaftë”.

⁴⁹ Projekti i Binjakëzimit “Mbështetje për Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe Inspektoratin e tij”, një projekt ndërkombëtar i financuar nga Bashkimi Europian në bashkëpunim me Këshillat e Drejtësisë së Italisë, Spanjës dhe Shqipërisë, (2007-2008).

3.Vlerësimi “I paaftë” përbën shkak për fillimin e procedurës për shkarkimin nga detyra të gjyqtarit.

4. Në rastin kur gjyqtari është vlerësuar “Pranueshëm”, Këshilli i Lartë i Drejtë-sisë, brenda një viti, bën rivlerësimin e tij.

5.Dispozita të tjera të Ligjit të ri i referohen sistemit të vlerësimit profesional të vlerësimit si edhe karrierës së gjyqtarëve.

6.Neni 12 paragrafi 2, gërma “c”, në bazë të së cilës kandidatët për Gjykatat e Krimeve të Rënda përveç kërkesave të tjera të jenë vlerësuar “shumë mirë”për aftësitë profesionale dy herët e fundit.

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, nenet 1, 2 dhe të Ligjit 9877 datë 18.02.2008 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” nenet 13 e 44, Këshilli i Lartë i Drejtësisë , si autoriteti përgjegjës që bën vlerësimin e gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apeleve miratoi Vendimin Nr. 261/2 datë 14.4.2010, Sistemin e Vlerësimit të Gjyqtarëve.

Përcaktimi i objektivave që duhen arritur nga sistemi i ri i vlerësimit kanë qenë pika e nisjes për grupin e ekspertëve në përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të duhura për ngritjen e sistemit. U vendos që sistemi i vlerësimit duhet të ketë katër qëllime kryesore⁵⁰:

- Të evidentojë vlerat profesionale dhe të gjyqtarëve për efekt të karrierës së tyre.

- Të identifikojë gjyqtarët që rezultojnë me pamjaftueshmëri profesionale dhe gjyqtarët me cilësi të lartë.

- Të konstatojë problematikat që ndeshen në gjykata gjatë verifikimit të veprimtarisë së tyre profesionale.

- Të identifikojë nevojat për training vazhdues të gjyqtarëve.

Vlen të theksohet se konsiderata e rëndësishme është që çdo procedurë emërimi duhet të garantojë pavarësinë gjyqësore institucionale dhe individuale. Në terma të përgjithëshme, standardet ndërkombëtare tregojnë që është e preferueshme që gjyqtarët duhet të emërohen nga homologët e tyre ose nga një organ i pavarur. Në këtë kontekst, Karta Europiane mbi Statutin për Gjyqtarët parashikon:

⁵⁰ Neni 1 i Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve.

Në lidhje me çdo vendim që rregullon përzgjedhjen, rekrutimin, emërimin, progresin e karrierës ose përfundimin e detyrës së një gjyqtari, statuti parashikon ndërhyrjen e një autoriteti të pavarur nga pushteti ekzekutiv dhe legjislativ brenda të cilit të paktën gjysma e atyre që janë në detyrë janë gjyqtarë të zgjedhur nga homologët e tyre duke ndjekur metodat që garantojnë përfaqësimin sa më të gjerë të gjyqësorit.⁵¹

Këshilli i Europës ka dhënë disa rekomandime në lidhje me procedurat e emërimit dhe organin e ngarkuar për përzgjedhjen e gjyqtarëve:

Autoriteti që vendos për përzgjedhjen dhe karrierën e gjyqtarëve duhet të jetë i pavarur nga qeveria dhe administrata. Në mënyrë që të ruhet pavarësia e tij, rregullat duhet të garantojnë, për shembull që, anëtarët e tij përzgjidhen nga gjyqësori dhe se autoriteti vendos vetë për rregullat e tij procedurale.”⁵²

Këshilli i Europës, gjithashtu, njeh se në disa shtete është e zakonshme për Qeverinë të emërojë gjyqtarët dhe se kjo praktikë mund të jetë e pajtueshme me pavarësinë e gjyqësorit për deri sa janë ta parashikuara disa garanci. Në këtë kuptim KE ka përcaktuar se:

“...aty ku dispozitat kushtetuese ose ligjore dhe tradita lejon që gjyqtarët të emërohen nga qeveria, duhet të ketë disa garanci për të siguruar që procedurat për emërimin e gjyqtarit janë transparente dhe të pavaruara në praktikë dhe se vendimet nuk do të influencohen nga një motiv tjetër nga ato të lidhura me kriteret objektive të përmendura më sipër.”

Sistemi i Vlerësimit të gjyqtarëve sapo ka filluar të zbatohet. Gjykata e parë ku ai është testuar është ajo e Rrethit Gjyqësor Elbasan, por që ende nuk ka një raport të bërë publik për gjyqtarët që i janë nënshtruar një Sistemi Vlerësimi të tillë. Në përfundim të vlerësimit të bërë duhet

⁵¹Paragrafi 1.3.

⁵² Këshilli i Europës, Rekomandime Nr. R (94) 12 të Këshillit të Ministrave për Shtetet Anëtare mbi Pavarësinë, Efiçencën dhe Rolin e Gjyqtarëve, Parimi I 2 c. Shihni gjithashtu nenin. 9 të Kartës Universale të Gjyqtarit (aprovuar nga Këshilli Qendror i Shoqatës Ndërkombëtare të Gjyqtarëve më 17 Nëntor 1999) “... ku kjo nuk është siguruar në mënyra të tjera, që janë rrënjësor në një traditë të ngritur e të provuar, përzgjedhja duhet të bëhet nga një organ i pavarur, që përfshin përfaqësimin thelbësor gjyqësor”.

që raporti të kalojë në mbledhjen e KLD dhe të shqyrtohet e miratohet për çdo gjyqtar të veçantë individualisht, si faza e tretë përmbyllëse e të gjithë procedurës së vlerësimit. Aktualisht KLD nuk ka filluar ende me shqyrtimin dhe miratimin e vlerësimeve të bëra për gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, vlerësimi i të cilëve është mbyllur. Sistemi i vlerësimit përfshin tre faza: a. Vlerësimi i kryetarit të gjykatës i ndjekur nga vetëvlerësimi i gjyqtarit; b. Raporti konstatues dhe projektakti i vlerësimit nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë; c. Akti i vlerësimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë⁵³.

Në Sistemin e Vlerësimit të Gjyqtarëve janë përcaktuar edhe kriteret e vlerësimit, të ndarë në 3 grupe⁵⁴:

a.grupi i aftësive profesionale të përgjithshme, organizuese dhe zbatuese;

b.grupi i aftësitë profesionale juridike dhe teknik;

c.grupi i kapacitetit njerëzor dhe angazhimit profesional.

Asnjë nga kriteret nuk ka rëndësi dominuese në raport me të tjerat. Një gjyqtar mund të vlerësohet pozitivisht sipas një parametri, dhe jo i tillë në parametrat e tjerë. Kjo nënkupton se korniza e përgjithshme profesionale e një gjyqtari do të shqyrtohet me kujdes në tërësinë e saj dhe vlerësimi përfundimtar i dhënë nga KLD-ja, supozohet të marrë në konsideratë të tërë parametrat e vlerësimit.

Le të ndalemi në grupin e 3 të vlerësimit, në të cilin përfshihen⁵⁵:

a.etika e gjyqtarit gjatë dhe jashtë procesit gjyqësor;

b.respektimi i solemnitetit dhe disiplinës në punë;

c.pjesëmarrja dhe aktivizimi në aktivitete profesionale;

d.shkrimet dhe botimet e ndryshme me natyrë juridike.

Etika e gjyqtarit gjatë dhe jashtë procesit gjyqësor: me këtë kriter vlerësohen aftësitë komunikuese të gjyqtarit gjatë seancave gjyqësore si dhe mënyra e sjelljes së tij.

Respektimi i solemnitetit dhe disiplinës në punë: me këtë kriter vlerësohen aftësitë e gjyqtarit për të zhvilluar një proces gjyqësor solemn

⁵³ Neni 2 pika 3 e Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve.

⁵⁴ Neni 3 i Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve.

⁵⁵ Neni 13 i Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve.

në përputhje me ligjin e aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij si edhe për të respektuar disiplinën në punë.

Pjesëmarrja dhe aktivizimi në aktivitete profesionale: me këtë kriter vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të marrë pjesë aktive në aktivitetet profesionale dhe trajnuese që kryen brenda dhe jashtë gjykatës, duke identifikuar drejt problematikën e nevojshme dhe duke e trajtuar atë në mënyrë të efektshme.

Shkrimet dhe botimet e ndryshme me natyrë juridike: me këtë kriter vlerësohet angazhimi i gjyqtarit në thellimin e studimeve juridike duke dhënë kontributin e tij në këtë drejtim.

Pra, sikurse vihet re janë vetëm 2 pika në të gjithë Sistemin e Vlerësimit të Gjyqtarëve që tentojnë të bëjnë një vlerësim të figurës së gjyqtarit nga pikëpamja etike dhe morale.

Shtojca 2- Përshkrimi i sallave të gjyqeve në Gjykatën e Tiranës

Sallat e gjykimit në Gjykatën e Tiranës, dhoma penale:

Salla 1: stema është e vendosur në pjesën e sipërme të murit që gjendet pas podiumit ku qëndron gjykata, flamuri kombëtar është vendosur djathtas (nga e majta e gjyqtarit), podium për gjyqtarët, vendqëndrimi për sekretaren dhe nga një vendqëndrim për prokurorin dhe një për avokatin, është pajisur me një kafaz hekuri, ka një vend të posaçëm tip podium për ekspertë, dëshmitarë, etj. Ka 45 vende për publikun, të ndarë nga një ndarje inoks nga pjesa tjetër e sallës ku qëndrojnë subjektët pjesëmarrës në gjykim. Salla është e pajisur me kamera që regjistrojnë seancën gjyqësore, nuk funksionon sistemi audio. Ka kondicioner.

Salla 1 është salla më e madhe e Gjykatës Tiranë, dhoma penale. Ka tre hyrje, një për gjykatën, një për të arrestuarit dhe një për publikun. Nga monitorimi rezultoi se për të hyrë dhe dalë nga kjo sallë përdoret vetëm një hyrje për gjykatën, palët dhe publikun edhe pse hyrja e parashikuar për publikun rri e hapur gjithë kohën. Në murin përballë trupit gjykues është vendosur shprehja “Ligji është i barabartë për të gjithë”.

Kontrolli i publikut pjesëmarrës në seancë bëhet nga punonjësit e policisë që merren me sigurinë në gjykatë.

Kjo është salla që përdoret nga të gjithë gjyqtarët dhe gjatë gjithë ditës.

Salla 2: stema është e vendosur në pjesën e sipërme të murit që gjendet pas podiumit ku qëndron gjykata, flamuri kombëtar është vendosur majtas (nga e djathta e gjyqtarit), podium për gjyqtarët, vendqëndrimi për sekretaren dhe nga një vendqëndrim për prokurorin dhe një për avokatin, është pajisur me një kafaz hekuri, ka një vend të posaçëm tip podium për ekspertë, dëshmitarë, etj. Ka 15 vende për publikun, të ndarë nga një ndarje inoks nga pjesa tjetër e sallës ku qëndrojnë subjektët pjesëmarrëse në gjykim. Salla është e pajisur me kamera që regjistrojnë seancën gjyqësore, nuk funksionon sistemi audio. Ka kondicioner.

Ka tre hyrje, një për gjykatën, një për të arrestuarit dhe një për publikun.

Kontrolli i publikut prezent në seancë bëhet nga punonjësit e policisë që merren me sigurinë në gjykatë.

Salla 3. stema është e vendosur në pjesën e sipërme të murit që gjendet pas podiumit ku qëndron gjykata, flamuri kombëtar është vendosur djathtas (nga e majta e gjyqtarit), podium për gjyqtarët, vendqëndrimi për sekretaren dhe nga një vendqëndrim për prokurorin dhe një për avokatin, ka kafaz hekuri, ka një vend të posaçëm tip podium për ekspertë, dëshmitarë, etj. Ka 34 vende për publikun, të ndarë nga një ndarje inoks nga pjesa tjetër e sallës ku qëndrojnë subjektët pjesëmarrëse në gjykim. Salla është e pajisur me kamera që regjistrojnë seancën gjyqësore, nuk funksionon sistemi audio. Ka kondicioner.

Ka tre hyrje, një për gjykatën, një për të arrestuarit dhe një për publikun.

Ka një tabelë “Ligji është i barabartë për të gjithë” dhe simbolin e peshores.

Sallat 4,5,6,7 (përshkrimi është i njëjtë për të gjitha)

Janë dhoma të vogla, pajisur me një tryezë të madhe pune për gjyqtarët dhe sekretaren dhe dy tryeza për prokurorin dhe avokatin. Kanë një podium për ekspertë/dëshmitarë të vendosur përballë gjyqtarëve. Kanë 3- 10 karrige për publikun. Këto salla kanë vetëm stemën të vendosur në murin pas trupit gjykues, por në dy prej sallave ajo është e vendosur në murin anësor, përbri dritares së sallës.

Kanë vetëm një hyrje për të gjithë pjesëmarrësit në gjykim. Këtu kryesisht zhvillohen gjyqe me të pandehur në gjendje të lirë.

Gjatë një seancë të monitoruar, e cila u zhvillua në një sallë të tillë (salla 4) në një prej tryezave e cila ishte paracaktuar si vendi i avokatit dhe të pandehurit, u ul sekretarja e seancës. Avokati dhe i pandehuri (i mitur në gjendje të lirë) u ulën në vendet e parashikuara për publikun.

Gjithashtu, në Gjykatën e Tiranës, dhoma penale është edhe një ambient i quajtur Dhoma e Avokatit dhe Prokurorit. Aty gjendet 1 tavolinë dhe 4 karrike. Nuk frekuentohet as nga prokurorët dhe as nga avokatët për këtë qëllim.

Sallat e gjykimit në Gjykatën e Tiranës, dhoma civile.

Salla 1: stema është e vendosur në pjesën e sipërme të murit që gjendet pas podiumit ku qëndron gjykata, flamuri kombëtar është vendosur majtas (nga e djathta e gjyqtarit), podium për gjyqtarët, vendqëndrimi për sekretaren dhe nga një vendqëndrim për prokurorin dhe një për avokatin, është pajisur me një kafaz hekuri, ka një vend të posaçëm tip podium për ekspertë, dëshmitarë, etj. Ka 48 vende për publikun, të ndarë nga një ndarje inoks nga pjesa tjetër e sallës ku qëndrojnë subjektët pjesëmarrëse në gjykim. Salla është e pajisur me kamera që regjistrojnë seancën gjyqësore, nuk funksionon sistemi audio. Ka kondicioner.

Salla 1 është salla më e madhe e Gjykatës Tiranë. Ka tre hyrje, një për gjykatën, një për të arrestuarit dhe një për publikun. Nga monitorimi rezultoi se gjykata përdor hyrjen e paracaktuar për të, palët dhe publiku përdorin hyrjen tjetër gjithashtu të parashikuar për ta. (Shënim: në këtë sallë gjyqi zhvillohen vetëm gjykime penale, aktualisht aty zhvillohet gjyqi i çështjes "Gërdeci", në dy ditë të javës, e hënë dhe e premte).

Sallat 2,3,4,5,6,7: stema është e vendosur në pjesën e sipërme të murit pas podiumit ku qëndron gjykata, flamuri kombëtar është i vendosur në 2 prej sallave në anën e majtë të sallës, në krah të podiumit ku qëndron gjykata dhe në 3 të tjera në anën e djathtë siç e kërkon ligji, të gjitha sallat kanë ndarjen midis vendqëndrimit të subjekteve pjesëmarrëse në gjykim dhe publikut, sallat nr 2 dhe 3 janë të pajisura me një kafaz hekuri, salla këto të mbetura që kur gjykata operonte në një godinë të vetme. Vihet re se nuk asnjë adaptim të tyre në salla të posaçme për gjykime civile. Asnjë prej sallave nuk ka një vend të posaçëm i cili duhet të përdoret nga dëshmitarët,

ekspertët, psikologët dhe përkthyesit gjatë aktivizimit të tyre në seancë gjyqësore. Të gjitha sallat e gjyqit kanë vend të mjaftueshëm për publikun, numëri i të cilave shkon nga 15-60 karrige. Ato kanë portë hyrje dhe dalje të veçantë për gjykatën, por nga monitorimi rezultoi se përdoret e njëjta për gjykatën, palët dhe publikun.

Gjithashtu, në Gjykatën e Tiranës, dhoma civile është një ambient i quajtur Dhoma e Avokatit dhe Prokurorit. Ajo ndodhet në katin e parë të gjykatës. Gjatë gjithë ditës dera rri e mbyllur.

Shtojca 3- Tabela mbi masat disiplinore gjatë viteve 2009-2010

Nr.	Gjyqtari	Gjykata	Propozimi MiD	Masa disiplinore	Vendim KLD
1	Gj. Gj.	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë	Tërhequr masa nga MiD	Pushim i procedimit disiplinor	Nr. 246/B/3, datë 14.05.09
2	M.Ll.	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë	1) Shkarkim nga detyra 2) Dërgim për 1 vit në një gjykatë të të njëjtit nivel	Dërgim për 1 vit në një gjykatë të të njëjtit nivel	Nr. 246/B/4, datë 14.05.09
3	A.M.	Gjykata e Apelit Vlorë	Tërhequr masa nga MiD	Pushim i procedimit disiplinor	Nr. 251/9, datë 29.07.09
4	M.R.	Gjykata e Apelit Vlorë	1)Shkarkim nga detyra 2)Ulje e përkohshme për 1 deri 2 vjet në detyrë	a) Shtyrje e shqyrtimit të procedimit b) Rrëzim i kërkesës për procedim	a) Nr. 246/B, datë 14.05.09 b) Nr. 251/10, datë 29.07.09
5	T.T.	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan	Shkarkim nga detyra	b)Rrëzim i kërkesës për procedim	a) Nr. 250/5/b, datë 08.07.09
6	R.D.	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë	1)Transferim në një gjykatë tjetër 2) Vërejtje me paralajmërim	Vërejtje me paralajmërim	Nr. 254/5, datë 02.11.2009
7	E.K.	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë	Vërejtje me paralajmërim	Rrëzohet kërkesa për procedim disiplinor	Nr. 254/6, datë 02.11.2009
8	A.C.	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë	1)Shkarkim nga detyra 2)Vërejtje	Vërejtje	Nr. 254/8, datë 02.11.09
9	A.A.	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë	1)Shkarkim nga detyra 2)Vërejtje	Rrëzim i kërkesës për procedim	Nr. 256/4, datë 02.12.09
10	M.B.	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë	1)Dërgimin për 1 deri 2 vjet në një gjykatë të të njëjtit nivel, jashtë rrethit gjyqësor ku gjyqtari ka emërimin e tij 2) Vërejtje me paralajmërim	Rrëzim i kërkesës për procedim	Nr. 256/5, datë 02.12.09
11	N.H.	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë	Tërhequr masa nga MiD	Pushim i procedimit disiplinor	Nr. 262, datë 23.04.10
12	A.K. ⁵⁶	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë	Tërhequr masa nga MiD	Pushim i procedimit disiplinor	Nr. 268, datë 15.09.10

⁵⁶ Pas vendimit të marrë nga Gjykata Kushtetuese për të.

Bibliografia

- Monitorim i QSP në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë
- Takime në Inspektoratin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë
- Takime në Ministrinë e Drejtësisë
- Takim me kryetaren e Shoqatës së Gjyqtarëve të Shqipërisë
- Takim me sekretarin e përgjithshëm të Dhomës Kombëtare të Avokatisë
- Takim me këshilltarin juridik të Presidentit të Republikës
- Takim në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit e Kontrollit të Pasurive
- Biseda me avokatë të ndryshëm
- Ligji për Organizimin Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë nr 9877, datë 18.2.2008
- Ligji Për Organizimin dhe Funksonimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr 8811, datë 17.5.2001, i ndryshuar me Ligjin nr 9448 datë 5.12.2005
- Ligji për Gjykatën e Krimeve të Rënda, nr 9110 datë 24.7.2003
- Rregullorja e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë Nr.195/2/a, datë 5.7.2006, e ndryshuar me Vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Nr.207/1 datë 7.2.2007
- Vendim i Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Për solemnitetin”, hyrë në fuqi në 1.1.2009.
- Vendim i Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Për evidentimin e të dhënave për gjyqtarët”, nr.177 (2) datë 16.6.2005
- Vendim i Këshillit të Lartë të Drejtësisë për Sistemin e Vlerësimit të Gjyqtarëve, nr 261/2 datë 14.4.2010
- VKM nr 714 datë 22.10.2004
- Kodi i Etikës Gjyqësore, viti 2000
- Rregullore “Për marrëdhëniet e gjykatës me publikun”, e miratuar me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë nr. 6777/5 datë 30.9.2010
- Memorandumi i bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Lartë

të Drejtësisë – Ministri e Drejtësisë

- Deklaratë e përbashkët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë – Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive

- Botimi i Projektit të Binjakëzimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me titull “Mbështetje për Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe Inspektoratin e tij”, 2008

- Botim i Këshillit të Lartë të Drejtësisë për organizimin dhe funksionimin e këtij institucioni, 2005

- Manual Hetimi administrativ dhe trajtimi i rasteve të veprave penale në fushën e deklarimit të interesave private

- Raport i projektit “Programi për zhvillimin e një gjykimi të drejtë”, Misioni i Prezencës së OSBE në Tiranë, 2004

- Raport Progresi i Komisionit European për Shqipërinë për vitin 2010

- Informacion i marrë pranë <http://www.gjykatatirana.gov.al> dhe <http://www.qdgj.kld.al>

- Shkrime dhe komente pasqyruar në shtypin e ditës në vend në lidhje me sistemin gjyqësor dhe gjykatat

- Parimet Ndërkombëtare mbi Pavarësinë dhe Përgjegjshmërinë e Gjyqtarëve, Juristëve dhe Prokurorëve: ICJ Udhëzuesi për Praktikuesit

- Këshilli i Europës, Rekomandime Nr. R (94) 12 të Këshillit të Ministrave për Shtetet Anëtare mbi Pavarësinë, Eficiencën dhe Rolin e Gjyqtarëve

- Karta Universale e Gjyqtarit

Rovena Qose - Pregja

Menaxhere Projekti

Qendra e Studimeve Parlamentare

Disa reflektime mbi problematikën dhe rrugët e arritjes së standardeve mbi integritetin e gjyqtarëve. Etika gjyqësore – një element thelbësor i integritetit të gjyqtarit

*“Standardet etike të gjyqtarëve dhe rritja e besimit të publikut kundrejt gjyqësorit”
Tryezë e Rrumbullakët, Tiranë, më 06 Prill 2011*

Dëshiroj të filloj fjalën time me një përgëzim të posaçëm për Qendrën e Studimeve Parlamentare, e cila është angazhuar me mbështetjen e paçmueshme të Ambasadës Amerikane në Tiranë, pikërisht për identifikimin dhe ndërmarrjen e këtij projekti mjaft ambicioz, tepër kompleks, po edhe aq dobiprurës, si për sistemin gjyqësor, ashtu edhe për publikun.

Dëshiroj të jap vlerësimin tim që, edhe ky Raport mbi Monitorimin e Standardeve Etike të Detyrueshme mbi Gjyqtarët, na reflekton dhe përshkruan qartësisht gjendjen problematike të gjyqësorit, duke ofruar edhe gjetje e sugjerime me interes për nisma e përmirësime në të ardhmen.

Nuk është hera e parë që trajtohen problematika dhe tema të tilla. Nuk jam nga ata që mohojnë se në këto dy dekada nuk është bërë përparim dhe nuk kemi arritje të dukshme. Por, kam qenë dhe mbetem i mendimit se, mund dhe duhet të ishte bërë shumë më tepër. Kam bindjen se institucionet përgjegjëse kanë bërë pak, reforma gjyqësore ka ecur në

vijimësi, por ritmi është i ulët, shpejtësia e ngadaltë, pjesëmarrja e aktorëve të interesuar e pakënaqshme. Kush është rezultati ?

Mbi të gjitha, ende nuk kemi ngritur një sistem gjyqësor që të garantojë jetësimin e parimeve dhe normave kushtetuese mbi dhënien e drejtësisë e shtetin e së drejtës. Suksesin e reformës gjyqësore dhe garancinë për mirëfunktionin e tij e ofron vetëm ngritja e sistemit gjyqësor me të gjitha elementet e tij institucionale, strukturore dhe ligjore. Individët kanë rolin e tyre, por kjo nuk është e mjaftueshme.

Ende nuk kemi një sistem gjyqësor që të realizojë e garantojë pritshmërinë e publikut nga gjykatat e gjyqtarët. Fakti i pamohueshëm është se gjyqësori e gjyqtarët ende nuk kanë arritur të jenë dhe të ndjehen të pavarur dhe njëkohësisht të përgjegjshëm. Po kështu, besimi publik tek drejtësia është i ulët, ndërsa siguria juridike problematike.

Kultura ligjore e juridike është ende e varfër. Praktika dhe mentaliteti i pandëshkueshmërisë në linjë horizontale e vertikale është ende në nivel shqetësues. Ky fenomen reflekton dhe ndikon seriozisht jetën familjare, private, sociale, publike, ushtrimin e rregullt të përgjegjësive në veprimtarinë politike dhe institucionale të vendit.

Po kështu, shkalla e ndërgjegjësimit të vetë gjyqtarëve mbi garancitë, të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre është e nivelit të ulët. I tillë, pra i nivelit të ulët, madje të papranueshëm, është edhe indiferentizmi, mungesa serioze e solidaritetit profesional e institucional, si dhe mungesa e kurajos qytetare dhe profesionale të gjyqtarëve lidhur me çështjet e mirëfunktionimit të pushtetit gjyqësor.

Ndonëse ka dy organizime vullnetare të gjyqtarëve, të cilat, me nismat që kanë ndërmarrë, dëshmuar se janë fillesa premtuese për të “zgjuar” gjyqtarët dhe për t’i nxjerrë ata nga apatia, me të cilën janë mësuar apo që u është imponuar nga institucionet përgjegjëse si nga brenda, ashtu edhe jashtë gjyqësorit, gjykoj se ende ka mungesë të ndjeshme të gjallërisë, nismave dhe organizimeve vullnetare të gjyqtarëve. Përvojat e mjaft vendeve perëndimore kanë dëshmuar sa vendimtar dhe i pazëvendësueshëm është angazhimi i përgjegjshëm i vetë gjyqtarëve në reformimin e sistemit gjyqësor dhe rritjen e standardeve të dhënies së drejtësisë.

Për të gjitha këto problematika, sikurse edhe për ato që trajtohen në këtë raport monitorimi, në funksion të synimit për rritjen e besimit të

publikut mbi gjyqësorin, rritjes së transparencës dhe përgjegjshmërisë së gjyqtarëve etj., është e domosdoshme, madje gjykoj se është emergjente që të promovohet, realisht dhe jo fiktivisht, në terrenin konkret dhe jo thjesht përpara kamerave apo për efekt të protagonizmit mediatik, një debat publik, sa më gjithëpërfshirës dhe sa më afër gjyqtarëve e përdoruesve të gjykatës, sa më efektiv dhe me impakte të prekshme.

Kjo emergjencë, lidhet jo vetëm me mungesën tonë të përvojës dhe traditës, por edhe me klimën në të cilën vijon të trajtohet dhe jetësohet reforma gjyqësore në Shqipëri. Kjo reformë, lidhur me shkaqet pse nevojitet, rrugët e zgjidhjes dhe nismat, pa i hyrë arsyeve pse ndodh kështu, në mënyrë të qëllimshme apo naive, është një reformë që vijon të mbetet monopol i një grushti politikanësh e funksionarësh, të cilët, për shkak edhe të nënvleftësimit të kapaciteteve të vetë gjyqtarëve apo shoqërisë civile, apo nga mungesa e ndjeshmërisë, nga padijenja, zelli i tepërt apo instikti politik për të kontrolluar e qeverisur patjetër, vijnë të mbajnë nën kontroll, madje të mbajnë të “pushtuar”, hapësira të konsiderueshme të mundësisë për t’u shprehur lirisht, për të kontribuar, për të kritikuar dhe sugjeruar. “Të pushtuarit”, madje në vetë shtëpinë e tyre, sipas gjykimit tim, kanë qenë dhe mbeten në radhë të parë, vetë gjyqtarët. Por, po aq “të pushtuar” janë dhe ndjehen edhe përdoruesit e gjykatës, pra vetë qytetarët, sipërmarrësit dhe institucionet publike, të cilës janë direkt të interesuar dhe gëzojnë të drejtën të kërkojnë e të shprehen mbi mirëfunksionimin e drejtësisë, por që mbeten të zhgënjyer e me pak shpresë se u dëgjohet opinioni i tyre.

Ligji për Organizimin Gjyqësor parashikon se gjyqtarët duhet të kenë “cilësi të larta morale”. Këto cilësi morale duhet të mbahen parasysht dhe të respektohen jo vetëm nga institucionet kushtetuese të ngarkuara me përgjegjësi për emërimin, karrierën dhe masat disiplinore ndaj gjyqtarëve, por edhe nga vetë gjyqtarët gjatë ushtrimit të funksionit të tyre kushtetues.

Në raportin e monitorimit ngrihet shqetësimi se ligji nuk përmban më tej as ndonjë përkufizim dhe nuk ka as rregulla më të hollësishme për këtë qëllim. Mendoj se jo domosdoshmërisht ligji duhet të përmbajë detaje të tilla. Detajet në ligj nuk janë gjithmonë një zgjidhje e mirë. Detajet nga njëra anë duket se e lehtësojnë kuptimin e normës nga të interesuarit, por nga ana tjetër, ato edhe e kufizojnë kuptimin dhe qëllimin

e normës juridike. Sipas një shprehjeje të njohur, “Ligjet e tepërta i vrasin vetë ligjet”, ligjet e tepërta e “vrasin” edhe gjyqtarin” që duhet ta zbatojë e t’i japë jetë ligjit. Aq më tepër, të tentosh që të përkufizosh dhe të detajosh me rregulla ligjore e nënligjore normative kuptimin e “moralit” në tërësi apo të “cilësive të larta morale”, qoftë edhe për gjyqtarët, mendoj se jo vetëm që është thujse utopike, por edhe dëmshme.

Ligji kodifikon dhe duhet të kodifikojë kushtet për të qënë i zgjedhshëm dhe ato të papajtueshmërisë me detyrën e gjyqtarit. Por, në dijeninë time nuk ka ligj a rregullore normative që të kodifikojë moralin e individit në tërësi, e atë të gjyqtarit në veçanti. Nuk besoj se një nismë a kompetencë e tillë për të normuar të ashtëquajturin “moral” të gjyqtarëve dhe “cilësitë e larta” të këtij morali duhet të ndërmerret nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, aq më tepër nga struktura qeveritare përfshirë Ministrinë e Drejtësisë. Mundet që, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, nëpërmjet qëndrimeve publike dhe publikimeve të ndryshme, gjithsesi nga ato jo të karakterit të normës dhe të detyrueshme, mund të kontribuojë për të promovuar debatin e shëndoshë dhe për të ofruar rekomandime e këshilla për njohjen dhe respektimin e vlerave të moralit në veprimtarinë e gjyqtarit.

Prandaj kam mendimin se, në momentin kur lind nevoja dhe në harmoni me dinamikën e kërkesave të kohës, për t’i dhënë jetë normës, nëpërmjet analizës tërësore dhe përfundimeve përkatëse, edhe lidhur me “cilësitë morale” të gjyqtarëve, kontribut mund e duhet të japin në radhë të parë Gjykata Kushtetuese dhe Gjykata e Lartë. Po kështu, kontribues të rëndësishëm jo vetëm për një kuptim të gjithëpranuar, por edhe të zbatueshëm të “cilësive morale”, aq më tepër, “të larta”, të gjyqtarit, duhet ta japin vetë gjyqtarët, nëpërmjet strukturave ligjore dhe vullnetare të vetorganizimit të tyre si pushtet, përfshirë ato të Konferencës Gjyqësore Kombëtare dhe strukturave të tjera rajonale të ngarkuara edhe me çështjet e etikës së gjyqtarit. Rol të rëndësishëm në këtë drejtim mund e duhet të luajnë shoqatat vullnetare të vetorganizimit të gjyqtarëve. Ende nuk kemi ngritur këshillat gjyqësore në nivelet e qarkut. Gjykoj se jemi mjaft të prapambetur në këtë drejtim.

Në raportin e monitorimit bëhet një parashtrim i hollësishëm, interesant dhe dobiprurës rreth çështjeve të etikës gjyqësore, përse ato rregulla janë të domosdoshme dhe të dobishme, për gjyqtarët e publikun, për rritjen

e besimit të individit tek gjykata, si dhe për problematikën e njohjes dhe zbatimit të këtyre rregullave etike. Prandaj, për vetë formatin dhe qëllimit e këtij aktiviteti, çmuj se nuk është vendi për t'i përsëritur.

Gjyqtarët shqiptarë kanë Kodin e tyre të Etikës Gjyqësore. Konferenca Gjyqësore Kombëtare e ka miratuar atë në vitin 2000. Madje, dokumenti më i hershëm i këtyre rregullave daton që në vitin 1994. Deri në shfuqizimin nga Gjykata Kushtetuese të Ligjit “Për organizmin dhe funksionimin e Konferencës Kombëtare Gjyqësore”, kemi patur edhe një Komision të Etikës Gjyqësore pranë kësaj Konference. Ky Komision, për aq pak kohë sa funksionoi, ka bërë disa përpjekje për të hedhur hapat fillestare për promovimin dhe respektimin e rregullave të etikës gjyqësore. Janë zhvilluar e zhvillohen edhe disa veprimtari mbi etikën gjyqësore.

Megjithatë, kam bindjen që kemi bërë shumë pak. Jo vetëm sepse, këto dy-tre vitet e fundit jemi gati të bllokuar me shfuqizimin e ligjit për Konferencën Kombëtare Gjyqësore, pranë së cilës formalisht kemi patur një Komision të Etikës Gjyqësore. Gjithashtu, sipas mendimit tim, duhet të pranojmë se Kodi i Etikës Gjyqësore ende vijon të mbetet një grumbull rregullash, të formuluar me një cilësi të pranueshme, por që nuk njihen sa duhet dhe, aq më tepër, pak ndjehet se zbatohen, pikësepari nga vetë gjyqtarët. Kjo nuk duhet të ngatërrohet me respektimin e tyre nga gjyqtarët. Kolegët e mi, sipas gjykimit tim, mendojnë dhe bëjnë përpjekje që ta respektojnë pozitën e figurën e gjyqtarit, sikurse e parashikon Kushtetuta, ligji procedural dhe rregullat e sjelljes për gjyqtarët. Nga ana tjetër, Këshilli i Lartë i Drejtësisë nuk e ka në kompetencë dhe as në natyrën e misionin e tij t'i imponojë gjyqtarëve miratimin a ndryshimin e rregullave etike. Ky Këshill, sigurisht që i mban parasysht këto rregulla kur gjykon mbi karrierën dhe masat disiplinore ndaj gjyqtarëve. Por, gjithsesi, edhe Këshilli nuk ka se nga kush të presë a kërkojë opinione mbi sjelljen etike të gjyqtarëve. As gjyqtarët nuk kanë struktura ku të kërkojnë opinion mbi etikën.

Çështja është se rregullat e etikës gjyqësore përmbledhin, krahas disa parimeve dhe rregullave të sjelljes të kodifikuara në Kushtetutë dhe ligje, edhe shumë elemente e rregulla të tjera, më të hollësishme, të sjelljes gjatë dhe jashtë veprimtarisë gjyqësore, të cilat nuk janë norma të detyrueshme. Këto lloj rregullash janë sjellje standard, që përcaktohen, miratohen dhe gjithëpranohen nga vetë gjyqtarët. Këto rregulla pasurohen e ndryshohen

prej tyre si reflektim i dinamikës së zhvillimeve në veprimtarinë gjyqësore e jashtëgjyqësore dhe për t'i bërë sa më të kuptueshme, të përdorshme, të dobishme për edukimin, orientimin dhe parandalimin e sjelljeve të papërshtatshme të gjyqtarëve që do të çënonin pozitën e figurën e tyre, si dhe për t'i shërbyer përdoruesve të shërbimeve gjyqësore dhe publikut më gjerë, që të njohë më mirë dhe të orientohet mbi korrektësinë dhe paanshmërinë e gjyqtarëve që shqyrtojnë çështjet e tyre.

Përse jemi në këtë gjendje të papranueshme ? Mund të ketë shumë arsye e faktorë. Por, në këndvështrimin tim, ekziston një lidhje jetësore, madje varësie të çështjeve të etikës gjyqësore nga gjendja e sistemit gjyqësor në tërësi dhe problematika e reformave përkatëse të parashtruara si më sipër në reflektimet e mia.

Në vetvete, Kodi i Etikës Gjyqësore është e pamundur të besohet të prodhojë ndryshim e përmirësim në sjelljen e gjyqtarëve. Është e vështirë të besosh që edukimi profesional dhe integriteti i gjyqtarit të arrihet pa një sistem gjyqësor të ngritur me themelet e duhura. Gjendja e gjyqësorit tregon vetë. Përveç sa u parashtrua më sipër, në sistemin tonë gjyqësor institucionet brenda gjyqësorit dhe ato jashtë tij, por të lidhura me përgjegjësi ndaj pushtetit gjyqësor, ende nuk janë vendosur në vendin e tyre, madje më keq, vijojnë të ndërhyjnë në fushën e tjetrit. Sistemi ynë ende nuk garanton përzgjedhjen cilësore, morale e profesionale në emërimet e gjyqtarëve, as në promovimin e ngritjen në karrierë të tyre. Sistemi ende nuk ofron një proces të drejtë, profesional e transparent, efektiv dhe eficient, të procedimit disiplinor për rastet e parashikuara nga ligji. Ky proces profesional e transparent nuk ekziston as edhe ndërmjet gjyqtarëve në strukturat e vetorganizimit të tyre, në lidhje me shkeljet e etikës gjyqësore.

Ju faleminderit për vëmendjen!

Ardian Dvorani
Anëtar i Gjykatës së Lartë

Etika e gjyqtarit dhe kriteret e vlerësimit nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë

*“Standardet etike të gjyqtarëve dhe rritja e besimit të publikut kundrejt gjyqësorit”
Tryezë e Rrumbullakët, Tiranë, më 06 Prill 2011*

Projekti në fjalë dhe prezantimi i raportit në kuadër të këtij projekti është një iniciativë e lavdërueshme dhe e gjetur, të cilën unë personalisht e vlerësoj shumë, pasi si një gjyqtar i angazhuar me çështje të etikës gjyqësore, gjithmonë kam menduar se etika gjyqësore është çështja më delikate për integritetin, besueshmërinë dhe autoritetin e pushtetit gjyqësor.

Ligji për Organizimin dhe Funkcionimin e Pushtetit Gjyqësor përcakton qartë se gjyqtari duhet të ketë “*cilësi të larta morale*”, neni 11/d. Dhe për të qenë gjyqtar në gjykatat e Krimeve të Rënda dhe në Gjykatat e Apeleve, duhet që gjyqtarët të jenë dalluar për “*cilësi të larta etiko-morale*”, neni 12 i ligjit të sipërcituar, çka do të thote se sistemi i karrierës në gjyqësor duhet të bazohet tek ky tipar i personalitetit të gjyqtarit.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka detyrimin që të bëjë këtë vlerësim në bazë të sistemit të vlerësimit i rishikuar e rimiratuar në vitin 2010, një sistem që bazohet në kriteret formale e që kryesisht neglizhon kriteret empirike të vlerësimit të gjyqtarëve.

Çështje e diskutueshme dhe që përmendet dhe në raportin prezantues të këtij projekti është ajo se tek cilat standarde etike duhet të adresohet sjellja e gjyqtarit, dhe cilat kritere duhet të ketë parasysh KLD në momentin e vlerësimit të gjyqtarit. Ne si pjesë e traditës ligjore të vendeve kontinentale të normativizmit e kodifikimit, kemi zgjedhur rrugën e përcaktimit të rregullave të shkruara etike e konkretisht në Kodin Etik të Gjyqtarëve, një grup rregullash të miratuara në mënyrë vullnetare nga vetë gjyqtarët. Ky Kod është në fuqi dhe është i aplikueshëm. Ai pati një histori të shkurtër, por të frytshme aplikimi, referuar dhe një mekanizmi garatues e konsultues siç ishte Komisioni i Etikës Gjyqësore, një Komision në kuadër të Konferencës Gjyqësore.

Ligji “Për organizimin dhe funksionimin e Konferencës Gjyqësore”, i vitit 2005¹, përcaktonte Komisionet e KGJK-së dhe ndër to, edhe Komisionin e Etikës si një nga Komisionet e Përhershme. Unë personalisht kam qenë i angazhuar në përbërje e në drejtimin e këtij Komisioni.

Sipas përcaktimit në këtë ligj, Komisioni i Etikës mbante lidhje, koordinonte, si dhe jepte mendime këshillimore Inspektoratit të KLD-së. Komisioni këshillonte dhe rekomandonte, kur ishte nevoja, ndryshime në Kodin e Etikës. Gjithashtu, Komisioni mund të jepte mendime këshilluese nëse një veprimtari ndalohet ose jo nga Komisioni i Etikës.

Nisur nga ky detyrim, Komisioni funksionoi deri në shfuqizimin e ligjit për KGJK në dhjetor 2008. Komisioni mjaftohej vetëm me mendime këshilluese në favor të pozitës së gjyqtarit. Inspektorati i KLD përcillte rastin në Komision, pa emra gjyqtarësh ndaj të cilëve pretendoheshin shkelja etike dhe Komisioni do jepte mendim rekomandues dhe këshillimor, nëse sjellja e gjyqtarit ishte në shkelje apo në përputhje me Kodin e Etikës.

Opinionin e Komisionit nuk ishte detyrues për Inspektoratin. Komisioni përcakton mënyrën e tij të veprimit, mënyrën se si do pranoheshin rastet e si do të përcilleshin në Inspektorat.

Megjithatë ne menduam se përmbajtja e Kodit të Etikës nuk ishte e mjaftueshme për përcaktimin e standarteve të sjelljes së gjyqtarëve, pasi

¹ Ligji nr. 9399, dt. 12.05.2005 “Për organizimin dhe funksionimin e Konferencës Gjyqësore”, botuar në Fletoren Zyrtare nr.45, fq. 1617 shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese me Vendimin nr. 25 datë 05.12.2008.

standarde të tilla ishin më të gjera dhe më përshkruese se sa vetë përmbajtja e Kodit. Vetë Kodi ishte i vitit 2004, i rishikuar në disa nene në vitet më vonë. Në interpretim të brendisë së këtij Kodi ne kemi gjetur përputhje me një akt të lartë të adresueshëm të parimeve etike, siç janë disa nga parimet e Kartës Europiane për Statusin e Gjyqtarit, por kryesisht Parimet e Bangalorit për Etikën Gjyqësore dhe Kodi përmban në mënyrë preçise disa nga këto parime.

Parimet e Bangalorit janë rregullat bazë të Etikës gjyqësore të rekomanduara nga Këshilli Shoqëror dhe Ekonomik i Kombeve të Bashkuara, përmes Rezolutës 2006/23. Komisioni Ndërkombëtar i Juristëve i përkrahu menjëherë dhe gjyqtarët e shteteve anëtare të KE gjithashtu. Këto Parime janë si një Deklaratë Universale e Etikës Gjyqësore.

Prandaj unë do të rekomandoja një Komentari mbi Kodin tonë të Etikës Gjyqësore nën frymën e parimeve të Bangalorit për Etikën Gjyqësore ose adaptimin e tërësishëm të Rregullave të Bangalorit dhe ndryshimin sipas frymës së tyre të Kodit tonë të Etikës Gjyqësore. Kështu, dhe gjyqtarët shqiptarë, si dhe autoritetet gjyqësore, përfshi dhe Inspektoriatin e KLD-së do kishin një standard më të qartë tek i cili do të adresoheshin për të vlerësuar sjelljen etike të gjyqtarit.

Ju faleminderit !

Sandër Simoni,
Gjyqtar i Gjykatës së
Shkallës së Parë për Krime të Rënda

Inspektimi i gjyqësorit në lidhje me respektimin e standardeve etike dhe praktika e ndjekur nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë

*“Standardet etike të gjyqtarëve dhe rritja e besimit të publikut kundrejt gjyqësorit”
Tryezë e Rrumbullakët, Tiranë, më 06 Prill 2011*

Të nderuar Zonja e Zotërinj pjesëmarrës,

Gjej rastin të përshëndes organizatorët dhe mbështetësit e kësaj tryeze për kontributin e dhënë në përmirësimin e performancës së pushtetit gjyqësor në Shqipëri. Takime të kësaj natyre, me bazë kaq të gjerë, ku marrin pjesë të gjithë aktorët e përfshirë në dhënien e drejtësisë, por dhe hallkat kontrolluese, ndihmojnë në nxitjen e debateve konstruktive dhe evidentimin e problematikave dhe të hapave që duhen marrë për përmirësimin e standardeve të veprimtarisë gjyqësore dhe të mënyrës së kontrollit të saj.

Jam njohur paraprakisht me raportin e përgatitur nga Qendra e Studimeve Parlamentare në përfundim të monitorimit 2 mujor të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, gjykatë që në fakt nuk mund të shërbejë si etalon matës për problemet që ajo ka në infrastrukturë dhe volumin e punës që përballon. Fillimisht dua të parashtroj disa objeksione

apo më saktë, të saktësoj, disa aspekte të veprimtarisë së realizuar nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, gjatë periudhës 2008 - 2010, pasi për këtë veprimtari është folur gjatë në raport.

Inspektorati, detyrat e tij i ushtron në përputhje me dispozitat e Ligjit 8811/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, si edhe në Rregulloren e miratuar nga Këshilli, ku është detajuar mënyra e procedimit për çdo detyrë të ngarkuar nga ligji (edhe në raport janë trajtuar gjerësisht këto procedura).

Së pari: Gjatë trajtimit të ankesave të depozituara nga shtetasit, institucionet shtetërore, personat juridikë apo shqetësimet e bëra prezente në median e shkruar dhe vizive, në çdo praktikë është treguar kujdesi maksimal për shmangien e çdo ndërhyrjeje ose ndikimi në vendimarrjen e gjyqtarëve të gjykatave të shkallëve të para dhe të apeleve. Të gjitha ankesat e adresuara për çështje gjyqësore në shqyrtim e sipër, janë verifikuar vetëm pretendimet për *zvarritje* gjykimi ose *shkelje* të etikës. Madje edhe për çështje gjyqësore (civile e penale) të përfunduara me vendim si në gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit, ankesat nuk janë verifikuar kur objekt të tyre kanë patur mënyrën e zgjidhjes së konfliktit nga gjykata.

Ankesat janë trajtuar e verifikuar në përputhje me procedurën e parashikuar nga Rregullorja e IKLD, ku përmend:

- Hartimi i një relacioni paraprak për Zëvendëskryetarin;
- Urdhëri i verifikimit i detajuar për Inspektorin e ngarkuar me kryerjen e veprimeve verifikuese;
- Informacioni dhe raporti përfundimtar i ankesës.

Si për ankesat e trajtuara, ashtu edhe ato të verifikuara, ankuesit i është kthyer përgjigje me shkrim. Ka patur raste që ky qëndrim, është shoqëruar me pakënaqësi nga ankuesit, pritshmëria e të cilëve ishte zgjidhja në themel e konflikteve të tyre të çfarëdo natyre apo prishja e ndryshimi i vendimeve të dhëna nga gjykatat. Gjithashtu, evidentoj se në adresë të Inspektoratit nuk kanë munguar ankesa për institucione të tjera shtetërore si Zyrat e Përmbarrimit, Agjensinë e Kthimit e Kompensimit të Pronave, ZVRPP, Ministrinë e ndryshme, Gjykatën e Lartë etj.

Në vitin 2009 janë depozituar 1200 ankesa, nga të cilat janë verifikuar 221 të tilla. Ndërsa për vitin 2010, ankesat e ardhura janë 1000, duke u verifikuar 235 prej tyre. Këto të dhëna flasin qartë për trajtimin paraprak

të çdo ankese dhe verifikimin vetëm të atyre pretendimeve, vërtetimi i të cilave, mund të përbëjë shkak për procedimin disiplinor të gjyqtarëve. Në asnjë rast, kontrolli i veprimtarisë gjyqësore nuk është ushtruar tej standardeve të miratuara apo duke cënuar pavarësinë e gjyqtarit të kontrolluar.

Vetëm duke trajtuar me efektivitet ankesat e depozituara, Inspektorati mund të luajë rol në luftën kundër korrupsionit. Ankesat me pretendime për kryerjen e veprimeve korruptive nga gjyqtarët, të shoqëruara dhe me mjete provuese, në mënyrë të menjëhershme i janë vënë në dispozicion prokurorisë, si i vetmi organ kompetent për ushtrimin e ndjekjes penale. Dy iniciativa të tilla të Inspektoratit kanë shërbyer për fillimin e procedimeve penale ndaj gjyqtarëve dhe pezullimin e tyre nga detyra.

Së dyti: E njëjta gjë mund të thuhet dhe për inspektimet e realizuara gjatë periudhës 2008 - 2010. Inspektimet e gjykatave, qofshin këto tematike apo të përgjithshme kanë karakter thjesht njohës. Misioni i tyre është evidentimi i problematikave dhe adresimi i masave e organizmave që duhen përfshirë për përmirësimin e situatës. Mjafton të përmend objektet e këtyre inspektimeve, e lehtësisht perceptohet se janë respektuar standardet europiane dhe ca më tepër nuk është cënuar pavarësia e gjyqtarit. Këshilli, me këto inspektime ka patur në vëmendje problemet e:

- Respektimit të solemnitetit të gjykimit;
- Respektimit të etikës gjyqësore;
- Zhvillimit në orarin e paracaktuar të seancave gjyqësore;
- Respektimit të disiplinës në punë;
- Evidentimit të problematikave që ndikojnë në zvarritjen e proceseve penale.

E ndërsa organet kontrolluese kujdesen për respektimin e pavarësisë së pushtetit gjyqësor, nga ana tjetër, perceptimi i publikut për cilësinë e shërbimit që i ofrohet nga gjykatat shqiptare le shumë për të dëshiruar. Jo rrallë gjyqtarët targetohen si të korruptuar dhe të paaftë, me apo pa të drejtë. Kjo situatë mund të ndryshohet vetëm me një reformë të thellë të të gjithë sistemit. Ndryshimet në këtë stad, nuk mund të arrihen me amendime të akteve nënligjore, por fillimisht duhen ndryshuar parime të përcaktuara në aktin themelor të shtetit, në Kushtetutë. Më konkretisht, do të përmendja:

- Kufizimin e imunitetit të gjyqtarit nga procesi penal, duke mos iu njohur ky privilegj për kryerjen e veprës penale të korrupsionit;

- Të rejat e parashikuara në procesin disiplinor nga Ligji 9877/2008, duhet të përqasen edhe me dispozitat e Ligjit 8811/2001, duke evidentuar mënyrën e verifikimit të parregullsive të pretenduara;

- Kategorizimi i shkeljeve në “shumë të rënda”, “të rënda” dhe “të lehta” dhe listimi për aq sa është i mundur i shkeljeve të secilës kategori, thjeshtëson evidentimin në praktikë të tyre. Megjithatë nga debatet në radhët e juristëve diskutohet nevoja e riformulimit të disa prej tyre, me qëllimin e vetëm, respektimin e pavarësisë së gjyqtarit. Përsa i përket standardeve etike që duhet të ndjekin gjyqtarët, ato janë të përcaktuar gjerësisht në nenet 23 e 32 të Ligjit 9877/2008. Parimet e parashikuara nga Konferenca Kombëtare Gjyqësore në vitin 2000, në miratimin e Kodit të Etikës, janë pasqyruar jo vetëm në ligjin organik të gjyqësorit por edhe në Kodet e Procedurave Penale e Civile. Është e vetëkuptueshme që ligji nuk mund të listonte çdo shkelje, prandaj ka parashikuar një dispozitë të hapur ku ka përfshirë aktet dhe sjelljet e tjera të rënda me pasojë diskretitimin e rëndë të pozitës dhe figurës së gjyqtarit. Gjithashtu, një pjesë e parashikimeve të Kodit të Etikës Gjyqësore janë materializuar në formë urdhërimesh në nenin 23 të po atij ligji “Kufizimet për shkak të detyrës së gjyqtarit”.

Me shumë rëndësi për arritjen e standardeve europiane në procesin disiplinor ndaj gjyqtarit, është evitimi i mungesës së fleksibilitetit në masat disiplinore që mund të merren ndaj gjyqtarëve të proceduar. Jo të gjitha shkeljet e listuara si shumë të rënda, janë vërtet të tilla, por edhe masa disiplinore që mund të jepet për to është shumë e ngurtë, ligji parashikon vetëm shkarkimin nga detyra. Është shumë i diskutueshëm në këtë rast, respektimi i parimit kushtetues të përcaktuar nga neni 147 i Kushtetutës sipas të cilit shkarkimi nga detyra i gjyqtarit mund të realizohet vetëm për “kryerjen e akteve e sjelljeve që diskretitojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit”.

Një tjetër rregullim i nevojshëm për të garantuar efikasitetin në procesin disiplinor është ndryshimi i përcaktimit ligjor tashmë të rikonfirmuar, ushtrimi i të drejtës ekskluzive të Ministrisë së Drejtësisë në fillimin e procedimit disiplinor. Është e vërtetë që kjo praktikë ndiqet dhe në shumë vende europiane, por mendoj se ka ardhur koha për ndryshim në këtë aspekt. Për vetë realitetin shqiptar nuk mund të pretendoj zbatimin e praktikës franceze ku të drejtën për të iniciuar një procedim ndaj gjyqtarit e ka kryetari i gjykatës, por të paktën mund të parashikohet ngritja e një

komisioni disiplinor, që ka fjalën e fundit në fillimin ose jo të një procedimi ndaj gjyqtarit (rekomandim edhe i ekspertëve ndërkombëtarë në kuadër të projekteve të bashkëpunimit me KLD-në).

Një tjetër problematikë e gjykatave shqiptare në drejtim të zhvillimit të procesit të rregullt ligjor është përfundimi i gjykimit të çështjeve në afate të arsyeshme kohore. Krahas organizimit e planifikimit më të mirë të punës nga vetë gjyqtarët (caktimi i një numri të arsyeshëm seancash e me diferenca kohore të pranueshme, njoftimi i organeve kompetente për mosveprimin e palëve në proces e përfaqësuesve të tyre), lind nevoja për ndryshime në Kodet e Procedurave Civile e Penale duke përmirësuar mënyrën e njoftimit të palëve për procesin, mundësinë e marrjes së sanksioneve ndaj palëve në proces, barrën e provës në gjykim etj.

Së fundi, por jo më pak rëndësi ka procesi i administrimit të buxhetit të gjykatave. Kushtet infrastrukturore të shumë gjykatave të shkallëve të para dhe të apeleve diktojnë nevojën për rritjen ndjeshëm të buxhetit që i akordohet pushtetit gjyqësor. Rritja e buxhetit duhet adresuar për:

- Rritjen e pagave të gjyqtarëve, duke minimizuar disnivelin e tyre mes shkallëve të gjykimit;

- Ndërtimin e një infrastrukture që garanton transparencën dhe respektimin e solemnitetit në gjykim;

- Regjistrimin audio-viziv të seancave gjyqësore, proces që bën të mundur:

- a) Reduktimin e kohëzgjatjes së gjykimit të çështjes;

- b) Efiçencë të punës së Inspektoratit në kontrollin e respektimit të etikës, solemnitetit gjatë ushtrimit të veprimtarisë gjyqësore;

- c) Rritjen e nivelit të vetëkontrollit dhe të cilësisë së gjykimit nga gjyqtarët.

Problematikat e trajtuara në raport janë shumë të gjera e debati për secilën prej tyre do kërkonte shumë më tepër kohë. Duke ju falenderuar për vëmendjen mbetemi të hapur për zgjerimin e debatit për to.

Faleminderit!

Valbona Vata

*Kryenspektore në Inspektoriatin
e Këshillit të Lartë të Drejtësisë*